

INTERVISTË ME MEHMET HAJRIZIN

Prishtinë | Data: 2 dhe 6 mars 2023

Kohëzgjatja: 443 minuta

Të pranishëm:

1. Mehmet Hajrizi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotëri Mehmet nëse mundeni me u prezentu, me na tregu për familjen diçka, prejardhjen e juaj?

Mehmet Hajrizi: Unë jam Mehmet Hajrizi i lindur në Strofc të Vushtrrisë me 1948. Kur ta përmendësh vitin 1948 të kujtohen menjherë ai kontekst historik e ngjarjet e zhvilluara në ato vite në Kosovë. Po le ta boj prezentimin e plotë. Kam mbaruar Shkollën Normale dhe Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. Atëherë ishte Fakulteti Filozofik në kuadër të tij. Gjuhë dhe Letërsi Shqiptare. Kaq për fillim.

Anita Susuri: Çfarë familje rrjedhni?

Mehmet Hajrizi: Familja Hajrizi është prej kur, dihet domethonë, në fshatin Strofc dhe ka qenë një familje si t'gjithë familjet e Artakollit. Se kështu quhet ajo pjesë ku shtrihen disa fshatra edhe Strofc. Strofc do t'jetë larg prej ktu dikund përreth 19 ose 20 kilometra. Osht' ni fshat që shtrihet rrëz Qyqavicës së njohur dhe që ka përpara gjithë Rrafshin e Kosovës si një peisazh t'mirë, t'bukur që e sheh. Mrapa në fund kem malin e bjeshkën dhe përpara në front kem fushën e Rrafshit të Kosovës.

Atje kom bërë fëmijërinë deri n'moshën pesë vjeçare, katër e gjysë. Kemi lshuar Strofcin. Ma tepër për shkaqe ekonomike në kërkim të një sipërfaqje ma të gjerë të tokës për ta punuar dhe për të mbijetuar. Sepse ishim pesë vllazër ne dhe ni motër ose meqë ishte motra ma e madhja, ni motër edhe pesë vllazër. Babai ynë ka qenë fshatar. Fshatar, bujk, punëtor, njeri i ndershëm, njeri i fjalës, njeri i dinjitetit. Me respekt të gjerë në ato anë anej.

Vllau i tij, vetëm ni vlla ka pasë ai, vllau i tij ma i madh se ky që e kanë qujtur Zymber osht' pushkatuar me dy kusherit e tij të afërm në vitin 1921 nga hordhit serbe. Babai im osht' kujdesur që t'rriren mirë e mbarë e të edukohen në frymën e babait të tyre edhe katër djemtë që kishte lënë të rinjë vllau i tij, Zymberi. Pastaj ata u rritën, u bon t'zot e vetit dhe u rritëm edhe ne fmitë e babait. Babai ishte martuar me një vajzë të bukur, jo larg Strofcit, në Hade ni fshat atje dhe quhej Naile, nëna ime.

Unë në këtë familje kom qenë fmija i fundit, ma i vogli. Atëherë i thoshin “sugar” fmsë të fundit që lind në familje, ma t’riut. Disa nga vëllezërit ma t’ri janë shkolluar por vllzërit e mdhej, sidomos dy t’parët nuk kishin arritur t’bëjnë ndonjë shkollim për t’u shënuar. Pastaj ne në vitin 1953 lshuam Strofcin dhe u vendosëm afër Fushë Kosovës në fshat. Aty jetum për 18 vjet tjera kurse kha gati 60 vjet që jetojmë në Prishtinë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për atë axhën, kusherinin e juj që osht’ vra, axhën e babës a po si po i bie. A e dini në çfarë rrethana osht’ vra në vitin 1920? Pse osht’ vra?

Mehmet Hajrizi: Po thuhet që, thuhet që n’atë kohë është bërë ajo lufta, lufta e kaçakëve dhe kanë pasur humbje si duket forcat serbe dhe pastaj kjo ka qenë një ekspeditë ndëshkuese. Një pse patën humbje dhe dy pse vet Strofcin dhe fshatrat përreth të Artakollit kishin qenë në mbrojtje të atyre forcave kaçake, Lëvizjes së Kaçakëve. Strofcin e pastaj në vazhdim, Zhilivoda para tina, e në vazhdim ato fshatra deri te Vushtrria ishin si t’thush porta e hyrjes në Qyqavicë. Në malet ku zhvilloheshin luftimet.

Sigurisht që ju pengonte rezistenca që bëhej në këtë portë të mbyllur për forcat e huja. Kshtuqë kanë mbledhë edhe të tjerë fshatar, të fshatrave tjera dhe i kanë pushkatuar bashkë. Bashkë të gjithë me radhë. Njëni prej djemve të xhaxhait tim, vllaut të babait tim, Zenel Hajrizi edhe me vllzërit e tij kanë marrë pjesë në luftë deri në tregun e ri në shqip, Novi Pazar. Për të mbrojtur interesat, për të mbrojtur jetën në radhë të parë të shqiptarëve deri atje që po rrezikoheshin nga forcat serbe.

Pastaj Zeneli ka marrë pjesë edhe në luftën e Shaban Polluzhës kundër forcave okupuese serbe që me 1945. Ka marrë pjesë gjithashtu edhe në brigadat shqiptare që kishin ardhë në Kosovë për të kontribuar në çlirimin e Kosovës nga nazi-fashistët. Zeneli pastaj në vitin 1960 bashkë me vllaun tim Zeqirin, vllaun e tretë, Zeqir Hajrizin, të dytë janë organizuar në një organizatë klandestine, të fshehtë, çlirimtare të qujtur Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë në vitin 1960.

Në krye të kësaj organizate dhe themeluesit e saj, të shquar, dy vllzërit Kadriu dhe Ramadani. Ndonëse kishin mbiemra të ndryshëm Kadri Halimi dhe Ramadan Hoxha po ishin vllzër. Dhe Ali Aliu. Ali Aliu dhe Kadri Halimi ishin edhe intelektual të shquar për atë kohë atëherë. Kanë mbetë pastaj gjithë jetën e tyre, edhe sot domethonë kanë lanë gjurmë edhe në fushën e studimeve.

Të dytë kanë hyrë aty, kanë qenë anëtarë të kësaj organizate e cila në vitin 1961 zbulohet... kini parasysh kto të organizatave të asaj kohe nuk kanë pasë jetën shumë t’gjatë. Ni vit, pak ma shumë se ni vit, dy vjet, s’janë arritur dhe kanë ra. Sepse gjurmimi, ndjekja policore e Rankoviçit atëherë ta them, e UDB-së që ai e udhëhiqte ka bërë arresime në masë edhe kuturu ndonjëherë, pa ditur a është a s’është e organizuar. Çdo shqiptar osht’ shikuar me dyshim dhe thuhej që dikund rreth 50 mijë dosje t’hapura kanë qenë në këtë kohë për shqiptarët.

Janë organizuar procese gjyqësore me dhjetra mijë për individ edhe për grupe t'vogla a organizata t'mdha të shqiptarëve që rezistonin kundër ripushtimit të Kosovës edhe viseve tjera shqiptare në ish Jugosllavi. Kta u dënuan, u dënuan atëherë dhe Zeneli, kusheriri im i parë që i kishim babat vllazër, e mbajti burgun në Nish, në Mitrovicë, nëpër kazamatë jugosllave. Kurse vllavi i Zeqirit e dërgun në burgun famkeq të Goli Otokut dhe atje ka mbjatur burgun. Atje e ka shkatërruar shëndetin dhe pastaj tërë jeta i ka shkuar në përkujdesje mjekësore për ta mbajtur derisa vdiq.

Anita Susuri: A keni pasë rast m'i vizitu nëpër kto burgje ju ata njerëz?

Mehmet Hajrizi: Si zakonisht në burg nuk lejohen në vizitë në kohën e hetimeve intenzive. Bile bile as nuk tregonin që ne i kemi arrestu dhe i kemi në burg. I kanë mbajtë ashtuqë familjet osht' dashur pastaj të gjurmojnë, t'shkojnë t'pyesin ku na mbeti njeriu ynë. Nuk kanë treguar derisa më në fund kanë treguar po nuk kanë lejuar që të vizitohen derisa janë kryer hetimet. Me t'mbaruar hetimet pastaj ka pasur vizita, kanë mund të shkojnë.

Unë isha i ri atëherë, fmi, jo i ri po fmi. Dëshiroja shumë t'shkoja ta shihja vllaun tim që e doja aq shumë edhe që m'kish dashtë edhe ai shumë se isha vllau ma i vogël. Po nuk arrita sepse duhej lënë radhën tjerë. Ne ishim familje e madhe edhe do t'shkoj ky, nuk më dërguan. Ndoshta nuk më dërguan edhe për ni arsye. Zeqiri ishte dërmuar fizikisht edhe me shëndet shumë të rrënuar.

Një rast kur shkon vllau im i madh, siç ka dëshmuar ai në një intervistë për media, kur shkon ta vizitoj bashkë me nënën time, hyjnë brenda, tha, "Zeqiri kishte ndrruar krejt, nuk ishte ai që e kem pasë në shtëpi dhe mezi qëndronte n'kambë. Aq sa dikur kishte rrezik që t'binte", thotë, "dhe ai gardiani ma bëri me shenjë që a mbarojmë se ky do t'bije për toke", tha, "unë e aprovova, nuk dëshiroja, jo nuk dëshiroja po nuk mund të duroja që nëna ime ta shoh skenën e rrënimit për toke të djalit t'saj".

E shkreta tërë kohën ajo ka qenë n'vaj. Ka pasë raste kur ajo u ulur të haj bukë bashkë me anëtarët e tjerë të familjes dhe e ka lënë bukën dhe është shkrehur n'vaj përsëri. 'Po pse çka ke?' I thoshin. Thonte, "Unë po ha e Zeqa jem ndoshta s'ka hangër kushedi sa kohë", e tjerë, e tjerë. Kjo tabllë e nënës të vujtur, liktisur edhe shpirtërisht të vrarë për nënën e saj ka qenë jo te një nënë, ka qenë te dhjetra mijë nëna shqiptare në Kosovë. Në Kosovë dhe vise tjera të shqiptarëve nën ish Jugosllavi në treva tjera të shqiptarëve.

Ishte ni jetë e tmerrshme por e tmerrshme ishte, i tmerrshëm ishte edhe konteksti historik në të cilin po jetonim. Shqiptarët po ndiqeshin, po keqtrajtoheshin, po vriteshin, po burgoseshin, po diskriminoheshin n'atë kohë. Regjimi, regjimi serb në gjithë politikat e brezave të regjimeve të ndryshme ka pasë për qëllim që ta zhdukë racën shqiptare. Me qëllim që t'marrë territorin por pa shqiptarë.

Kosova ishte viktimë e këtij qëllimi historik serb, e kësaj politike historike serbe dhe po deshët duke parë parasysh edhe gjithë ato elaborate edhe gjithë ato plane gjithë ato qëllime të fundit të tyre bënë jetë doktrinë. Një doktrinë e një kombi që don ta zhduk ni komb tjetër dhe që e ka fqinj. Në këtë gjendje, e rëndë ishte jeta dhe e padurueshme ishte jeta. Nuk mund ta përballonin dhe disa prej tyre pastaj edhe dhunshëm por edhe nga ky represion u detyruan që ta lshojnë Kosovën dhe të vendosën në Turqi kryesisht ku sot bëjnë mbi pesë milion pasardhës të atij brezi shqiptar që dhunshëm u dërguan atje.

Anita Susuri: A ka pasë n'rrethin e juj ose n'familje që kanë shku?

Mehmet Hajrizi: Jo. Jo nuk kanë shkuar askush. Ndoshta prandaj e kemi paguar qaq shtrejt (qeshë). Jo vetëm qëndrimin ktu por edhe rezistencën edhe rezistencën. Në vitin 1981 se për organizatën tonë do t'ju flas pastaj, shpërtheu kryengritja popullore paqësore në Kosovë për Republikën e Kosovës. Ni lëvizje domethonë që kishte për qëllim ta bënte populli shqiptarë në Jugosllavi që ishte i treti për nga madhësia, ta bënte të barabartë me popujt tjerë jugosllav. Nuk kishte asnjë kërkesë asni qëllim tjetër. Nuk pretendohej që të shkatërrohej Jugosllavia prej nesh po që të barazohemi, as më pak as më shumë. Kaq ishte qëllimi dhe ishte përpjekja që të arrihej kjo.

Në ato demonstrata duke filluar prej kryeqytetit të Prishtinës e në qytete tjera edhe në fshatra mandje me të gjitha shtresat shoqërore duke filluar prej nxënësve, studentëve, shtresës së inteligjencës, fshatarëve, punëtorëve. Me ni fjalë, të gjitha shtresat shoqërore të popullsisë ishin ngritur në këmbë me ni kryengritje. Po e quj kryengritje për karakterin e saj, për shtrirjen e saj. Ajo ishte ni kryengritje jo e armatosur. Ndonëse ishin përdor edhe armët.

Po në Prishtinë me 02 prill 1981 pati reprezalje të rënda me armë zjarri kundër demonstruesve. Në krye të demonstruesve, djali i vllaut tim Naser Hajrizi, bashkë me shokun e tij të organizuar, të dy ishin militant të organizuar. Bashkë me shokun e tij Asllan Pireva, që ishin nxanës të vitit të katërt të shkollës së mesme, po mbaronin atë vit, vriten aty ku osht' kryeministria sot. Ni shesh mrapa saj. Ka aty ni pllakë sa për t'shënuar që u derdh gjaku i dy t'rinjëve aty. Jo vetëm kta dy. U vranë edhe gjashtë të tjerë në Prishtinë, në Vushtrri edhe në Ferizaj.

Pastaj pati edhe vrasje tjera edhe në Gjakovë edhe në Prekaz po edhe nëpër burgje. Mbytën njerëz në tortura, në torturë. Rënia e Naserit ishte gjë ma e randë e familjes tonë. Mirëpo unë, bashkëshortja ime Haxherja, djali i vllaut tim tjetër Jahiri, ishim gjithashtu t'organizuar dhe familja nuk e dinte saktë si do t'jetë edhe fati ynë. Një anëtarë i familjes i vra por të tjerët ose do t'vriteshin ose do të arrestoheshin, do të dënoheshin me burg t'rëndë. Por pak gjasa kishte që të shpëtoje në ato situata t'rënda nëpër të cilat po kalonte krejt Kosova. Pastaj, ram n'burg edhe ne dhe mbajtëm atë burg dhe u kthyem në shtëpi.

Një paraqitje e shkurtër e historisë të familjes tonë ishte kjo. Po sigurisht që do t'kthehem...

Anita Susuri: Po. Zotëri Mehmet na folëm... po du m'u kthy pak në disa detaje që i përmendet. Në fëmijërinë e juaj ka qenë fëmijëri ku jeni përballë me burgosjen e anëtarëve të familjes të juaj, njerëzve që i keni pasë afër. Qysh ka qenë me u rritë me këto, domethonë, ngjarje që kanë ndodhë? Po gjithashtu duke parë parasysh që keni qenë fmi edhe s'i ka ndiku krejt në zhvillimin e juaj po ndoshta ma tutje edhe të idealit, krejt kto që kanë ndodhë?

Mehmet Hajrizi: Nuk osht' e lehtë për asnjë anëtarë të familjes kur vijnë forcat e çmendura serbe dhe ta kapin anëtarin e familjes. Po osht' veçanërisht e rëndë për ni fmi si e përjeton ai në psikologjinë e tij, në jetën e tij shpirtërore ni gjendje të tillë kur papritas, pa ditë asgjë e humb vllaun, e humb babanë, e humb motrën e kështu me radhë. Bashkë me vllain tim Zeqirin, Zeqiri ka qenë i lindur në vitin 1940, ishte edhe ni dajë i imi që e kishim afër, fqinj Banush Ademi.

Te dytë kanë qenë të ni moshe të përafërt. Mund t'ketë qenë Zeqiri pak para tij po aty. Zeqiri ishte atëherë nxanës i klasës së fundit të shkollës bujqësore. Me Banushin, me dajën e vet ata ishin organizuar nën ndikimin e Ramadan Hoxhës, vllaut të Kadri Halimit, udhëheqësit të organizatës. I cili punonte si bibliotekist në Fushë Kosovë. Kta dy t'ritë shkonin dhe merrnin libra aty. Unë ndonjëherë i merrja vllaut ato libra dhe lexoja diçka prej tyre.

Aty Ramadani duke parë se ishin djem të formuar, djem inteligjent, djem të fortë, ju propozon që të organizohen në organizatën që ata udhëhiqnin, Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Kta te dytë mbajshin takime, mbajshim takime të fshehura që t'mos merrte vesh familja e asnjërit përse po bisedojnë. Po unë si çdo fmi kurreshtar shkoja dhe i gjeja nëpër t'futur nëpër ara ku kishte grur të mbjellur, ku kishte misër. Ata ishin fut dhe po bisedonin aty. Unë shkoja kadale, qetë, qetë dhe afrohesha afër.

Jo pse kapja fillin e bisedës çfarë kishin po ma shumë m'interesonte të gjeja ku shkonte vllau, ku mbeti dhe i gjeja. Pastaj qëndroja aty. Vllaut tim i vinte vështirë që t'më largonte dhe ata merrnin tjetër bisedë. Ndërkohë mbaj mend daja, Banushi, i thoshte vllait, "A po largon a po e largoj unë?" Sepse si duket e kisha tepruar, i kisha marrë kohë shumë atyre (qeshë) duke qenë me ta.

Isha, me hi në klasën e katërt ose të pestën, ktu dikund s'mbaj mend mirë shoh në shtëpi dhe erdhën dy njerëz. Njëni fliste shqip tjetri fliste serbisht. Më pyetën, "I kujt je?" Ju thashë. M'pyetën për vllaun, "Ku osht?" Thashë, "Nuk osht' ktu?" "Ku osht'?" Babai m'kishte thanë që ti s'ke nevojë të tregosh kur t'pyesin ku osht' ky, ku osht' ai, thuaji "Nuk di, ti je fmi". Thashë, "Nuk e di ku osht'". Unë e dija ku ishte, kishte shkuar në qytet, në Prishtinë dhe pritshim që të kthehej domethanë.

E thirrën babanë pastaj. Doli ky dhe ju tregoj që, 'Nuk osht', ka shkuar në Prishtinë'. Ata i thojnë, "Hajde me neve deri në fshat", se ne ishim pak në periferi të fshatit. Fshati Henc quhej i Fushë Kosovë. Ishim në periferi me shtëpi. Shkun ky bashkë me ata dy në fshat ku ata ishin vendosë, ekipi që kishin ardhë

për të arrestuar. Atje e pysin edhe niherë ku ka qenë ku osht' e tjera, kto që thashë. Pastaj i thonë, “Shiko, do t'i thush djalit nesër të vij në mëngjes e të paraqitet në stacionin e policisë në Fushë Kosovë. Kem vetëm një bisedë t'shkurtë me të pa kurfar pasojash, le t'vijë deri aty”, edhe tha, “M'i rrahën shpatullat me dorë”, tha, “s'më pëlqej hiç sepse e pashë kush janë dhe ata nuk t'përkëdhelin shpatullat”.

U kthy në ni gjendje tepër t'keqe babai. Në pamje dukej edhe nuk po bisedonte, nuk po tregonte asgja. Ma vonë pastaj e morëm vesh kta. Ndërkohë policia që kishin ardhur për arrestim morën me vete ni bashkëfshatar. Si duket i thojnë, ‘Do t'na tregosh ti në qoftëse Zeqiri osht' duke u kthyer në shtëpi’, që ta kapin rrugës. Ka gjasë që ky ju tregoj në dalje të Fushë Kosovës, që, ‘Po, ky osht' Zeqiri’. Po Zeqiri ishte bashkë me Zenelin, me atë kushëririn tjetër të organizuar.

Nalet makina, i pyesin, ‘Kush jeni?’ Ky tregon thotë, “Zeqiri duhej t'vijë me neve, kem pak punë. Kurse ti”, nuk dinin për të ose siç ka qenë puna, as s'ju ka interesu se kta kanë ardhë për Zeqirin. “Ti mund t'vazhdosh”. Tregonte pastaj Zeneli se ai u arrestu ma vonë. Tregonte Zeneli për gjendjen që ka pasur kur e morën Zeqirin. Tha, “Unë e kisha me veti armën, një revole”, tha, “edhe disa here m'ka shkuar mendja që ta përdor. Ne të dyt t'ikim, të mshifemi dhe t'kalojmë kufirin të kalim në Shqipëri. Megjithatë”, tha, “nuk e përdora se ma përpara ata mund t'na vrisnin neve”.

Po ai erdhi në shtëpi te ne edhe na tregoj si e morën Zeqirin. Për babain kjo ishte konfirmim i asaj që kishte dyshuar derisa ishte në fshat. Për mu ishte e pa imagjinueshme që unë t'mos e kisha më Zeqirin afër në shtëpi. Sepse ai si t'thush më ndihmonte edhe se ishte ma i shkolluar prej vllazërve. Më ndihmonte edhe në shkollim, më ndihmonte edhe në edukimin tim. Mund t'them që shkolla e parë e edukimit tim patriotik ka qenë vllai im Zeqiri, Zeqir Hajrizi. Atë e kisha mësues mbi mësuesit që kisha në shkollë. Sepse ky më edukonte hapur dhe ndryshe. Prandaj e çmoja shumë, pikërisht për këtë kontribut të tij që po jipte në formimin e personalitetit tim si fmi dhe si i ri nesër.

Arrestimi i tij mua ma nxiu jetën dhe më humbi vullnetin për gjithçka. Megjithatë unë isha nxënës shembullor dhe nuk mund, nuk mund t'lejoja që të bije niveli im kualitativ i mësimnxënjes në shkollë. Fundja të mbaja atë ritëm dhe atë nivel të punës ishte edhe ni përmbushje e ni kërkesë, e një porosie dhe të vet vëllaut, Zeqirit. Shkova në shkollë, m'thirrën në sallën e arsimtarëve. Çka po m'thrrasin tash, çka kam bërë unë? Zakonisht nxënësi mendon që ka bërë ndonjë faj dhe tash duhej t'shkon para gjyqit.

Nuk kisha bërë asnjë faj unë (qeshë). Kom qenë natyrë e qetë dhe njeri shumë i afërt dhe i kujdesshëm me kolegët, me shokët e shoqet e klasës, me arsimtarët e me të tjerët. Me respektin që duhet t'ketë nxënësi. T'gjitha ishin në atë nivel. Po, jo, ata m'kishin thirrë, përse e kanë marrë në burg vllaun. Nuk m'kujtohet a pat' aty edhe ndonjë njeri që nuk ishte anëtarë i kolektivit. Me gjasë, po. Thonë ni fjalë, ‘Tregon fmija çka ka shpija’. Ata prisnin mos fmija ka dëgjuar diçka dhe din diçka dhe do ta thotë sinqerisht dhe do t'na lehtësoj ne procesin e hetuesisë me Zeqirin.

Une sipas asaj porosisë që nuk di, nuk di thashë, “Nuk di kush e ka marrë as pse e kanë marrë, s’e di kur e lshojnë a kur vjen. Nuk kom haber po e di që e kanë marrë, dikush e ka marrë, s’di çka janë ata”. Kaq domethonë me ta. U ktheva. U ktheva në shtëpi dhe po vazhdoja. Ai ka pasë ni kand në dhomën e ditës ku po rrinim, ni kand të, ni qoshe të dhomës ku kishte bërë ni dollap edhe mbante gjithë librat e tij atje dhe mbate ni çantë dore me t’cilën i bante materialet kur shkonte në mësim.

Gjithë kohën unë sytë atje i mbaja dhe më dukej sikur po shoh vllaun tim aty dikund ulur në ni front lart dhe më shfaqej. E shihja andërr. Niherë e kisha parë andërr ku edhe ai kishte ardhë në klasën time dhe ishte bërë nxënës. E çuditshme për mu si është e mundur ky nxanës po kush e di çka thoshte kjo andërr atëherë për ni fmi.

Po sigurisht që shprehte atë preokupim të ditës që shfaqej në ëndërr natën. Ato ndjenja që po ziheshin në shpirtin, në organizmin e njomë të një fmija që përjeton ndoshta burgun e anëtarit të familjes ma rond se vet ai i burgosuri. Kjo ishte gjendja që nuk, nuk e harroj. Kto kujtime janë, siç thashë ma përpara, të gravuara fort në kujtesë dhe mbahen mend. Mbahen mend deri n’fund t’jetës.

Pjesa e Dytë

Mehmet Hajrizi: Zeqiri ishte në burg po une nuk arrita ta shoh ndonjëherë. Ndoshta nuk më dërguan me qëllim që t’mos e shihja në gjendjen në të cilën ishte ai. Torturat kanë qenë mizore, sikur në çdo periudhë edhe në periudhë të vona edhe atëherë kanë qenë mizore në burg. U përmend vetëm ni detaj që ma ka thënë Zeqiri kur është kthyer nga burgu.

Thotë, “Përderisa ni hetues serb po më torturonte dhe t’ju duk pak edhe ma kapi kokën e pastaj te një muri i binte murit me kokën time”, tha, “edhe aty ishte edhe një ndërprerës i korentit që ai ndoshta se shihte po u thye ai ndërprerësi”, tha, “edhe tash mund të dilnin telat, kabllat e energjisë elektrike dhe të më vriste tash korenti se lehmo ky hetuesi”.

“Dikur”, tha, “e pa që po i përballoja kto t’gjitha, m’shtini dy gishtat e mdhej të dorës m’i shtini në gojë edhe po e tërhiqte në të dyja antë dhe shihej se kishte ndërmend të shkynte gojën time. Unë nuk muja ta duroj këtë gjendje sepse ishte dhimbje shumë e tmerrshme, ende kisha fuqi”, tha, “dhe e kom shtyer me gjithë fuqinë që kom pasë edhe i pshtetur për muri”, tha, “edhe u plandos në dysheme në shpinë ra. Ndërkohë tjetrtë që ishin jashtë ndoshta ose afër aty e ndëgjjuan rropllimën”, tha, “ky u ngrit në kamë dhe e nxori revolën”, kinse për ta vrrarë këtë.

“Pikërisht atë moment hyjnë ata brenda, ata e kapën nuk e lanë që ta shkrepnte revolën”, ose ndoshta nuk do ta shkrepnte po ka pasë për kërcënim ku ta dish. “Pastaj më morën mua”. Dhe mund ta imagjinosh sa shtrejt pastaj e ka paguar atë shtyrje të tij edhe plandosje. Po Zeqiri në kushte të rënda

të atyre kthinave, qelive të burgut ku nuk ka dritë, nuk ku ka shtrat, ku nuk ka karrige, ku nuk ka dysHEME normale po në beton, ku nuk ka dritare po ka ni rrjetë të shpuar që e lshon të ftohtin, nuk ndalet aty. Unë vet e kam përjetuar atë dhe e di si duket ajo dhe çfarë kushte janë ato aty.

Zeqiri merr tuberkuloz aty, tuberkuloz në mushkëri. Pasi janë kryer hetimet, pastaj osht' bashkuar në dhomë me Zenelin Hajrizin, kusheririn e vet edhe me ni Hasan Dumanin që ishte profesor atëherë i shkollës bujqësore para arrestimit. Te dyt anëtarë të organizatës në të cilën ishte edhe ky. Ata, shkruan tash në librin e tij Hasan Dumani, "Kujtimet", që ua dhashë ma përpara. Thotë, 'Zeqiri ishte krejtësisht i dërmuar', thotë, 'dhe ndodhte ndonjëherë na vinte ndonjë copë mishi në ato gjellnat që i bëjnë', si në Burgun Hetues të Prishtinës që s'i bëjnë ato gjella askund. 'Vinte ndonjë copë mishi dhe ne, unë edhe Zeneli nuk e hanim vet po ia jepnim Zeqës që të këndellet pak, të vijë n'veti sepse do t'na vdiste n'dhomë'.

Pasta jZeqirin e kanë transferuar nga Prishtina pas dënimit dhe shëf i krejt ktyre hetuesve atëherë ka qenë ni Çedo Topalloviç, kryeshef i UDB-së për, ktu në Prishtinë. Që i ka udhëheq t'gjitha kto procese hetimore. Hetimore të dhunshme, të përgjakshme. E transferojnë në Goli Otok, në Goli Otokun famkeq. Atje në Goli Otok ka pasur ni gur thyes ose jo gur thyes po gur blues. Osht' gurore toka e Goli Otokut, osht' ni ujëdhese në Kroaci. Midis detit që t'mos mund të ikë askush. Megjithëse ka ndodhë që njerëzit kanë hy not n'deti për t'ikë prej atij burgu.

Ka qenë shpatie. Ato barakat ku kanë jetu t'burgosurit kanë qenë poshtë kurse punishtja ka qenë larg në ni shpat u dashtë të ecshë përpjet që t'shkojsh atje ku punohet. Secili i burgosur ka pasë ni gur, ni gur t'madh, si zifi. Dhe ka pasë për detyrë çdo mëngjes kur t'niset e t'shkoj në punishte ta ngarkoj gurin në shpinë dhe ta baj deri atje lart. Kurse në mbrëmje kur t'mbaroj punën ta kthej gurin përsëri në vend t'vet. Secili e ka pasë gurin e vet për ta bartut. Kjo si dënim shtesë përveç punës që ishte torturë në vete. Sepse duhej të punoje në makina ku bluhej guri dhe bëjnë taraseri që i grryn mushkëritë e njerëzve që kanë punuar aty.

Zeqa, Zeqiri i kemi thanë shkurt, Zeqiri kishte edhe ashtu të grryera mushkëritë, i kishte me tuberkuloz. Kishte shkuar atje i rrënuar. Dhe duke mos marrë asnjë masë shërimi të tuberkulozit, atij atje i kalon tuberkulozi nga mushkëritë në veshkë. Për herë t'parë n'jetën time kom ndëgjue që tuberkulozi mund të transmetohet nga mushkëria në veshkë. Ky tash në dy organe e kishte tuberkulozin edhe në mushkëri edhe në veshkë. Ka dalë pastaj nga burgu i rrënuar po kshtu. Menjëherë e kanë dërguar në ushtri. Megjithëse i kish kalu vitet për t'qenë ushtar ai ma po për arsye objektive e kanë marrë në ushtri...

Anita Susuri: Në burg sa vjet ka qenë?

Mehmet Hajrizi: Katër vjet. Kur shkon, kur shkon në ushtri përkeqësohet gjendja dhe fati i tij që u përkeqësua në ushtri dhe e dërgojnë në Spitalin e Zagrebit, të Lublanës gjithashtu. Në dy spitale ka

qenë me intervale të ndryshme. Dhe kanë marrë masa shëruese për tuberkulozin në veshkë sidomos. Osht' shërue vazhdimisht por veshkat sidomos nuk e morën vetën ma kurrë dhe pushuan së funksionuari, u bllokuan. Pastaj, ka jetu nja 14 vjet të fundit të jetës t'tij në dializë.

Kto i ka jetuar në Finland edhe në Suedi. Sepse gjatë luftës e kanë dërguar atje, siç i kanë marrë shtetet e ndryshme të dëbuarit. Kanë dërguar atje dhe atje, atje janë përpjekë ta mbajnë dhe e kanë mbajtur gjatë. Se po të ishte në Kosovë nuk do të përballonte jeta e tij sepse fill pas luftës ktu tek ne nuk, nuk ka pasur mjete. Duhej të shkoje në Shkup e në Nish nuk mund të shërohej.

Por për mua edhe niherë unë po kthehem te ndjenjat e mija, ka qenë një gjendje tepër e randë dhe që ka ndikuar në jetën time shpirtërore. Në jetën time formuese si nxanës edhe si student. Sepse për sa ishte n'burg, ne nuk kishim asnjë parashikim çfarë do t'ndodhë me të kurse pas burgut ai erdhi krejtësisht i rrënuar. Nuk ishte ma ai Zeqiri që dikur e kisha, e kisha përjetuar ndryshe.

Pastaj dhimbja tjetër akoma ma e randë ishte me Naserin, Naser Hajrizin. I cili në moshën 20 vjeçare ju kput jeta dhe një familje, si t'thuash, që e kaloj jetën e saj në, në nifar' zije. Po nuk ishte vetëm familja jonë kshtu. Ishte në tmerr, në vujtje, në ndjekje, në torturë jo një familje e tërë po ni popull i tërë, ni popull i tërë. Ni popull shqiptar që vetëm në saje të forcës së tij shpirtërore. Po deshte të gjenit shqiptarë ka arritur të përballoj atë periudhë gati 100 vjeçare të sundimit sllav në kto treva.

Anita Susuri: Zoti Mehmet nëse mundeni me na folë për njohuritë e juja për organizatat ilegale para se me formu oranzatën e ju? Si ka qenë përvoja e ju në demonstratat e vitit '68?

Mehmet Hajrizi: Në qoftëse e marrim vetëm periudhën e viteve '60 se ka pasur organizim çlirimtar që nga viti '45 me NDSH-në me organizata t'vogla e t'mdha deri në '60-ten. Në '60-ten osht' themeluar Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë për t'cilën fola ma herët. Kanë vepruar pak ma shumë se një vit dhe osht' dënuar organizata. Shumë nga veprimtarët e saj edhe udhëheqja janë dënuar. Kanë shpëtuar të tjerët. Siç ndodhë gjithmonë që mbetet dikush pa u arrestuar.

Viti 1963 domethonë dy vjet pas organizatës që fola formohet ni organizatë tjetër e re në krye me shkrimtarin Adem Demaçin. Organizata ishte formue në shtator të vitit 1963 nga disa veprimtarë, kryesisht intelektual. Në vazhdim osht' emërtuar organizata që në mbledhjen e dytë të organizimit duke e qujtur Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, LRBSH shkurt. Aty zgjidhet në krye Adem Demaçi dhe vendoset që të formohen komitete të qyteteve kryesore në Kosovë. Në formohen komitete të tilla në qytetet ma t'mdha të Kosovës ku kishte pasë në shumicën prej tyre edhe organizime ma t'vogla t'ma hershme.

Ato grupet e vogla pastaj bashkohen me komitetet edhe kshtuqë zgjerohet organizata. Në fillim të vitit 1964 në fund të janarit hartohet programi i organizatës. Kurse në mars po të atij viti hartohet edhe statuti. Statuti që përcakton edhe programin që përcaktojnë qëllimin bazë të organizatës. Qëllimin për

bashkimin e shqiptarëve. Atje thuhet që qëllimi i parë dhe i fundit është ky për këtë organizatë, për bashkimin e atdheut të ndarë. Të ndarë dhunshëm, të ndarë në vitin 1913 nga fuqitë e mdha të atëhershme, Konferenca e Ambasadorëve e të tjera të ma vonshme.

Nuk osht' arrestuar gjith antarësia e kësaj organizate në vitin 1964 duke filluar nga qershori. Në qershor kanë filluar arrestimet dhe pastaj janë dënuar. Janë dënuar dikund 50 vet me burgim të rëndë kurse disa qindra rreth 300 vet janë dënuar për kundërvajtje, dënime ma t'ulta, kundërvajtje. Ata që kishin mbetë dhe ata që dolën në vijim nga burgu pastaj e bëjnë nifar' riorganizimi.

Në vitin 1968, po flasim në kohën kur ishin bërë dy vjet që ishte shkarkuar nga funksionet Ranković dhe për shqiptarët tash po fillonte ni periudhë pak ma e lehtë edhe e veprimit zyrtar se jo vetëm t'fshehtë, që të avancohet pozita e Kosovës. Pozita e Kosovës kishte qenë fillimisht në një autonomi që nuk quhej autonomi. Serbisht e quanin *oblast* që s'kishte kurfar' prerogative vetë qeverisëse...

Anita Susuri: Si provincë?

Mehmet Hajrizi: Po ma vonë pastaj në vitin '63 bëhet nifar' avansimi dhe në vitin '68 kishte filluar reforma kushtetuese në Jugosllavi. Kosova deri atëherë kishte pasë ni statut që organizonte jetën në Kosovë po jo kushtetutë. Tashti që Jugosllavia ishte shfaqë hapur që kishte bërë shumë faje ndaj shqiptarëve, n'krye me Rankovićin. Në shërbim të asaj doktrine serbe që thashë anti shqiptare.

Fillun të rishikojnë nëse mund t'jipen disa t'drejta shqiptarëve. Dhe pati ndonjë zë gjatë ktyre diskutimeve të amandamenteve të kushtetutës atëherë që Kosova të ishte republikë masi ka kufitë e saj, ka territorin, ka popullsinë jo ma t'vogël se kombet jugosllave. Disa ishin, disa kombe ma t'vogla sesa populli i Kosovës edhe trevave tjera shqiptare në Jugosllavi. Ishte vetëm Serbia dhe Kroacia me popullsi para asaj të Kosovës, bie fjala.

U shua shpejt ky zë dhe nuk lejuan që të diskutohet në këtë ulli të republikës. Atëherë përfundimi i gjithë atij procesi reformues të kushtetutës ishte ni zgjidhje gjysmake, ni zgjidhje me kuptim dobioz. Në Kosovë që e bënte njësi konstituive të federatës por e lënte nën Serbinë. Ndoshta as kjo nuk do të arrihej, as kjo nuk do të arrihej që Kosova të kishte këtë status po t'mos ndodhte një ngjarje shumë e rëndësishme historike në vitin 1968, në nëntor të vitit 1968.

Kjo ishte demonstrata e iniciar prej një grupi politik që ishin kryesisht student edhe djem e vajza të rinj që ose kishin qenë të angazhuar në LRBSH përpara ose diku tjetër. Ose që s'kanë qenë të angazhuar por që ishin të një mendje domethonë që ne duhet t'bëjmë dhe për herë t'parë. Pas kryengritjeve të shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore po ndodhte në Kosovë që të shpërthej një protestë, një revoltë dhe një kërkesë njëkohësisht e shqiptarëve për barazi. Të kërkonin ma shumë, atje u kërkua republikë, republikë për Kosovën.

Domethonë ideja për Republikën e Kosovës është e '68-tes jo e '81-shit, ma herët. Ajo demonstratë nuk ishte njësoj sikur demonstratat që ishin bërë gjithandej në Europë, madje edhe në Jugosllavi edhe në Beograd. Po demonstratat që ndodhën në atë vit nëpër botë edhe nëpër Europë edhe në Jugosllavi kishin ni karakter tjetër, ni karakter për rregullim të jetës së brendshme dhe për ni liberalizim.

Domethonë që sistemi për të drejta të njeriut e tjerë. Kurse demonstrata në Kosovë pat' ni karakter nacional çlirimtar. Domethonë ni karakter kombëtar. Sepse çështja kombëtare e shqiptarëve në Jugosllavi nuk ishte zgjidhur kurrë. Nuk ishte zgjidhur drejtë ishte zgjidhur mrapsht e tjera. Dhe shqiptarët kërkonin që të shtrohet edhe niherë në tryezë kjo dhe të mbaroj epoka e diskriminimit të shqiptarëve dhe barazimit të tyre me popuj tjerë.

Ky ishte karakteri i kësaj demonstrate dhe rëndësia e saj ishte që për herë të parë po thom nga '45-ta, për herë t'parë aspiratat e shqiptarëve, vullneti i tyre po shfaqej publikisht, hapur në rrugë. Ky ishte ni shkallë ma e lartë e rezistencës që është bërë deri atëherë sepse ishte bërë kryesisht në organizata të mshefta klandestine që kapeshin e arrestoheshin e dënoheshin. Kurse ni demonstratë ku morën pjesë dhjetra, qindra e mijra njerëz siç ndodhi me '81-shin është e vështirë e pamundur që t'i të arrestosh ni popull të tërë dhe ta dënosh atë. Nji dënim kolektiv sigurisht që po...

Kshtu ndodhi demonstrata e '68-tes dhe ndikoj në procesin e riformimit kushtetues dhe në arritjen e disa fitoreve të kufizuara të shqiptarëve në statusin e tyre dhe në të drejtën e tyre legjitime në vitin 1974 kur këto u sanksionun në kushtetutë.

Anita Susuri: Po mu po m'intereson edhe përvoja juj personale po edhe a e keni njoftë Adem Demaçin ose a keni dëgju për të në atë kohë kur keni qenë ju në shkollë t'mesme?

Mehmet Hajrizi: Po. Me Adem Demaçin nuk kam mund të njihem sepse ai ka qenë n'burg në atë kohë. Kurse kur ka dalur nga burgu pastaj në vitin '70 nuk kom dashur të kontaktoj me të. Sepse isha vet i organizuar dhe mund ta rrezikoja organizatën duke kontaktuar me të. Se e merrnim me mend, jo vetëm unë por edhe të tjerët, e merrnim me mend që ai osht' i survijuar. Ai është i vëzhguar, është i përcjellur. Kushdo që hynte në shtëpinë e tij dhe takohej me të pastaj vazhdonte përcjellja e tij. Çonte pastaj te organizata jonë atje që mund ta rrezikonim.

Megjithatë, ndikimi i figurës së Adem Demaçit në burg ka qenë nji ndikim frymëzues i brezave për t'u organizuar sepse po thuhej që nji intelektual ka rrezikuar jetën e tij nëpër burgje të gjata për t'mirën tonë. Atëherë çfarë duhej t'bëjmë ne që jemi ma t'ri se ai dhe që mund t'bëjmë diçka edhe ne dhe mos t'presim që të dalë rezultati final vetëm prej një njeriu që është n'burg. Domethonë ndikimi edukues edhe mobilizues ka qenë i Demaçit, dhe jo vetëm i Demaçit, edhe i t'burgosurve tjerë.

Kur ka dalë nga burgu vllai, ka dalë pastaj edhe kolegët e tij Kadri Halimi, Ali Aliu e të tjerët. Kom kontakti me ta sepse vllau shkonte te ta e mu më merrte me vete sepse kur kishte ardhë ky unë isha

goxha djalë, dikund nga gjysma e mbarimit të Shkollës Normale. Kur shkova për herë t'parë ta takoj Kadri Halimin për shembull që kishte dalë '68-ten, unë isha aty dhe një vit e gjysë që ta mbaroja shkollën normale. Ai më pyti çka bëj unë, cila është puna ime? Po i tregoj që jom në normale. "Cili vit?" Po i tregoj në cilin vit. "A", tha, "me ty po mujsha me bisedu, ti qenke i nivelit që mund t'bisedojmë gjithçka".

E kisha banesën ku po rrija afër tij, jo shumë larg. Ni banesë me qera me ni koleg tjetër. Po i tregoj ku jom. "A", tha, "ktu. Po qenkemi fqinjë. Po ti", tha, "mund t'vish saherë dush ktu". M'u duk, i ri isha unë, m'u duk ni i burgosur, ni intelektual i madh që kisha dëgju unë për të, e dija kush është. Ni studiues ndër të parët etimolog, ndër të parët jo po i pari, në Kosovë e tjerë. M'dukej që unë po arrij kulmin e objektivit tim të rri me një njeri të tillë dhe të dëgjoj diçka prej tij. E pastaj edhe unë t'i shpërfaq ato ndjenjat e mija para tij e para atij tjetrit, e tjetrit. Ishin njerëz të formuar, intelektual.

Pastaj vishin ata edhe te ne. Vinin te ne dhe gzohesha kur na vizitonin. Ose edhe kur kishin ndonjë dasmë a ndonjë aheng a ndonjë ata ishin gjithmonë të pranishëm aty. E gjithë oda e mbushur me 100 njerëz ndoshta heshtnin të gjithë edhe këngëtarët heshnin të dëgjojnë se çfarë po thotë Kadri Halimi dhe çfarë po flet Ali Aliu. Se ishin, ishin njerëz të gojës dhe të fjalës dhe të mençurisë. Njerëz të inteligjencës që kishe çfarë dëgjoje.

Unë po mësoja prej tyre. Isha në fazën kur duhej të mësoja shumë çka që ndoshta t'i hyja edhe unë ni ditë ni pune të tillë, ni veprimi të tillë. Se siç e kishin kta ni borxh në rininë e tyre ose në jetën e tyre, ai borxh osht' transmetua edhe te brezi ynë si ni flakadan, si ni flakadan që nuk duhej lërë të shuhet, ta mbajmë të ndezur. Dhe ne po e mbajmë të ndezur pa qenë të sigurt a do t'i shkojmë n'fund ksaj pune a jo. Te kryj detyrën time unë si brez që jam dhe pastaj brezi tjetër le ta vazhdoj. Të bëhet si ni shtafetë që përcillet brez pas brezi derisa të fitohet ni ditë.

Ni gja ishte e sigurt që edhe ata të burgosur politik transmetonin bindjet e tyre që janë t'sigurt që Kosova do t'fitoj. Do t'fitoj herët e vonë, por do t'fitoj. Kjo bindje po ngjizej e po formohej edhe te të rinjtë. Unë e kisha fatin tim, jo veç që e kisha vllaun të burgosur por edhe që po rrija me bashkëvuajtësit edhe bashkëveprimtarët e tij që ishin aq të ngritur aq të formuar dhe që kisha çfarë të mësoja prej tyre. Domethënë ndikimi i brezave të t'burgosurve politik në formimin e brezave t'rinjë të luftës për çlirim ka qenë shumë i fuqishëm. Shumë i fuqishëm dhe i burgosuri politik atëherë është çmuar si një njeri që jo që osht' i tokës po që ka zbritë nga qielli dikund edhe ka ardhë mes nesh që do t'na shpëtoj.

Anita Susuri: Qysh ka qenë rrjedha e demonstratave '68-tes? Çka ju kujtohet juve?

Mehmet Hajrizi: Demonstrata e '68-tes nuk kom qenë, nuk kom qenë, nuk kom qenë i organizuar atëherë nuk kom qenë. Kur ka ndodhë demonstrata për fat t'keq unë s'kom marrë pjesë as në demonstratë. Sepse kom qenë nja ni muj e gjysë a dy në spital. Nga spitali pastaj kom marrë vesh prej

ndonjë doktori, prej ndonjë infermieri çka po ndodhë, si po vete puna edhe nga familja që kanë ardhë t'më vizitojnë. Kam qenë në spital ktu në Prishtinë. Një problem shëndetësor që ndodhi atëherë, serioz ishte por që kaloj. Mirëpo m'la pa shku n'burg atëherë (qeshë). Pastaj fill pas demonstratave atëherë nisëm ne me mendu seriozisht për ni organizim.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Zoti Mehmet, ishit t'u na tregu për fillet e organizimit. A keni mendu mbas vitit '68, mas demonstratave, ose jeni inspiru për me formu ni organizatë t'jujen? Qysh ka fillu gjithçka?

Mehmet Hajrizi: Fill pas demonstratave të '68-tes, unë po flas për veten time, njëherë kam qenë i inspirun që të organizohemi disi. Kisha ato ndikimet e ma hershme siç fola. Kisha ni përvojë që kisha marrë prej tyre pak a shumë që m'dukej se do t'më shërbente. Kisha njerëz që ishin gati të organizoheshin, që i njëfsha dhe nisëm ne po bisedonim për mundësitë e një organizimi dhe nisëm nga pak të bëjmë diçka po jo, jo për t'i dhënë formë organizimit, për t'i dhënë emër e status e për t'i dhënë program e qëllime e të tjera. Por po vepronim.

Dikur u bom edhe si [e pakuptimtë] të ngushtë, që t'bohen celula që i qunim atëherë nga tre vet. Por kishim kuptuar që organizime të tilla po ndodhnin edhe me të tjerët, jo vetëm me neve. Kishim kontakte me ta. Një veprim për shembull në vitin 1969 në ni vjetorin e demonstratave të '68-tes, disa të rinjë kishin pasur idenë që duhej të bëjmë një trakt dhe ta shpërndajmë në, jo vetëm te studentët por edhe te qytetarët e tjerë. Ishte Kadri Osmani, Binak Ulaj e Xhafer Shatri. Edhe do tjerë që e shpërndan dhe meniherë u kapën u burgosën dhe u dënun me nga disa muj deri dhjetë muj dhe e mbarun dënimin.

Ne hym në kontakt me ta. Ata kishin bërë edhe disa veprime përpara si fillim të organizimit. Tash kishim edhe nifar' bashkërenditje nifar' bashkëpunimi. Nifar' shkëmbim i përvojave, dokumenteve, materialeve, libra. Se vinin atëherë libra fshehtas nga Shqipëria që ishin të ndaluar këtu dhe pastaj u jipnim ne. Ata na jipnin gjithashtu dhe kishim nifar' bashkëpunimi. Kshtu deri në fillim të vitit 1973. Në fillim të vitit 1973 ne po bisedonim për t'i bashkuar kto grupe t'vogla të përndara dhe të veprimeve secili n'veti. Ta bëjmë një organizatë më vete të përbashkët, unike.

U mblodhëm, u mblodhëm me 03 mars të vitit 1973 në ni shtëpi jo larg ktu ku jemi ne. Që nesër do t'vendoset ni pllakë përkujtimore në të për të shënuar 50 vjetorin e këtij themelimi për të cilin po flas. U mblodhëm, u mblodhëm përfaqësuesit e atyre organizime të përndara që kishin pasë. Unë isha dërguar nga kolegët e mi me t'cilët punonim që t'shkoj në këtë mbledhje të bashkimit. Aty ishte edhe Kadri Osmani, ishte Xhafer Shatri, Binak Ulaj edhe një Feriz Seferaj. I cili ma vonë, domethonë, për arsyet e veta u tërhoq nga organizimi edhe... po fillimisht ka veprua bashkë me ne.

Ne aty u morëm u morëm vesh që ta bëjmë bashkimin, ta themelojmë organizatën dhe i vum emrin Grupi Revolucionar i Kosovës. Këtë revolucionar e kishim dëgjuar edhe te praktika e Komitetit Revolucionar që foli në të '60-tën edhe te Lëvizja LRSh, Lëvizja Revolucionare e Adem Demaçit. Me Adem Demaçin në krye. E kështu me radhë. Dhe karakterin revolucionar po e runim edhe ne në emërtimin që në emërtimin e organizatës.

Po cili ishte kuptimi i këtij revolucioni. Ishte kuptimi i një revolucioni nacional çlirimtar. Se kishte atëherë revolucion proletar, komunist, socialist që po bohej. Ka edhe revolucion shkencor, ka edhe revolucion teknik, ka plot revolucione. Po edhe shoqëria ka revolucionet e veta. Tipet e veta. Nja katër a pesë për shembull. Njëri prej tyre është revolucioni nacional çlirimtar. Atëherë e kanë qujtë revolucion kulturor për shembull, të tij, kur e ka bërë atë gërrdin atëherë me të. E kështu me radhë.

Aty vendosëm atë ditë që kjo organizatë e jona ta ket' shtypin e vet klandestin, shtypin e vet msheft. Për herë t'parë në Lëvizjen Kombëtare të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore po vendosej që t'kemi ni organ të shtypit. Kjo praktikë s'ishte, nuk osht' përdorë kërkund. Aty vendosëm ne gjithashtu të formojmë në kuadër të Grupit Revolucionar të Kosovës një komitet që quhej Komiteti i Studentëve.

Qëllimi ynë ishte që ta bëjmë një komitet për udhëheqjen e studentëve në Lëvizjen Çlirimtare sepse ishte forcë motorike. Si të thush shtresa shoqërore e studentëve të Kosovës. Ishin ma të gatshmit që t'hyjnë këtij rreziku, ishin edhe të pregaditur, si intelektual. Përspektiva, fundi i fundit, i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare qëndronte aty te ata. Prandaj dëshironim që atje të organizojmë më shumë, më shumë me ata të organizojmë punën.

Vendosëm që të shpërndajmë trakte. Trakte politike si pjesë e shtypit klandestin. Fillim mëniherë me ni trakt që e bam për studentët ku i bonim thirrje studentëve që, jo për Republikën e Kosovës, por për kushtet e jetës së tyre, kushtet e studimeve e tjera e tjera. Që ishin në krahasim me studentët e republikave të tjera shumë të diskriminuar.

Anita Susuri: Po për kto traktet po du me ju pytë, po ju ndërprej, qysh jeni organizu për m'i shtypë? A keni pasë makina? Si i keni siguruar kto?

Mehmet Hajrizi: Edhe traktet edhe këtë organin e shtypit... organin e shtypit mendum ta quajmë Zëri i Kosovës. Dhe do ta tregoj për herë t'parë ndoshta si erdhi deri te ky propozim. Unë kisha mbaruar Shkollën Normale në vitin 1970 dhe shkova të konkuroj diku në punë, familjen e kisha në gjendje jo t'mirë ekonomike. Dëshiroja të punoja dhe njëkohësisht të vazhdoj studimet për gjuhë. Pata regjistru fakultetin atëherë. Më kishin pranuar në Magurë të Lipjanit. Magurja është një qytezë në komunën e Lipjanit. Më kishin pranuar në punë.

Shkova atje të shikoj dhe po shihja shkollën, po shihja nxënësit, po shihja koridorin. Koridori pashe disa fleta të ngjitura nëpër muri. Thanë, 'Kjo është gazeta e murit, e nxanësve të shkollës tonë'. E kishte

themeluar një Gani Xhafolli. Ni shkrimtarë për fmi kryesisht dhe pastaj jam njoftë me të ma mirë. “Si quhet kjo gazeta ju?” Thashë, tha, “Zëri i Kosovës”. M’pëlqej shumë. M’pëlqej. Ishte, edhe e kishte pak ni analogji me Zërin e Popullit në Shqipëri që po bahej. Atje Zëri i Popullit. Zëri i Kosovës m’u duk edhe ma mirë bile i formuluar.

Kur erdh puna të vendosim për, për organin e shtypit unë e kisha mbajhtë n’mend nga viti 1970 atë gazetën e murit atje. Po ju thom, “Propozimi im është që organi im i shtypit të quhet ‘Zëri i Kosovës’”. Kërkush nuk e kundërshtoj, t’gjithëve ju pëlqej edhe mbet Zëri i Kosovës. Për herë t’parë doli Zëri i Kosovës. Pastaj Zëri i Kosovës është botuar në vijmësi edhe nga LPK-ja me vite të tëra edhe para saj edhe nga Jusuf Gërvalla nga dy numra, tre numra, s’di sa i ka nxjerrë me këtë emër, gazetën e vet. E kshtu me radhë.

Po u vendos, u vendos ashtu me Zërin e Kosovës. Po si t’i bëjmë tash kto traktet që të shumëzosh me qindra kopje, mijëra kopje. Si të shumëzosh tash Zërin e Kosovës që nxirret ajo si revistë të duket. Sigurisht jo kualiteti kolor e tjera e tjera, larg asaj. Po bardh e zi ishte me një ballinë ku vizatohej n’të. Një grafikë domethënëse domethënë. I bëm, i bëm kto. Fillimisht kemi bërë vet me dorë një shumëzues me një bez e cila lyhej pastaj me ngjyrë. Me atë letrën kopjuese edhe shtypnim n’makinë në atë letrën e dyllit e pastaj me një cilindër e shtypnim dhe me dorë.

Ngadalë bëhej kjo punë. Nuk ishte kushedi sa cilësore po sidoqoftë u nis ni punë me ni mjet, me ni fakturë i punuar kshtu. Nuk na ecte puna aq mirë me të. M’duket me të mos kemi përdorë nga dy raste a tri, jo ma shumë. Pastaj na duhej atëherë ishin dy makina që mund t’përdorehin për këso punë. I thojshin, njo ma e vogël që mund t’sillej me dorë, gështetner, sigurisht emërtim gjerman duhej t’jetë. Dhe një tjetër, shtaptilograf që ishte ma i avancuar dhe punonte me korent. Ishte shumë ma i shpejt. Nxirrje kopje sa t’dush me të.

Mirë. Ktë nuk mund ta bleje sepse duhej leje e veçantë që të mund ta kishte ktë. Institucionet kishin ksi, organizatat e ndryshme kishin. Ne s’na mbetë zgjidhje tjetër përveçse t’shkojmë t’hyjmë në ato institucione fshehurazi dhe t’i rrëmbejmë. Kanë hyrë veprimtarë të ndryshëm të armatosur kanë hyrë brenda dhe i kanë rrëmbyer ato pa pasë asni pasojë asniherë, as me rojtarin. Aq me kujdes kanë hyrë brenda. I kanë mbarrë, i kanë qit’ n’krahë dhe i kemi dërguar nëpër baza. Pastaj i kemi punuar me to. Me to kemi punuar.

Mu m’vjen keq që ato shtaptilografe dhe aato gështetner që i ka policia, i ka marrë atëherë policia, i ka konfiskua dikund janë sot. Do t’duhej ata gështetner, ata shtaptilografë të nxirren aty ku janë, në çfarë gjendje që janë dhe të dërgohen në muze. Se edhe ajo ka qenë ni lloj arme që s’ka derdh plumba. Po ka, ka përhapë ide çlirimtare. Ka përhapë ide ndikuese të zgjidhimit shqiptarë. Nuk di, nuk di ku janë. Mund t’jenë diku nëpër podrumet e naj gjykate, sekretariatit të punëve të brendshme a, nuk di.

Po të isha i lumtur sikur ato të mblidhen, jo vetëm ato, po edhe çdo dokument, çdo veprim që është bërë. Edhe ato revole që i kanë përdorë njerëzit, që thashë, që s'i gjen dot njeriu që të dërgoheshin t'mbaheshin me ni muze dikund. Se jemi te revolja, ky djali i vllaut tim që ka qenë i organizuar edhe kty në demonstratë, kur ishte n'burg kishte lënë ni revole t'fshehur në oborr te vllau im n'dhe.

Derisa ishte n'burg i thotë vllaut në vizitë, thotë, "A e keni nxjerrë ata prej kopshtit? Nxirrne se e prish dimri në qoftëse s'e nxirrni herët". Vllau e kupton mesazhin. Ai po i thoshte që shikoni se gjatë hallakatjes së dheut do t'gjeni atje një revole t'fshehur n'dhe. Vjen vllau ktu dhe i hin kopshtit t'vet, e shkapurit dheun e gërmon dhe e gjen një enë në të cilën kishin mshefë materiale.

Ne kemi përdorë sistemin e enëve plastike hermetikisht të mbyllura dhe kemi fut materialet dhe ksi fuqi të plastikes për turshi që marrin njerëzit atëherë. I futshim thellë në dhe, për shembull, maje Gërmisë dikund atje. E mbushnim plot materiale që ti kur t'dush t'shkosh t'i marrësh ato dhe t'i kthesh përsëri aty. Ishin si bazë domethanë.

Anita Susuri: E qysh e keni ditë ku osht' bash vendi? A keni lanë naj shenjë a diçka?

Mehmet Hajrizi: Po, u dashke me mbajtë mend. Tash unë po ta thom një dru që mund ndodhë që ia kishe thy dikund ni rrem. Kurse vendi aty ku ishte na e vendosnim edhe ni gur përmi të që ta mbroje. Pastaj dheun edhe dushkun. Kurqysh nuk dihej ku osht'. Kurse vendi ku hyjnim ishte plot therra dhe plot gllusha, që nuk t'hynte gjithkush aty. Sepse kishte rrezik që t'i gjejnë baritë a t'i gjejnë kalimtarët e rastit, a ku ta di unë. Jo, ne hynim i bënim ato aty ku s'mund t'hyjë njeriu për shkak t'gjithë atyne therrave që t'gërvishnin dhe na përgjaknim kur hynim të nxjerrim diçka ose të lëjmë diçka n'to.

Vllau duke gërmuar nëpër oborr t'vetin, baba i Naser Hajrizit i dëshmorit të '81-shit. E gjen një ksi far' ene edhe e nxjerrë atë. Kur shkon atje thotë, "A i nxorre patatet?" Ky thotë, "Po i kemi nxjerrë edhe mirë shumë", mirë shumë se e kish gjetë këtë enën po jo revolën, jo revolën. Se si e ka gjetë enën ka thanë e gjeta çka ka thanë ai, e kreve porosinë. S'ka kërku ma shumë. Gjithnji ky Jahir e ka emnin, Jahir Hajrizi, Jahiri mendon që e kanë gjetë dhe rrin i qetë. Kur del nga burgu, mas nja tetë vjetve, vjen edhe i thotë, "Si kish qenë revolja?" "Jo revole s'kom nxjerrë, s'kom gjetë revole", "Po çka ke gjetë?" Thotë, "Unë kom gjetë materiale, kom gjetë shkrime, libra", "Aha s'osht' kërkund".

Shkon Jahiri edhe e gjen. E gjen po kishin kalu tetë-nantë vjet gjatë kësaj kohe. Kur e nxjerrë kishte hyrë uji edhe ishte bërë krejt ndryshk. Nuk kishte gjë prej saj. Domethënë mbaheshin edhe në kso baza të vogla. Po kishin edhe shtëpi bazë që ishin ma t'rrezikuara ato. Sepse e merrje me qera një banesë kishe jom student e po banoj aty. Mirëpo lajshin materiale dhe e mbyllnim atë aq mirë sa t'mos mund ta gjej askush atë vend.

Unë për shembull kam shkruar në shtëpi natën. Kryesisht natën m'u ka dashtë të shkruaj për shtypin klandestin, për traktet e tjerë e tjerë. Atëherë ora 03:00 t'natës kur mbaroja shkrimin, se prej orës 03:00

deri në ora 06:00 osht' rreziku që të ndërhynte policia. Nuk kisha mundësi që të shkoja në baza ta dërgoj ta la atje. Sepse zbardhte drita verës. Po shtëpinë atëherë unë e kom pasë jo ktu, po poshtë n'qytet.

Dhoma ku isha unë ishte me një tullë e gjysë, muri shumë i gjerë. Aty ishte ndërprerësi i rrymës për të ndezë dritat. E kisha nxjerrë ndërprerësin e kisha shpu murin thellë sa e nxinte A4-shin po ta kthesh në anën e ngushtë domethonë. E kisha bo ni vrimë rrumbullak deri para se me dalë në anën tjetër. Aty e vendosja shkrimin që kisha ba natën. Pastaj e mbyllja atë me copa tullash e ku ta di unë që t'mos duket. Pastaj, e vendosja përsëri kutinë e ndërprerësit t'rrymës aty sepse konsideroja që kur t'vijnë policia nuk guxojnë t'i shtijnë dur të aty ku osht' rryma, ku osht' kjo e ku ta di unë.

Ka qenë një mënyrë e sigurt për mua dhe origjinale. Kadri Zeka, një bashkëveprimtar i imi derisa po folnim për mënyrën si t'ruhen, po kishim dëshirë që secili ta kem mënyrën origjinale të ruajtjes. Se po shkun e arrestuan dikë dhe e gjetën pastaj do t'kërkonin te t'gjithë atë mënyrë të fshehjes. Po bisedonim niherë si mund të mshifet. Kadri Zeka e dini ju që është vlarë pastaj në vitin 1982 me 17 janar bashkë me Jusuf Gërvallën dhe vllaun e tij Bardhoshin. Në Untergruppenbach të Gjermanisë. Osht' vra nga UDB-ja jugosllave.

Po m'thotë me ni rast, "Kom menduar që mënyra për ta mshefur shpejt e shpejt ni material është që aty ku osht' priza ose ku osht' ndërprerësi aty t'bohet ni vrim edhe të futen materialet derisa t'kaloj". Ishte koinjencë e idesë t'tij me idenë time që unë tash po e aplikoja këtë. Thashë, "Le atë ide" (qeshë) "le atë ide se osht' e konsumuar. U kry kjo punë". Kshtu domethonë janë ruajtur materialet, janë shumëzuar dhe janë shpërndarë pastaj natën. Zakonisht natën vonë dikund prej orës 01:00 deri në 02:00 se edhe shumë shumë nuk mund të zgjasë kjo.

Se në qoftëse të bije dikush në gjurmë ose mund të dalë dikush që e lajmëron policinë edhe të thotë, "Para derës time ka ardhë ni trakt", ata pastaj do t'vraponin sigurisht të gjenin mos janë duke shpërndarë ende rrugëve. Ishte gjithmonë rreziku ishte domethanë. Po njerëzit ishin të armatosur dhe në qoftëse do t'shihnin që po vijnë policia që të kapin, ti sa ishte e mundur me atë armë të siguroheshe që të shmangesh dikund dhe të humbësh gjurmët.

Në takime për shembull, në takimet tona, ka ardhë dikush nga Drenasi, dikush nga Gjakova, dikush nga Peja. Nuk jemi takuar në qytet, as nuk jemi takuar në banesën bazë ku do t'mbanim mbledhjet, jo. Fillimisht u dashtë të shkoje në Malet e Gërmisë e atje t'bëje ni xhiro t'mirë natën. Sepse ky spiuni që t'vje ty mrapa kur ti hyje në mal atje nuk do t'vinte pas teje. Sepse do t'mendonte që ti po e ndjellë që t'vije dhe t'i laje hesapet diku me të në bjeshkë. Prandaj, ata do të ktheheshin se s'rrezikonte asnjëri prej tyre ashtu me t'ardhë ty deri në fund me t'përcjellë. Pastaj edhe përcjellja do t'bëhej e dukshme. Nëpër qytet t'përcjellë po ti s'din cili osht' ai që po të ndjekë. Qytetar...

Anita Susuri: Po ka shumë njerëz n'rrugë.

Mehmet Hajrizi: Ashtu. Prej atje pastaj u dashke deri dikund tjetër e ndonjë herë për siguri u dashke të hyje nëpër lum, nëpër ujë. Me qëllim që as me qen ata t'mos mund të ndjekun ty. Se lumi i humb gjurmët e qenit. Ose mbanim biber me veti dhe duke ecur mund të hidhje diçka mrapa nga ai që t'ja humb nuhatjen qenit që të ndjekë. Po edhe nëpër ujë shumë herë më është dashtë të hyj nëpër ujë, nëpër lum që t'dalësh dikund tjetër krejt dhe pastaj t'shkojsh asfaltit që edhe era e karburanteve ta humb erën tënde dhe ta evitosh. Pastaj të shkosh deri atje.

T'i thush sot një të riju që ki me mbajtë mbledhje, ai thotë punë e madhe jeni mbledhë jeni knaqë, keni bo muhabetm jeni shpërnda n'fund. Po nuk mund ta imagjinoj as ta kuptoj ai sa shumë kujdes duhej për atë mbledhje dhe ti i dërrmuar vishe nga lodhja duke bërë xhiro andej e këndej për të ardhë i sigurt në banesën ku mbahej mbledhja. Aty në bazë mbyllej dritarja ashtuqë t'mos dukej drita jashtë, një. E dyta vendosej zakonisht në dritare muzikë që në qoftëse vjen dikush dhe don të inxhizoj, të regjistroj diçka nëpërmjet dritares çka po flitet brenda t'ja bosh të pamundur ti me zhurmën që bën kjo.

Dritarja mbyllej që t'mos dukej nga larg drita se ai po vinte afër dritarës e dëgjonte edhe muzikën. Që mund t'mendonte që dikush... muzikë jo kushedi çfare të rëndësishme domethonë. Një muzikë që mund ta dëgjoj çdo i ri natën. Brenda në mbledhje kishim ato armët e lehta domethonë, ato revolet me t'cilat mendohej që mund të shpërthehet se me to ti s'mund t'i ktheje ekspeditat policore me 30 ose 40 a 50 vet kur vinin ata me armë të gjata edhe njerëz të njërive speciale që... nuk mund t'i bësh me ni revole asgjë atij.

Por që ta shpëtojmë vetën, që t'dalim nga rrethimi, nga situata. Gjithmonë e kem pasë ndonjë dalje tjetër jo nga dera e hymjes por diku tjetër për t'dalë jashtë. Janë bërë bunker edhe brenda në shtëpi. Ka ndodhë që kurrë nuk janë zbuluar. Rexhep Mala për shembull njëri prej veprimtarëve të organizatës tonë ka bërë në bunker në shtëpinë e tij nën dhe, brenda në shtëpi. Është bastisur ajo shtëpi me dhjetra herë jo një herë apo dy herë por me dhjetra herë osht' bastisur. Kurrë nuk kanë gjetë bunkerin që kishte punuar Rexhepi në shtëpinë e tij.

Jo vetëm aty. Janë bërë edhe në vende tjera. Mënyra të ruajtjes së materialeve ndër më të ndryshmet që unë nuk du ta zgjas ma shumë por e mora në shembull. Por shembuj ndër ma të ndryshëm, ma të çuditshmet që vështirë t'i shkoj njeriut mendja. Por, si të thush nevoja e ka bërë gjithë këtë zhvillim teknik e teknologjik në historinë e njerëzimit. Nevoja, nevoja për rrotën është zbulu rrota, e tjerë e tjerë. Dhe nevoja të mson, është msuesi ma i mirë. Të mson çfarë duhesh të bësh në ni rrethanë të caktuar. Si mund të gjindesh dhe si mund ta zgjidhësh problemin. Kaq do të thosha për bazat edhe për ruajtjen e shpërndarjen e materialeve

Pjesa e Katërt

Mehmet Hajrizi: Në themelimin e organizatës me 03 mars 1973 ne formuam një organ udhëheqës të organizatës. Pastaj vendosëm që të formojmë siç thashë komitetin e studentëve. Vendosëm që të formojmë edhe komitetet lokale nëpër qytetet e Kosovës. Vendosëm që të bëjmë edhe dokumentat programor dhe statutor që evidentojnë qëllimin që përcaktojnë qëllimin. Qëllimin e fundit dhe domethonë strategjik dhe qëllimet tona taktike të arritjes të disa fitoreve ma t'voglë gjatë rrugës për të shkuar deri tek ati final.

Vendosëm për mënyrën e organizimit dhe të punës. Duke vënë në epiqendër disiplinën dhe konsipracionin. Domethonë fshehtësinë e thellë në veprimtari. Sepse kishim të bënim me një organizatë, ta quaj organizatë, UDB-në. Në institucion të sigurisë ndër ma të sofistikuarit në botë. Nga... kam dëgjuar pastaj që, në burg bile, nga një hetues bile, thotë, "Shumica e vendeve të pa angazhuara të botës", thotë, "kanë marrë instruksione për formimin e shërbimeve të tyre të sigurimit prej nesh", prej Jugosllavisë.

Sepse kanë qenë shumë, shumë mirë të përgaditura. Nuk ka qenë e lehtë t'i përballosh ndjekjes policore sekrete serbe e jugosllave. Prandaj, organizatat nuk mund të zgjasnin më shumë veprimtarinë se një vit, një vit e gjysë, dy vjet. Duke parë përvojën e së kaluarës ne vendosëm që të jemi rigoroz në këto dy binar. Në disiplinën dhe konsipracionin në të cilën lokomotiva jonë do t'shkonte drejt destinacionit. Bëm, bëm këtë punë.

Jo vetëm në aspektin teorik, jo vetëm në udhëzimet që jipeshin çdo ditë por edhe në veprimtarinë praktike që neve na zgjati jetën deri në vitin 1982 kur në pjesë e kësaj organizate u dënua. Udhëheqja po thuajse e tëra ra në burg. Por që mbeti pjesa më e madhe e anëtarësisë jashtë, sidomos në mërgatë, ku e kishim Kadri Zekën atëherë. Ai e mori në dorë pastaj organizimin dhe riorganizimin e kësaj organizate dhe që u bashku pastaj me organizatat të tjera dhe u themelua Lëvizja për Republikën e Shqipëtarëve në Jugosllavi.

Më vonë mori emrin LPK që është më e njohur tashmë LPK, që zgjati deri në mbarim të lutës dhe LPK-ja u bë si të thuhet iniciatorja dhe themeluesja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Do të thotë që ato idetë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që lufta t'jetë për çlirimin dhe bashkimin kombëtar dhe kjo luftë të nis me mjetet paqësore dhe me veprimtarinë propagandistike në kuptimin pozitiv të shpërndarjes së ideve dhe të lirisë. Në kuptimin agjitativ për t'i përvetësuar njerëzit në këto ide, për t'ju bashkuar këto ideve. Në fund edhe me mjetin e fundit, me formën e luftës si kryengritje popullore për t'u shpërliruar.

Organizata pati një goditje të rëndë në vitin 1974, '74. Në Zërin e Kosovës e përgaditëm gjatë vitit '73 pasi sapo u themelua filluan përgaditjet por vetëm me 01 shkurt të vitit '74 e botuam numrin e parë të Zërit të Kosovës. Pastaj numrin e dytë në pas një muaji po m'duket a dy. Por... në prill m'duket po. Kurse në maj derisa po përgaditej numri tre i organizatës në shtëpinë e Kadri Osmanit që e kishim

zgjedhur si udhëheqës të organizatës. E ku ishte edhe Binak Ulaj njëri prej anëtarëve, udhëheqës i organizatës.

Duhej të shkoja edhe unë aty në mbrëmje. Ata kishin pasë shkuar më herët. Se janë njoftë e kanë punuar bashkë aq shumë nuk bënin konspiracion njëri me tjetrin. Shkova ma vonë. Kisha marrë me vete do kso që i kap letrat, do letra edhe do shkrime. Do shkrime që duhej shtypur atje pastaj dhe m'i fut pastaj në organin e shtypur, numrin tre. Doli shoqja e Kadri Osmanit bashkë me të bijën Hidajetën, Shukrie e kishte emrin e shoqja e Kadriut. Dolën n'derë. Më njëfishin te dyjat.

Thanë, "Para pak kohe e kanë arrestuar Kadriun bashkë me Binakun. Prandaj, ti mos hyr brenda ik meniherë dhe ki kujdes se kanë mbetë nja dy a tre a katër spiunësh. Qe ku janë, po duken aty ma poshtë", po ishte terrë atëherë dukej vetëm silureta e tyre. "Aty", tha, "janë t'u shiku janë n'derë kush po hyn e kush po del". Ishte e pamundur më. Unë ju thashë fjalët e rastit që duhet të thuhet ato raste që duhet t'jenë t'forta të qëndrojnë e kishin dy djem ata ma t'vegjël. Mbarova. Thashë, "Qito materiale futni në zjarrë meniherë e digjni", se thashë më kapen rrugës.

Edhe kto ato kapset ku ta di unë ata mund ta dinin pse i kam unë nëpër xhepa. Thashë, "Edhe kto merrni gjuni dikund e hiqni, zhdukni". Dola unë. Dola atëherë. Kjo ka qenë në Kodrën e Diellit që i thonë tash ka pasë shtëpi atëherë shumë aty. Prej shtëpisë të Kadriut deri dilje në gjade te kjo Furra Qerimi që i thonë sot, ka qenë krejt livadh, domethonë arë, nuk ka pasë shtëpi. Dola. Dola unë n'rrugë dhe erdh ni makinë. U nal. "Mirëmrara", "Mirëmrara", ishte errësirë. Tha, "Po shkoni ktej?" Unë isha, po shkoja te poshtë asfaltit. Tha, "Hajde, hajde", tha, "hyn brenda, hyn n'makinë", thashë, "Jo se nuk jam larg, ktu kthehem", "Po mirë", tha, "deri ku t'dush", tha, "në makinë se vet jam", "Jo", thashë, "faleminderit", "Hyn more", tha, "n'makinë".

Nuk hyra. E merrja me mend që mund të ishte... ata kishin folë me ata tjetrin dhe tash po shkojmë dhe ta kapnim. Po ishte vetëm ai. Ai ka marrë me mend që mund t'jem edhe i armatosur dhe isha i armatosur. Insistoj boll po nuk doli t'më kapkte me zor. Se ishim veç vet na aty, nuk kishte... shtëpi kishte domethonë që nuk ishin të kryera. Unë po vazhdoj po rri edhe pak pas tij. Kur shoh, ka qenë ni kryq i rrugëve aty, pikërisht te furra që po përmendi. Aty ni rrugë shkonte ktej {shpjegon me duar drejt} një tjetër andej {shpjegon me duar ana e djatht} një andej {shpjegon me duar ana e majt}. Kur e shoh aty jo ai tash vet po ishin bërë katër. Po rrinin kishte po bisedojnë në këmbë. I pashë.

Kom hyrë shpejt në ksi ndërtesë të pabanune, kom kalu atë, kom dalë ni tjetër, pastaj ni tjetër, ni tjetër, ni tjetër dhe kom dalë deri në Tauk Bahqe kto pishat që janë. Kom kalu edhe aty dhe jom ngjit kom shku në territorin e shliuar tonin, në thojza, në Gërmi. S'kanë mund të vijnë mrapa. Ndoshta kah kjo kam shpëtuar atë natë dhe jam kthy dikur vonë në shtëpi natën nëpër rrugica tjera. Kisha diçka nga materialet, libra se ksi materiale shkollore nuk kom bajtë hapur. I hoqa ato, u pastrova. Thashë në qoftëse vijnë t'më arrestojnë natën bile t'më gjejnë kshtu siç jam dhe t'tham që ai njeri atje që ju ka duk si unë, s'kam qenë unë. Pikë. Mos e prano bile.

Nuk erdh kërkush. Po çfarë ndodhi tash. Me udhëheqjen, udhëheqjen që kishim caktu, nuk mbeti kërkush pos meje. Mbete fikall vetëm. Çka t'bëj, si t'gjindem. Ta them sinqerisht, ndjenja nifar' nevojë shpirtërore t'jem edhe unë n'burg bashkë me veprimtarët e mi. Nga ana tjetër nuk e kisha të lehtë të veproja tash vetëm si ni udhëheqje, vet udhëheqje në ato kushte kur edhe vet isha i rrezikuar dhe pritsha çdo çast që do t'më kapin. Zëri i Kosovës numër tre që po pregaditej natën ishte kap...

Anita Susuri: Se në shtëpinë e tyre...

Mehmet Hajrizi: Në shtëpinë e tyre... jo kanë qenë duke punuar ata në tavolinë. Kur kanë pa që në dritare të kuzhinës po shikon ni polic brenda. Gruja e Kadriut e merr materialin e Zërit të Kosovës që po përgaditej dhe e fut në zjarr. A ai e sheh që futej në zjarr. I lajmëron kta tjerët, thotë, "Vraponi sepse u fut në zjarr materiali". Hyjnë forcat këndej dhe e nxjerrin prej zjarrit. Ishte djegë gjysma e revistës dhe sot në arkiv është e tillë, kshtu që është rrëmbyer. Po ajo ishte ni provë që e kishin ata n'dorë që mos t'mund të thojmë që ne po bënim muhabet edhe po flisnim për arat. U zu kjo.

Nga ana tjetër kishim ndërtuar unë edhe Kadriu në dhomën e bashkëshortëve ku flenin, kishim ndërtuar thellë, dy metra me dy një bunker. Pastaj, kishim rregulluar dyshtemenë që të vendoset diçka e fortë aty që kur shkel njeriu të mos jetë ndryshe nga pjesët e tjera. Kishim vendosë dyshtemenë, drrasa kanë qenë, në atë mënyrë që nuk dukej asgjë aty e dyshimt domethënë. E kishim rregullu aq mirë. Aty kishim vendosë makinën e shkrimit që po bëhej Zëri i Kosovës edhe traktet. Aty kishim vendosur ni ksi gështetner të dorës, aty kishim vendosur edhe ni shtaptilograf të madh që punonte me energji elektrike.

Kom marrë kontakt pastaj... kurse mbi atë bunkerin kishim vendosë shtratin ku flenin kta bashkëshortët. Kom marrë kontakt meniherë me vajzën e Kadriut, Hidajetën, për t'i thënë që, 'Veproni disi me dajtë', që e dinin që, shtaptilografin e kishim çuar fillimisht te dajtë. Ai shtaptilograf ishte rrëmbyer nga Rexhep Malaj me shoktë e tij. Na kishin nxjerrë në këtë far' parkun Tauk Bahqe që po i thonë, natën vonë dhe e morëm ne te tret. Kadriu, Xhaferi dhe unë. Në krah e kemi bartë deri lart atje te varrezat e dëshmorëve. Atje kishte mik, miqtë Kadriu dhe e vendosëm te ata. Ata janë kujdes për të.

Unë i thash ksaj, "Thirri ata dajtë tu që e dijnë shtaptilografin, e njohin se e kanë pasë n'shpi. T'vijne ta marrin ta kamuflojnë diqysh me do thas edhe ta hjekin prej aty zbrazni". Mirëpo nuk pati kohë që t'hiqej kjo. Ata mësuan ku ndodhen ato mjete dhe erdhën i morën. I morën përsëri domethënë krejt çka pat' në atë bazë. Në shtëpi. Kishin formuar ndërkohë komitetin e studentëve. Komitetin e studentëve kishin zgjedhë disa student.

Xhafer Shatrin patën thanë që ta dërgojmë aty nga udhëheqja. Aty ishte edhe Rexhep Mala, ishte Gani Sylja, ishte Ilmi Ramadani. Për ta riformu udhëheqjen edhe niherë që e qitem komitetin drejtues. Kshtu osht' qujtë udhëheqja e organizatës tonë. Fillimisht unë e mora nga komiteti i studentëve, se aty ishin

njerëzit, si të thush ma të zgjedhur nga, nga studentët anëtarët e organizatës. Kom ardhë në banesë të tyre dhe kemi vazhdu për ni kohë ne të dy bashkë me udhëheqje.

M'u ka dashtë mu kur jom kthyer nga Kadriu që t'mos mbetet përshtypje e keqe te anëtarët e organizatës se policia pat' arrestime dhe u bë kjo publike, dihej që kanë bo arrestime. T'mos mendojnë që kanë arrestu udhëheqjen e organizatës, që kshtu edhe kishte ndodhur. Përveç meje që kisha shpëtuar. Hajde ta bëjmë numrin vijues të numrit të Zërit të Kosovës shpejt e shpejt me artikuj të ri dhe ta shtypim shpejt. Jam ngut dhe kam shkruar tash me tri-katër pseudonime une të ndryshme. Sikur janë shumë autor të shkrimeve.

Problemi ishte tash i shtypjes dhe i shumëzimit. Osht' Gani Sylja ai që e ka marrë këtë punë me aq përkushtim dhe aq sakrificë sa ka shkruar i ka shtypë punimet e shkruara me dorë, u shku i ka shtypë maje berishe ni mal atje naltë ku UÇK-ja pat' vendosë shtabin dikur ma vonë. I futur në ni gmuzhë sikur ato bazat tona që t'mos e sheh askush aty duke punuar. Ditën se natën nuk do të shihej. Ditën ka punuar aty por nuk është dukur, kamufluat. Aty u ulë dhe aty i krrusur i ka shtypur të gjitha materialet dhe ka përgadit teknikisht krejt Zërin e Kosovës dhe kemi shpërnda te shokët. Fillimisht e shpërndamin brenda radhëve. Është shpërndara atje.

Pastaj kom dëgjuar që ata anëtarët e komitetit të studentëve kanë thënë që organizata jonë nuk qenka dëmtu s'osht' marrë kërkush sepse osht' qetësia, osht' niveli i Zërit të Kosovës qysh kanë qenë numrat e parë. Ktë e dinte vetëm Gani Sylja edhe unë që ishte bërë ashtu dhe nuk mund t'ja thonim të vërtetën. Ma vonë pastaj kemi tërheqë nga komiteti i studentëve edhe Hydajet Hysenin. Rexhep Malaj duhej të vinte në komitet drejtues por Rexhepi ishte rrezikuar shumë. Kishim plot indikacione që ai edhe vëzhgohej, survijohej edhe ndiqej. Kshtuqë nuk mund ta binim në udhëheqje sepse rrezikonim krejt organizatën pastaj.

Kjo ka qenë arsyeja e vetme domethonë pse Rexhep Mala nuk erdhi në udhëheqje atëherë. Ne u bom megjithatë tre dhe mirë shkonte puna. Ma vonë u kuptua edhe Kadri Zeka. Tashmë ne po funksiononim normalisht. Bëm disa numra të Zërit të Kosovës për dy-tri vjet dhe pastaj na mori mendja që nuk duhet ta botojmë ne Zërin e Kosovës. Sepse po t'gjindej ni ditë, po t'kapet dikund Zëri i Kosovës i vitit 1975 për shembull, ndërkohë që n'vitin '74 ishin kap njerëzit duke përgaditur pikërisht Zërin e Kosovës. Atëherë konkludimi ishte logjik dhe ish shumë i thjeshtë që ju jeni vazhdues të atyre që i kemi burgosë. Po juve s'ju kemi kap tash do t'ju kapim, a po jo?

I zhdukëm t'gjithë numrat që kishim që t'mos gjenden. Ndonjë edhe ka mbetë ndoshta diku, nuk e di, s'kom pasur rast ta gjej. Por, dhe artikuj megjithatë nuk i humbëm por i ribotuam në ni përmbledhje n'fund t'librit dhe e quajtëm Materiale. Materiale ishin diku 200 e tepër faqe të A4-shit. I përmbledhëm aty. Por kur e bom në formë të librit u bon dikund A5 m'duket. Bom ni tjetër tash organ, e qujtëm Pararoja. Tash kishim ndrru edhe emrin e organizatës. T'mos quhet më Grupi Revolucionar sepse e kishin zënë atë dhe vendosëm ni emër t'ri.

Ni emër që kishte ngjyra ideologjike, megjithëse ne nuk ishim aty për t'luftuar për ideologjinë. Ishim për çlirimin kombëtar. Po megjithatë mund t'ishte ndikim i Shqipërisë që ishte vend socialist markist-linivist. Pastaj kishte organizata kombëtare marksiste-liniviste që i parapagandonte Shqipëria me t'madhe. Pastaj kishte lufta dekolonizuese n'botë atëherë. Po shembej si t'thush sistemi kolonialist në botë atëherë dhe po shliroheshin popujt e kolonizuar dhe ne po dëgjonim që ata organizimin e tyre çlirimtar po e bëjnë sipas doktrinë së Marksit.

Ne mendonim, po atëherë pse edhe ne t'mos msojmë nga kjo doktrinë dhe organizata u qujt Marksiste Liniviste. Pastaj ma vonë nuk e lam as emërtimin grup po e qujtum Organizata Marksiste Liniviste e Kosovës, domethonë OMLK shkurt. Përse e quanim grup? Ne nuk ishim pak njerëz. Organizata ishte e shtrirë me vite se kish kohë ne që t'i zgjerojmë radhët. Ishte shtrirë me vite po dëshironim gjithnjë të quhet grup që në qoftëse të kapet ndonjë material nga policia ta shohin si grup dhe nuk e marrin aq seriozisht të ndiqet, sikur kur thoshe ti parti ose front ose emërtime t'mdha që tërhiqnin interesimin e syrit udbesk. Që t'vijne edhe të gjurmojnë edhe ta gjejnë ku osht' kjo organizatë aq e madhe.

Mernim emërtime modeste sikur nuk jemi shumë. Edhe kur ziheshin njerëzit ta zam me material n'dorë ai mund të pranonte që jemi ni grup po jemi grup prej tre vetësh. Shpëtonte organizata. Kshtu për shembull në vitin 1974 u arrestuan kta, nja gjashtë-shtatë vet t'u përfshi përveç ktyne treve në komitetin drejtues, edhe ndonjë anëtarë tjetër të komitetit të rrethit. Komitetit lokal. Siç ishte ni veprimtar i hershëm dhe shumë aktiv Jashar Alija edhe ndonjë tjetër. Po u arrestun edhe nja 60 vet dhe nuk u zbulu organizata. Për herë t'parë po ndodhte në praktikën e organizimeve klandestine çlirimtare të kapet udhëheqja, ta zam, ose shumica e udhëheqjes e t'mos zbulohet organizata.

Ne vazhdum veprimtarinë, u konsolidu udhëheqja n'rregull, komiteti i studentëve n'rregull gjithçka. Celulat po rriteshin, po zgjeroheshin. Organizata shkonte në të gjitha viset shqiptare. T'u përfshi Maqedoninë, Preshevën, Bujanovcin, Malin e Zi e tjera. Domethonë jo vetëm në Kosovë. Sepse ne në të gjitha trevat shqiptare i qunim me ni emër Kosovë. Domethonë duke përfshirë ktu edhe kto vise që i përmenda. Zgjerohet, ecte. Në vitin 1975 edhe niherë ne u goditëm nga milicia. Ksaj radhe u morën nja 13 a 14 anëtarë të organizatës tonë dhe u dënuan bashkë me Adem Demaçin. Edhe shumë të tjerë domethonë që s'ishin në organizatën tonë.

Adem Demaçi ka thanë ma vonë që, 'Asaj radhe unë nuk isha i organizuar, s'kom pasë kurfar' organizate, s'kom qenë i organizuar dhe m'kanë marrë vetëm e vetëm që t'ja bojmë qefin Beogradit ose që të evitojnë rrezikun që mos t'boj diçka në fshehtësi'. Po aty u morën pastaj njerëz ose që kishin rënë n'sy ose që kishin shkuar te Adem Demaçi për ta takuar. U arrestun jo pak po nja 13 a 14 s'jom i sigurt, po ktu osht' numri 13 ose 14. Anëtarë të organizatës tonë. U dëmtuam përsëri. Rexhep Malaj për shembull, Ilmi Ramadani ishin anëtarë të grupit të studentëve dhe tash atë grup... të komitetit të studentëve dhe atë komitet pas arrestimit të Xhaferit u udhëhiqte Rexhep Mala.

Ishte dëmtuar, ishte dëmtuar rëndë. Po megjithatë përsëri organizata nuk u zbulua. Përsëri u konsolidua sikur t'mos kishte ndodhur asgjë. U mbushën, u kompenzuan vakumet që kishin lënë atë dhe veprimtaria vazhdoi. Ka ndodhë pastaj edhe arrestime tjera individuale të njërit ose dy vetve e tre vetve. Janë dënu po organizata nuk osht' zbuluar. Në vitin 1981 kur kanë filluar arrestimet e udhëheqjes të OMLK-së tash nuk kanë mund t'i gjejnë t'gjithë.

Po udhëheqja u mor', përveç Kadri Zekës. Kadri Zeka ishte anëtarë i komitetit drejtues por ishte jashtë. Ne kishim formu edhe ni komitet ekzekutiv e quanim. Na merrte menja që ky komiteti ekzekutiv duhej të ishte për çdo rast. Po të ndodhë që të kapej komiteti drejtues te ni mbledhje, për shembull, ata meniherë t'marrin rolin e komitetit drejtues dhe po përgaditnim zëvendësimin tonë. Atje në komitetin ekzekutiv ishte për shembull pos të tjerëve edhe Saime Isufi. Ni veprimtare e njohur tashmë jeton në Zvicërr.

Pjesa e Pestë

Mehmet Hajrizi: Nji ndër kto arrestime sistematike që bëheshin organizatës sonë, por pa e zbuluar asnjëherë organizatën, ndodhi edhe me 21 dhjetor të vitit 1979. Kishte nji para histori ky arrestim. Dy muj përpara ose ma pak, kishte ardhë Josip Broz Tito në ni vizitë pompoze në Kosovë dhe ne sa kuptonim qëllimi i tij kryesor ishte që t'i mobilizonte njerëzit e vet ktu të sistemit politik e policor që të luftonin më me energji lëvizjen kombëtare e cila po zgjerohej në rrathë koncentrik në Kosovë. Sepse i duhej regjimit që të burgoste vazhdimisht njerëz. Ata konsideronin që po zgjerohet shumë lëvizja.

Kjo ishte porosia kryesore që po lente Titoja atëherë kur qe ktu. Qëndroj sa kohë edhe la porositë dhe shkoj. Ne mendum se nuk mund t'kalohet kjo ngjarje pa ni trakt politik që ta shpërndanim në, ndër qytetarët. E bëm traktin ma t'gjatë se që kishim bërë zakonisht. E demaskuam si të thuash jo vetëm vizitën e tij, se s'kishte ardhë për t'mirën e Kosovës por për t'keqën e Kosovës. E tham të vërtetën. Dhe e kishim bërë që t'jau jepnim këtë të vërtetë t'jua japim qytetarëve që ata ta dijnë, ta dijnë përse erdh, përse erdh ai njeri.

Trakti u shpërnda në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës për njëherësh. Në Mitrovicë, në Pejë, në Gjakovë, në Prishtinë, në Gjilan, në Ferizaj m'duket. Në të gjitha qytetet, në të gjitha qytetet kryesore u shpërnda në të njejtën orë. Po ndoshta as ne s'duhej ta bënim kshtu por e bëm ashtu që t'i kundërpëgjigjemi që lëvizja kombëtare osht' aq e gjerë dhe gjithandej që nuk mund ta shkatërroi, nuk mund ta burgosni. Po qëllimi kryesor i joni ishte që ta informojmë drejt, objektivisht për atë vizitë, për përmbajtjen e asaj qytetarin tonë.

Po mbase edhe kjo e dyta diçka kishte të vërtetë. U shpërnda edhe kjo bëri bujë shumë t'madhe. Domethonë qenka organizimi shumë, shumë i gjerë. Pastaj, i hyn arrestimeve. Nuk dinin kush, kush mund ta ketë bërë këtë por arrestonin njerëz ku dyshonin ata. Pas shpërndarjes së këtij trakti filluan

arrestimet. Arrestimet në masë pa pasë ni adresë, pa ditur nga kush ishte shpërnda. Arrestuan sidomos veprimar të Lëvizjes Nacional Çlirimtare. Ni organizatë që kishte themeluar Metush Krasniqi dhe e udhëheqte. Disa, disa anëtarë të saj. Në mesin e të cilëve ishte edhe Jusuf Gërvalla që nuk u arrestua po iku dhe emigroi jashtë në Gjermani.

U arrestuam edhe unë e Gani Sylaj në shtëpinë time. Me 21 dhjetor 1979. Atje po zhvilloheshin hetime për dy muj rresht dhe unë e vreja që ata nuk po dijnë për organizatë por kërkonin prej secilit që e merrshin të pranoj se i përket ni organizate, ku ta di unë. Nuk doli asgjë...

Anita Susuri: Po fillimisht si ka ndodhë arrestimi?

Mehmet Hajrizi: Ganiun pastaj e dërguan në Shkup ku e lidhën me ni tjetër koleg të tij gjithashtu që po organizonte Ganiu. I dënuan atje për propagandë e për organizim. Ganiun e dënuan me gjashtë vjet. Tek unë u bonën dënimet dy muaj, nuk, nuk gjetën ndonjë lidhje, nuk doli gjë dhe më liruan. Pa fakte ishin. Më dënuan për propagandë 133 ka qenë ni nen i Kodit Penal atëherë. Nejse ata dy muj i mbajta dhe dola nga burgu. Kshtuqë organizata përsëri mbeti.

Si ndodhi arrestimi më pyete. Ka pasur ni bashkëveprimtar të Kumanovës Gani Sylaj. Osht' quajtur Muharrem Shaljani. Me Muharrem Shaljanin kanë qenë bashkë kta ushtarë dhe kanë filluar organizimin. Ka shkuar disa herë Ganiu te ai, ka ardhë edhe ai disa herë u takua ktu në Prishtinë me Gani Sylën. Me 21 dhjetor 1979 ka ardhë Muharremi ktu të takohet me Ganiun në Prishtinë. Muharremi paska qenë i përcjellur nga UDB-ja maqedone tërë kohën. Atë ditë e kanë përcjellë prej shtëpisë t'tij kur është nisur e ka ardhur këndejeri ktu.

Takimin e kanë lënë dikund te spitali i vjetër i mushkërive. Kanë prit njërin, s'po di cili e ka prit t'shoqin, po nuk kanë mujtë me ardhë n'kontakt edhe janë shpërnda te dyt. Kta kishin qenë të përgjuem nga policia sekrete maqedonase. Deri aty e kanë përcjellë Muharremin dhe e kanë pa me kënd po takohet që po shkon në Prishtinë. E kanë pa edhe Ganiun tash që n'vendi ku ai kishte prituri ni kohë, ky tash po priste aty që të takohet. Ganiu mbaron, dështon domethonë takimi dhe niset t'vijë te unë.

Ganiu ka qenë vlla i Haxherës, i shoqes sime. Prandaj meqenëse ishte vonë dhe s'kishte lidhje që t'shkonte në shtëpi, në Kishnarekë të Drenicës ai erdhi te ne. Erdhi te ne por prapa i kishte përcjellësit tasht. Tasht ku po shkon ky. Kur vijnë te unë aty ne po rrijmë, po bajmë muhabet erdhën forcat policore të armatosur deri në dhomë, nja, sigurisht nja 40 prej tyre kanë qenë atë natë aty. Unë kisha shtëpinë jo ktu po poshtë n'qytet. Hyjnë brenda në oborr, ne nuk e hapëm derën. Unë i kisha dy fmi t'vegjël në dhomë ku ishim.

Nuk e hapëm derën por një mundësi për të dalë jashtë shtëpisë mrapa edhe për t'ju shpëtuar, për të ikur nuk na u dha. Na dolën pengesa. Hyjnë brenda ata. Hyjnë brenda dhe na arrestuan. Jo vetëm mua, jo vetëm Ganiun por edhe vllaun tim që kishim qenë bashkë me të edhe një djalë të tij që ishte 13 vjeç

a 14. Ky djali ish zhvillu, ish i gjatë dhe ju ka dukë si burrë. Pastaj me këtë veshjen me kapelë në kokë e ku ta di unë. Edhe atë e arrestun. Po na çojnë n'burg.

Kur shkum në shkalltë e sekretariatit të punëve të brendshme që t'hyjmë brenda, po ngjiteshim shkallëve përpjet vllau Zeqiri që kishte qenë i burgosur përpara që folëm për t'i dhënë pak kurajo që t'mos i frikësohet djali, ishte fmi. U kthye i tha, "He Fadil he u bone me ardhë me ne ktu". Polici mrapa i tha, "Mos fol nuk lejohet", tha, "me folë, kush t'tha me folë?" E tjera bërtiti. Mirë. Ky e kryjti t'vetin me Fadilin, djalin e vet.

Shkum brenda. Atë natë i kanë mbajttë ata n'burg. E kishin arrestuar edhe një vlla timin ktu. Këtë e kanë lshu ma herët natën, dikur kah mëngjesi. Zeqirin ma vonë se ky edhe ka qenë i burgosur tani kanë dashtë ta hallakasin kah pak. E lshojnë edhe këtë djalin e tina vetëm unë e Ganiu aty. Une siç thashë më mbajttën aq sa më mbajttën. Në mungesë të provave të fakteve më dënun vetëm dy muaj. Më lshuan të lirë. Kurse këtë e çuan atje për të vazhduar hetimet e tjera me Muharremin tash Shaljanin.

E dënun edhe Muharremin edhe Ganiun po edhe ni Haxhi Maliqin, te tret bashkë. Kta dy kah dy vjet m'duket kurse Ganiun e dënun gjashtë vjet. Gjashtë vjet sepse ky e shfrytëzoj sallën e gjyqit për t'mos lënë gjë pa thënë çka kishte n'bark kundër regjimit. Që në nifar' mënyre ky edhe tregoj tani që është njeri i pregaditur mirë, nuk keni kap rastësisht ni njeri n'rrugë. E dënun ma shumë, ma shumë se ata. Kshtu ishte ky arresimi ynë. Unë u ktheva përsëri dhe vazhdova veprimtarinë sepse në nifar' mënyre unë u binda që ata nuk dinin për organizatën tonë kshtuqë në konspiracion ma të thellë tash, ma me kujdes po vazhdoj.

Aty kom shkru në atë rast ni letër që e keni në atë librin aty ni letër t'gjithë anëtarëve të organizatës. Arrestime tjera siç thashë kanë ndodhur por organizata nuk u zbulua deri në vitin 1982. 1981 fillun arrestimet në dhjetor pastaj, ma herët bile, pastaj mu m'kanë marrë me 18 dhjetor n'burg. Kur kam shku s'kam dashtë të pranoj asgjë duke menduar se mos po shpëtoj sikur në '79-ten. Por ata m'i thanë emrat e gjithë anëtarëve të komitetit drejtues që, "I kem", tha, "ktu". Domethonë ndoshta me anëtarët e komitetit drejtues kom qenë i fundit unë që jam arrestu.

Pastaj u zbulua shumë çka. Edhe në atë komitetin ekzekutiv u zbuluan përveç Saimes që mbeti jashtë. Sepse ishte martuar me Kadri Zekën atje. Vetëm dy javë pas martesës Kadri Zeka u vra pastaj. Ne vazhdum, vazhdum veprimtarinë dhe vendosëm që ta mbyllim atë organin pararoja që kishim bo në '77-'78 masi kishim mbyllë punën me Zërin e Kosovës dhe ta bëjmë ni tjetër organ e qujtëm Liria. Liria e cila tash mund të shtypej në kushte ma t'mira jashtë mbasi e kishim Kadri Zekën atje.

Ktu është përgadit Liria, në tërësi është redaktu e tjera dhe osht' dërguar materiali pastaj me kujdes nga veprimtarët tanë jashtë. Atje ka shtyp Kadri Zeka numrin e parë dhe osht' kthy këndeje pastaj osht' shpërnda ai trakt diku në tre mijë kopje që janë shtyp. Plus tani sa është rishtyp e sa është përshekru e sa vet e kanë lexu ni numër se s'mbahej te ni njeri ajo. Kshtuqë Liria u bë e njohur, e njohur në të gjithë

Kosovën atëherë dhe filloj numrin e parë në tetor të vitit 1980 dhe mbaroj në numrin e fundit në vitin 1982 mbasi ram na në burg. Po materialet ishin dërguar për shtyp, ishin të gatshme domethonë.

Ka vazhdu ni kohë dhe ka pasë ndikim të fuqishëm. Sidomos kjo koïncidoi edhe me demonstratat e vitit 1981. Ne tash ishim në nifar' gjurmimi, jo vetëm për rritjen e zgjerimit të organizatës tonë por edhe për t'gjetur organizata tjera dhe që bashkë ta formojmë një organizatë të fuqishme t'madhe dhe ta qujmë bile Front. Dhe ai fronti t'mos i kishte ato kriteret shumë rigoroze për ta zgjedhë një njeri që t'hyj në organizim. Por të futeshin njerëz të shtresave të ndryshme, përveç mos t'na rrezikohej domethonë po jo dikush tjetër. Të futeshin fshatar, t'ri e të vjetër, kushdon. Kush kishte vullnet që t'hynte.

Nuk, nuk patëm shumë sukses n'fillim derisa ndodhën demonstratat. Ndodhën demonstratat. Organizata jonë atëherë doli në ballë të demonstratave dhe kishte rolin udhëheqës domethanë. Nuk kishin nisë ne organizatat, organizatat, ato demonstratat. Demonstratat filluan në universitet fillimisht me 11 mars të vitit 1981 për kushte ma t'mira të studentëve. Pastaj mori karakter politik me 26 mars. Pastaj me 31 mars, me 01 prill me 02 prill arriti kulmin dhe vazhdoj pastaj edhe nëpër qytete tjera. Që ishte ni kapitull tashmë në vete kjo.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare e gjitha konsideroj që mori pjesë në këto demonstrata dha kontributin e vet, jo vetëm organizata jonë. Nuk ishte vepër e organizatës tonë kryengritja e vitit '81. Ishte ni vepër n'radhë t'parë e vet popullit që ishte, ishte mbush revoltë kundër regjimit shtypës, shfrytëzues edhe diskriminues dhe donte të dilte n'rrugë vet. Kur zbret vet masa në rrugë atëherë, atëherë nuk osht' larg liria. Kurse roli ynë ishte ta drejtojmë, ta orientojmë drejt, t'mos lejomë që t'hyjë dikush t'i manipuloj, t'vijne shërbime sekrete t'huja ose jugosllave që t'hyjnë dhe t'jepin karakter kushedi çfare organizatës dhe demonstratës. Gjithnji po e bëj organizatë demonstratën.

Ky, ky ishte roli ynë. Jo vetëm të drejtojmë po edhe ta orientojmë drejt në pastërinë e luftës së atyre kohëve. Që t'mos shprehim urrejtje kundër popullit serb po kundër regjimit pushtues. T'mos ngacmojmë po as t'mos rrezikojmë fqinjë serb. T'mos ndodhë ajo që po bënin ata kundër nesh. Ka pasë njerëz që prej banesave serbe në qendër të qytetit kanë gjujtë saksi lulesh plot pleh mbi kokat e demonstruesve. Kurse ni tjetër trimush, dikund atje te Mensa e Studentëve, te ni Bashiq ishin ni familje, ka gjujtë me armë kundër demonstruesve. Pastaj demonstruesit kanë shku e kanë identifiku prej ku u gjujt dhe e kanë shti flakën asaj shtëpije, gjatë demonstratave.

Nuk di tash unë saktë sa ka plagos, a ka vra. Po me vra jo se nuk osht' vra aty kërkush n'atë vend po mund t'ketë plagosur përderisa ka gjujtë me armë. Kur t'gjujsh ti në ni masë të dendur njerëzish sigurisht që dikond do ta kap, do ta kap plumbi. Për demonstratat të flasësh është ni histori e gjatë dhe histori n'vete. Një për mënyrën si u përgadit ajo për nja dhjetë vjet rresht në mënyrën si u ndërgjegjësuat qytetarët që t'dalin n'rrugë edhe të protestojnë. Që t'mos jenë vetëm grupe njerëzish që luftojnë për liri po t'jetë vet populli dhe liria t'jetë vepër e atij populli.

Që të shikojmë cili ka qenë ndikimi i shtypit klandestin, cili ka qenë ndikimi edhe ma i madh se i shtypit ai i bisedave të drejtpërdrejta me njerëzit aty ku gjenim mundësinë të flasim. Me njerëzit ne kemi folur dikund ma hapur dikund ma fshehur, dikund me alegori e dikund me simbole po i kemi thënë pikëpamjet edhe me gojë. Gjithnji duke mos lejuar që të digjet edhe po të piqet mishi.

Domethonë ta arrijmë qëllimin tonë ne te njerëzit po t'mos zbulohemi që jemi njerëz të organizuar. Fundi i fundit edhe po të merrshin... mu më morrën, më dënuan për propagandë atëherë '79-ten po nuk mund të dënoheshe shumë. Gjashtë muj për ni kundërvajtje. Për propagandë mund të dënonin edhe ma shumë. Ka ndodhë për shembull kur kom lexu pastaj n'burg që njeriu që ju ka gjetë Liria e ka lexu edhe e ka shpërnda tetë vjet e kanë dënu. Vetëm pse e ka pasë Lirinë në dorë.

Kryengritja e vitit, unë e quaj me dëshirë domethonë kryengritje sepse e tillë ka qenë në përmasat e saj dhe me karakterin thellësinë e dimenzionit dhe të kuptimit t'saj. Ni kryengritje pa armë, ni kryengritje paqësore. Ka nxjerrë në sipërfaqe gjithçka. Ka nxjerrë në sipërfaqe trimërinë, guximin edhe vendosshmërinë e një populli që do t'jetë i lirë. Ka nxjerrë në sipërfaqe aftësinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që t'organizoj edhe ngjarjet e tilla të mdha.

Ka nxjerrë në shesh edhe servilizimin e figurave të ndryshme përpara regjimit pushtues që kërkonte që kto demonstrata të shpallen kundër revolucion. Kundër revolucion do të thoshte vepra ma e randë në ni shtet socialist dhe kjo u bë me qëllim që t'mund të dënohen me dënime t'larta, t'randa, dragonike pjesëtarët e këtij kundër revolucionit, n'thojza. Udhëheqja zyrtare e Kosovës atëherë e pranoj këtë kualifikim dhe boni gabimin e randë që s'e kishte bërë ndoshta deri atëherë që i kushtoj popullit shqiptar shumë. Shumë i kushtoj randë kjo.

Megjithatë, ne nuk po hiqnim dorë përsëri edhe në këto kushte për të shpërndarë trakte. E shkruam ni dokument që u qujt teza për frontin e republikës. E shkruam ni dokument programatik për Republikën e Kosovës. Ku parashihnim bashkimin e t'gjithë organizatave patriotike dhe çlirimtare dhe të gjithë njerëzve vullnet mirë që dojnë t'luftojnë për Republikën e Kosovës... tash sigurisht e heshtur pak çështja e bashkimit kombëtar. Dëshironim një fitore taktike ta kemi që të fitohet republika, shtetësia e pastaj e drejta e vetëvendosjes do t'vinte bashkë me republikën, bashkë me shtetësinë. Në ni fazë tjetër do t'vazhdonim pastaj për bashkimin kombëtar.

Ne u trimëruam pastaj për republikën edhe ma shumë nga një solidaritet i gjerë ndërkombëtar. Shtypi, radio, televizionet e huja e përkrahnin plotësisht idenë e Republikës së Kosovës, i përkrahnin plotësisht demonstratat në Kosovë që ishin zhvilluar dhe kërkesën për, për republikë, kërkesën për barazi brenda Jugosllavisë. Që atëherë CIA amerikane kishte paraparë shembjen e Federatës Jugosllave. Për shkak të krizave që e brenin për brenda.

Kurse në epiqendër të këtyre krizave ishte kriza e Kosovës me çështjen e saj të pa zgjidhur. Dhe që po vinte dalë nga dalë edhe në kancelaritë botërore po hynte atje për ta parë atë vullnet, atë këmbëngulje

dhe atë luftë që po bëjnë shqiptarët dhe për ta bërë të pranueshme për këto kancelari që nga Europa e deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo shpërfaqje ishte shumë e qartë domethonë edhe në shtypin e atyre vendeve e mediave të tjera, jo vetëm në shtypin e shkruar.

Kjo disi sikur e afronte edhe më shumë fitoren e Kosovës. Nga ana tjetër pas përfundimit të reformës kushtetuese në Jugosllavi. Në shkurt të vitit 1974 u miratu Kushtetuta e re e Jugosllavisë. E cila e kishte bërë Kosovën njësi konstituive të federatës por me t'drejta t'veta bile në federatë, por jo të barabartë me republikat e tjera. Kjo pabarazi dukej edhe në numrin e delegatëve që dërgoheshin në Komitetin Qendror ose në kuvendet e Serbisë, të Jugosllavisë, të federatës e tjerë.

Po Serbia nuk kishte qenë e knaqur për këtë. Prandaj në dhjetor të atij viti, domethanë, rreth dhetë muaj më vonë, në Serbi nën kryesimin e Dragoslav Markoviçit që ishte kryetar i kuvendit atje, u mbledh ni komision për ta hartuar ni dokument kundër zgjidhjeve që kish bërë kushtetuta e re. Në dokument kërkohej pos tjerash që të kthehet gjendja e më parshme e krahinave. E Kosovës dhe e Vojvodinës. Me ni fjalë të mohohet autonomia që iu kishte dhënë, ni autonomi ma e gjerë sigurisht.

Por jo vetëm kaq. Po kushtetuta kishte bërë pengesa edhe në zbatimin e hegjomonizmit serb brenda Federatës Jugosllave. Tash nifar' mënyre ishte bërë nifar' liberalizimi, i kërkuar edhe nga jashtë, i kërkuar edhe nga brenda. Qoftë me Maspokun¹ në Kroaci në vitin 1971 me Savka Dabčević-in² e kush ke tjetër... Në Serbi pastaj një vit ma vonë me atë lëvizjen liberale kur Titoja u dha daska edhe lëvizjes në Kroaci edhe lëvizjes në Serbi. Gati, gati sikur edhe Rankoviçit që i kishte dhënë katër vjet a sa po i bjen përpara, 1966-ten. Po Rankoviçin s'e kishte fut n'burg kurse kto i futi edhe nëpër burgje.

Serbia ishte e pa knaqur. E pa knaqur dhe në dokumentin që e kishte ni emër t'gjatë po e qujtën shkruar 'Libri i kaltërt' sepse dokumenti i kishte kopertinat e kaltërta. Libri i kaltërt u hartua pos tjerash edhe për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Sidoqoftë, mos t'zgjatëm në këtë çështje, në këtë temë. Libri i kaltërt, u hesht dhe u mbyll në sirtar për t'mos vazhduar më tutje bisedimet. Sepse pati, pati bisedime në nivele të ndryshme deri te Josip Broz Tito. Ishte rrezikim në qoftëse do të zbatohet domethonë që atëherë. Sepse edhe Tito ishte i vetëdijshëm që në Kosovë përveç kundërshtimit të zyrtarëve që ishin n'pushtet edhe ma fuqishëm do t'kundërshtohet nga lëvizja e fshehtë kombëtare.

U hesht, u hesht po nuk u gjujt në shportën e mbeturinave të historisë. Ajo u mbajt aty dhe Serbia po priste ni rast tjetër ma t'favorshëm edhe të brendshëm edhe ndërkombëtar për ta zbatuar atë libër, atë dokument. Ky rast, siç mendonin ata, do të ishte fill pas vdekjes së Titos. Të gjithë e dinin që Tito nuk e

¹ Maspoku ishte lëvizje politike dhe kombëtare në Kroaci më 1971 (nga "masovni pokret" – lëvizje masive), e njohur si Pranvera Kroate, e cila kërkonte më shumë autonomi ekonomike e politike për Kroacinë brenda Federatës Jugosllave. Lëvizja u shtyp nga udhëheqja federale e Jugosllavisë në fund të vitit 1971.

² Savka Dabčević-Kučar ishte një politikane kroate gjatë periudhës komuniste dhe një nga figurat kryesore të *Pranverës Kroate* (Maspok).. Ajo shërbeu si kryetare e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Kroacisë deri në dhjetor 1971, kur u largua nga pozita e saj pas shtypjes së lëvizjes nga udhëheqja federale.

kishte gjatë sepse ishte randë i smutë dhe matej jeta e tij tashmë me muaj ose me ni vit, jo më tepër. Dhe është e vërtetë që ai vdiq, vdiq shpejt.

Unë nga ato që bëj analizat e atij konteksti historik atëherë, rezultati më del që po t'mos ndodhte kryengritja e vitit 1981 suprimimi i autonomisë nuk do t'bohej në vitin e Kosovës, në vitin 1989 por 1981. Ndoshta nga fundi i vitit, ndoshta nga mesi i vitit por do të ndodhë. Sepse Tito ishte heq si pengesë dhe kta do ta bënin. Kurse federata nuk e kundërshtonte shumë vendime anti shqiptare dhe vendime anti Kosovë të Serbisë sepse e kishin hallin e vet.

E dinin që ishin në armiqësi me Serbinë edhe ata. Donin që le t'merren me Kosovën, le t'bëjnë çka t'dojnë me të. Nuk ka qenë federata në anën tonë krejtësisht. Ka pasë ni interes që t'ishte me ne bashkë edhe sigurisht e kanë kundërshtu, për shembull, ma vonë pastaj në atë protestën ose grevën që bën minatorët në Cankarjev Dom në Lublanë. Por edhe në Kroaci shtypi e tjera e tjera. Ishin në përkrahje të atyre minatorëve. Po ishte tash një kohë tjetër.

Serbët vazhduan ato vite me njerëzit e vet dhe shqiptarë dhe erdhën te rrënimi, te suprimimi i autonomisë. Tash do të thush ti po si do të ndodhte më 1981 si me '89 autonomia ra, do t'binte. Nuk osht' konteksti historik njëjtë '81 me '89. Sepse në '89-ten kishin filluar transformime rrenjësores në bllokun socialist. Po frynte ni erë tjetër perëndimore dhe do të ndodhte tashmë jo rrënimi i autonomisë po do të ndodhte rrënimi i ni sistemi të tërë socialist në rajonin tonë e më gjerë.

Në këtë kuptim suprimi i autonomisë në vitin 1989 nuk mund të ishte afat gjatë. Mund ta bënin siç e bën por nuk mund të qëndronte tashmë gjatë. Nuk mundte si mendohej, nuk mund të bëhej i përhershëm sikurse do t'mund të bëhej në '81-ten ose '82 dhe të merrte të drejtën pastaj ai suprimim në vazhdim. Por jo ktu pastaj që në embrion gjithçka u kontestua edhe nga ndërkombëtarët. Rrodhën pastaj si rrodhën ngjarjet dhe suprimimi i autonomisë faktikisht Libri i Kaltërt dështoj. Dështoj përfundimisht tashti sepse ishte tepër vonë që të zbatohet.

Ishin edhe ato memorandume të akademisë, ishin laborante të krijune ma vonë pastaj edhe nga partia radikale e Sheshelit kur ishte sekretat i përgjithshëm i saj. Presidenti aktual i Serbisë Vuçiq e tjera. Ai ka qenë një elaborat jo më i butë se elaboratët tjera, që ka bërë Garašanin-i që ka bërë Ivo Andriç e të tjerë.

Pjesa e Gjashtë

Anita Susuri: Zoti Mehmet, kisha dashtë me u kthi edhe me bisedu për demonstratat e vitit '81 ku mbetëm herën e kalune. Me tregu se si kanë vazhdu përgaditjet prej juve, prej grupit t'juj, qysh ka qenë situata?

Mehmet Hajrizi: Organizata jonë që nga themelimi ka bërë punë të dendur jo vetëm në kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarët kudo po edhe me shtypin e saj klandestin, me traktet, me botimet e veçanta që janë përgaditë atëherë, disa asosh. Për të ngrit ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve, për të thënë të vërtetën mbi gjendjen e tyre dhe për të dërguar, për të dërguar rrugën nëpër të cilën do t'mund t'shkonim drejt lirisë dhe çlirimit.

Kanë qenë jo pak po u bon mbi dhjetë vjet veprimtari dhe ishte efekti i asaj pune. Nga ana tjetër, sidomos nga fundi i një dekades të viteve '70-të, lindën edhe organizata të tjera dhe unë ju thashë ma përpara që ne po përpiqeshim tani se si t'i gjejmë ato dhe të vendosim kontakte dhe t'bëjmë një bashkim. Një bashkim sepse duhej të bashkohej gjithë potenciali i lëvizjes kombëtare për të mund për të pasë rezultate ma t'mira.

Nuk po nguteshim po kishte ardhë koha kur duhej të shpërthente, kur duhej nxirrej në rrugë qytetarët dhe ata të shprehnin hapur vullnetin e tyre politik, të shprehnin hapur revoltën e tyre që kishte arritur një nivel të lartë dhe të kundërshtonin atë politikë shtypëse, shfrytëzuese dhe diskriminuese që bënte regjimi pushtues në Kosovë. Mjaftoj një protestë e studentëve me 11 mars që pastaj të ndizej, si të thush, zjarri i madh popullor në ditët në vijim.

Anita Susuri: Si e pritët ju qat' shpërthim që ndodhi me 11 mars?

Mehmet Hajrizi: Me 11 mars përmbajtja e asaj proteste ishte me karakter social. Studentët po kërkonin kushte më t'mira të studimit ose me ni fjalë po kërkonin që të trajtoheshin në mënyrë të barabartë me kolegët e tyre ane kënd Jugosllavisë. Mu m'kujtohet viti 1973 ne kishim shpërndarë ni trakt që e qujtëm thirrje. Madje e bëm edhe në gjuhën serbe. Sepse kishte karakter social trakti prandaj dëshironim që të kenë në dorë atë trakt edhe komuniteti serb, kroat. Çfarë ka pasë aty që fliste gjuhën serbo-kroate atëherë.

Atëherë u kërkonim që të ngrihen në grevë e në protesta studentët për të përmirësuar kushtet e tyre dhe për t'u bërë krejtësisht të barabartë me studentët e universiteteve tjera në Jugosllavi. Kshtu aty shpërtheu dhe ne si organizatë nuk ishim në dijeni të kësaj që ndodhi. Madje edhe vet studentët tashti thonë që nuk ka qenë ndonjë organizim kush e di sa i përgaditur paraprakisht. Ndodhi ni pjatë që u përmbys aty dhe pastaj u ndezën flakët e rinisë studentore.

Ajo kaloj gati e gati në heshtje. U dha vetëm një njoftim i Tanjugut³ atëherë në Rilindje po jo ma shumë, mbase edhe në mediat jugosllave. Sepse transmetohej nga Tanjugu, Agjensia Telegrafike e Jugosllavisë. Por ditën e definimit të stafetës së Titos me 26 mars u bë ni shkas tjetër për të protestuar përsëri, kryesisht studentët. Por kësaj radhe bashkë me studentët hyn edhe punëtorë, nxanës, fshatar.

³ Tanjug (Agjencia Telegrafike e Jugosllavisë së re) është sot agjencia shtetërore e lajmeve në Serbi. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ajo funksiononte si agjenci lajmesh e drejtuar nga partizanët.

Kush qëllonte në kryeqytet atëherë. Vetëm në Prishtinë pat' ndodhë kjo dhe u bë megjithatë një, një demonstratë e madhe. Shumë ma e madhe se që ishte ajo e 11 marsit.

Them që ishte, ishte para shpërthimit të revoltës të njerëzve dhe nuk duhej shumë punë për t'i nxjerrë n'rrugë ata për të protestuar. Pastaj, ndodhi tjetra me 31, me 01, me 01 prill ishte më e madhe dhe ne atëherë u vlerësua që ne duhet të hyjmë si organizator në këto demonstrata sepse po shihej që kishin ni karakter spontan të shpërthimit, kishte stehi dhe ekzistonte rreziku që të ndërhyj dikush tjetër aty brenda dhe t'i orientoj në drejtim të gabuar demonstratat.

Sidomos mund të ndërhyjnë aty spihuj ta zam të regjimeve të ndryshme po në radhë të parë serbe. Që ta paraqesin atë si një ngjarje të rëndë për Jugosllavinë dhe qëllimi i tyre ishte që ta zinin këtë kohë tash që ta realizonin Librin e Kaltërt për të cilin e folëm ma përpara, për të suprimuar autonominë. Edhe po t'mos ndodhnin demonstratat, përpjekja për ta suprimuar autonominë e Kosovës po edhe të Vojvodinës ishte në plan të tyre në këtë kohë.

Hym, hym ne dhe të gjithë udhëheqja e organizatës ka qenë në grupe të ndryshme duke orientu demonstratën. Njëri prej anëtarëve të komitetit drejtues, Hydajet Hyseni, meqenëse jetonte në ilegalitet të thellë dhe nuk mund të kapej sepse ishte i fshehur si të thush. Ai doli me megafon atje dhe paraqiti kërkesat, thirrjet, parullat, orientimin e demonstratës që i ipte karakter të organizuar vet demonstratës së asaj nate, natën vonë...

Anita Susuri: A ka qenë ai i përcaktun me folë?

Mehmet Hajrizi: Po.

Anita Susuri: Prej organizatës apo vet...

Mehmet Hajrizi: Po. Ishte e randë pastaj ndërhyrja e policisë. Me ato bombat shurdhuese që kishin një, një jehonë n'krejt qytetin e pastaj gjuanin edhe bomba me gaz lotsjellës. Nuk ishin ato thjeshtë sa për t'sjellë lot po ishin ngulfatëse sepse mbeteshin njerëzit pa frymë. Unë e mbaj mend për shembull që deshtëm të dalim nga kuvendi tash ku osht', atëherë quhej Këshilli Ekzekutiv i Kosovës, po aty kishin qenë ato forcat që gjuanin dhe na gjujtën.

Pastaj, ka qenë një rrugë gjysmë rrugë aty ku osht' optika te teatri, te Teatri Kombëtar, aty kemi hyrë një grup njerëzish. Po rruga ishte e mbyllur. Pa asnjë hezistim ata erdhën dhe gjujtën pikërisht në atë rrugë ku ishim ne. U kriju ni gjendje aq e rëndë aty sa as s'mund të ktheheshe mrapa sepse ishin njerëzit që ishin bërë njëri pas tjetrit ngjitur dhe të tjerët atje nuk mund ta kalonin se ishte e mbyllur. Për më tepër paska qenë ni shtëpi serbe aty që e mbyllte rrugën.

Unë e mbaj mend që mbeta, mbeta pa frymë. As s'mund të kthehesha mrapa as para. Në asnjë drejtim s'mund të lëvizja. Nuk kisha asgjë me veti, as ujë as diçka që t'mund të... ose qepë përdorëshin për shembull atëherë. Nuk mund të, të merrje as një veprim që t'shpëtosh nga kjo gjendje. Ne kishim mbetë aty dhe po prisnim t'gjithë çka t'ndodhë le t'ndodhë me ne s'kishim çfarë të bëjmë. Ndërkohë po çarkullonte nga pak përpara dhe unë arrita të shkoj deri te ajo shtëpia që thashë.

Shtëpia e kishte ni muri, u dashke të ngjiteshim murit e të hypim mbi mur e të hyjmë brenda në oborr. Osht' interesant kur kam kërcyer aty nuk pashë askënd që t'dilte e t'na thoshte kush jeni, pse hyni, pse dilni. Mund edhe t'na gjunin. Si duket edhe ata e kishin lshu shpinë. Pastaj duhej ta kaloja ni muri tjetër po ashtu të lartë dhe bie në rrugë andej nga, dilje pastaj n'këtë rrugën tash Agim Ramadani që quhet. Aty.

M'u duk sikur linda për t'dytën herë, pastaj mora frymë (qeshë). U nisëm dhe tash duhej të shkonim në bazën tonë që të mblidhemi dhe të bëjmë një analizë si shkoj puna deri ktu, çfarë do t'bëjmë nesër e tjerë e tjerë. Se atë natë atu u tha që nesër me 02 prill do t'vazhdoj demonstrata dhe t'jemi gati. Të nesërmen kom dalë n'mëngjes bashkë me ni vlla timin, ka qenë edhe ai ish i burgosur politik, Zeqir Hajrizin që e kemi përmend ma përpara. Kemi dalë dikund kah ora 07:30-08:00 sepse morëm vesh që filloj demonstrata. Ishte pak herët po ne e lam bukën, ishim mëngjes duke ngrënë dhe dolëm.

Erdh ni vajzë, motra e Naser Hajrizit që ishte në shkollë dhe ata kishin shkuar jashtë qytetit, qysh i kanë ndjekur dhe t'dalin pastaj... unë isha në rrugën e proletarëve atëherë me shtëpi dhe ajo erdhi në derë dhe nuk hyri brenda po vetëm nga rruga tha, "Ka filluar demonstrata, unë po shkoj atje", dhe e gjujti çanten e vet t'shkollës e gjujti n'oborr, kurgjo tjetër. Ne atëherë e lam bukën dhe u nisëm t'shkojmë pas saj, po nuk e zum. Sepse ata ishin ma të shpejt, nxënësit.

Dolëm, dolëm poshtë dhe kur arritëm te kuvendi forcat ushtarake serbe jugosllave kishin qenë t'vendosura nëpër pika të ndryshme, nëpër qoshte të kuvendit. Aty ata po na thoshin, 'Mos kaloni sepse shtijmë me armë'. Kujt i thoshin? I thoshin nxënësve dhe mendonin se do të ndalojnë ata. Nuk ndaluan ata, kaluan. Për fat nuk shtiu kërkush. Ne bashkë me ta, kaluam edhe ne. Shkuam aty para teatrit ku ishte qendra e protestët, e demonstratës që kishte filluar atë ditë.

Ndërkohë na humbi neve kjo vajza me shoktë e shoqet e veta domethonë ishte nxënëse e vitit të dytë e shkollës së mesme. Fillun pastaj të shtijnë, të gjujnë bomba, gaz lotsjellës aty. Ne u tërhoqëm në rrugën Agim Ramadani tash, atëherë s'di qysh osht' qujtur, mos ka qenë Marshalli Tito, nuk e di s'jom i sigurt. Po aty dikund. Gjuanin. Ndërkohë Naseri me shoktë e vet, Naser Hajrizi bie nga Shtëpia e Malltrave...

Anita Susuri: Gërmia që ka qenë.

Mehmet Hajrizi: Gërmia që ka qenë dhe don të dali jo ajo e reja atje poshtë po e vjetra, m'doket e vjetra ka qenë kjo ktu mos t'gabohem. Nejse, njana ka qenë, në qendër të qytetit ku osht' përballë teatrit. Aty ku osht' Monumenti i Skënderbeut. Aty lshohen poshtë me shoktë e vet ata. Me Asllan Pirevën kanë qenë të pa ndashëm dhe kanë qenë të organizuar bashkë. Kanë pasë ni flamur. Që duke ardhur nga Shkolla Normale atje kthehen në një zyre që e kishte babai i tij që punonte te Xhamia e Madhe aty ka qenë ni ndërmarrje Kosova për punët përfundimtare në ndërtimtari dhe ai e kishte ni flamur dhe i biri Naseri e dinte që e ka. Kanë hy aty dhe e kanë marrë. Babën s'e gjetën po flamurin ia morën.

Dolën në protesë me atë flamur n'dorë te dytë kanë qenë. Herë Naseri herë Asllani e kanë bartë flamurin në qytet. Kur dolën në ni shesh aty që e kalojnë Shtëpinë e Mallrave, pas Shtëpisë së Mallrave, aty osht' ni shesh i vogël midis postës së vjetër, midis Bankës Popullore, kjo ndërtesa ku osht' tash kryeministria dhe në anën e jugut ishte Shtëpia e Mallrave, shesh i vogël është aty. Aty pastaj mbliiden kta dhe po protestojnë. Ndërkohë në ndërtesën e Bankës Popullore, ishte një, jo një po ishte mbushur plot e për plot ushtarak e ushtar jugosllav, oficer.

Unë kom qenë herët në mëngjes aty ora 06:00 kur s'kishte ende demonstratë. Kisha shkuar ni vajzës time t'vogël t'i marrë, t'i marrë qumësht. I pashë ata, ishin të shtrirë poshtë në atë si holl i madh ka qenë kati i pari. Xhama ka qenë, krejtësisht xhama dhe mund të shihej brenda njerëzit. Ishin shtrirë, se kishin fjet aty si duket. Prej katit të tretë m'kanë thënë pastaj që ka gjujt ni oficer me snajper. Aty e ka vrarë Naser Hajrizin dhe Asllan Pirevën, te dyt bashkë.

Ne që ishim në rrugën, tash Agim Ramadani, pam ç'është e vërteta ni makinë, ni makinë të ndihmës së shpejt që kaloj andej pari dhe shkonte për spital. Gjithnji kom mendu që ajo makinë i ka bart ata dy. S'kishte qenë ashtu po paska qenë ni doktor që tash jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ni Petrit quhej. Që i paska marrë në makinën e vet kta dy dhe i ka dërguar në spital. Pastaj kam marrë vesh që njëri ka qenë i gjallë por në përfundim t'jetës domethonë. Tjetri ka shkuar pa jetë atje. Kujdestar ka qenë Zenel Kelmendi ni kirurg i njohur.

Ai ka trajtuar dhe m'ka treguar pastaj si i kemi trajtuar të dytë dhe, "T'jesh i sigurt", thotë, "që nuk ka qenë mungesë e kujdesit mjekësor dhe nuk kemi pasë infermiere në sallën e operacionit po t'gjithë kanë qenë doktor që t'bëjmë të pamundurën që t'shpëtojmë jetën". Nuk kanë mundur t'i shpëtojnë. Prej aty pastaj jam tërhjekë bashkë me vllain. Shtëpinë e kom pasë në rrugën e proletarëve poshtë, aty m'duket jemi kthyer që t'i lajmë sytë prej gazit, tymit. Pastaj kemi dalë mrapa ku po zhvilloheshin demonstrata gjithashtu andej nga rruga e Xhamisë së Llapit dhe aty na ndoqën përsëri dhe u detyrum të ngjitemi nalt në Kodrën e Trimave.

Mbaj mend tash sikur sot, një dukuri ta them a si ta quj, një përkujdesje, ne duhej të shkonim rrugës që çonte te varrezat. Ajo rrugë është e gjatë dhe përmbi atë Fabrikën e Tullave ka qenë një fushë e pa shtëpi. Rrugës derisa po shkonim t'gjithë ishim të, me lot n'sy, me ato, me atë gjendjen e tymit e

bombave e tjera. Gati nuk ka pasë derë shtëpije ku nuk kishte një vajzë ose një grua që dilte para dere dhe na ofronin ushqime, ujë, lëngje. Me një tabull që ti mund të merrje çfarë të dush dhe të kalosh tutje.

Të gjitha dyert e hapura kanë qenë dhe të gjitha ato gra e vajza unë i kom sot parasysh që kishin dalë sikur për vllëzit e vet, sikur për motrat e veta që t'u jepin ni ndihmë sado të vogël. Shkum pastaj mbetëm në atë fushën pak pushum aty. U kthym përsëri që t'dalim. Kur u kthym këtë rrugën që shkon për Podujevë, dikush kishte vendosur disa makina e kishte mbyllë rrugën, si barikada edhe ni autobus.

Erdhën ndërkohë forcat serbe aty dhe zbritën. Hypi njëri prej tyre në autobus dhe për çudi u ndez. Unë nuk prisja që do të ndizet aq lehtë, mendoja që do ta shtyjnë a me ni bonduzher a s'e di çka. Ai e ndezi dhe e parkoi autobusin anash. E çeli rrugën dhe kishte edhe makina tjera edhe të djegura për të hyrë në qytet që kishin qit' barrikadë. Duhej tash të gjitha këto t'i rujsim. Po ne u dashtë të tërhiqemi nga aty sepse na gjuanin. Kshtu shkoj tërë dita deri në mbrëmje, 02 prilli.

Në mbrëmje vetem kanë pa n'familje që nuk ka ardhë Naseri në shtëpi. Kanë pritë gjithë natën. Nëna e tij sidomos nuk ka fjetur fare. Kur do të vinte... nuk osht'... me 03 prill ne shkuam në spital të pyesim mos, mendonim që është plagosur. Sepse erdhën nga shkolla ni Zenun Gjocaj, profesor i Naserit ka qenë. Erdhi ai me dy të tjerët dhe thanë, 'Naseri është i plagosur', ata nuk donin që ta shqetsonin aq rëndë familjen në lajmin e parë.

Shkum ne unë, baba i Naserit dhe vllau Zeqiri, te tret. Shkum atje. Hyjmë brenda. Mu nuk m'lanë që t'hyj t'i shoh rrobat. Se ata thanë, "Nuk ka ktu Naser Hajrizi nëpër klinika", thanë, "po shkoni shikoni rrobat, në qoftëse i gjeni rrobat e tij e njihni po shkoni dhe gjeni rrobat e tij e pastaj e verifikojmë që ku osht'". Rrobat tregonin që aty osht' dikund. Aty dy shkuan po mu m'kthyn më thanë, "Jo ti nuk mund të hysh", "Mirë". Prita unë.

Hynë ata nuk i gjetën. Erdhën. Ata po thonë, "Ky ndoshta e gjen më mirë", për mua. Tha, "Mirë, hajde hyn". Hyra unë edhe po i shikoj ato rrobat të rënditura, podrum ishte aty, të rënditura varg, të njerëzve me gjak, ishin të shkyera, ishin, ishin të demonstratës, të ngjarjes ni ditë ma përpara. Nuk i gjeta kërkund rrobat e Naserit dhe dola. "Hajde shkojmë në morg". Shkuam në morg atje dhe përsëri për çudi sikur me inati mu m'thanë, "Jo", tha, "ti mos hyn le t'hyjnë kta". Ndoshta sepse isha ma i ri dhe kushedi çfarë dyshonin, çfarë mund t'bëj ky. Ata nuk dinin për mu kush jam e si e kisha punën e tjera.

Hyjnë ata dhe nuk e njohën. Dolën përjashta thanë, "Nuk e pam, nuk osht'", thashë, "A t'hy unë niherë?" M'lejun tash për t'dytën herë. Hyra brenda i nxorrën në njo si kabinë që ishte frigorifer. E nxorrën njëerën, ishte me flokë të zeza që s'i ngjante Naserit kërkund hiç po ishte Asllani. E nxorrën tjetrën, ose m'u duk si Asllani. E nxorrën tjetrën kufomë erdhi, ngjante në Naserin po meqenëse plumbi i kishte rënë në ballë, njejtë edhe tjetrit, snajper ishte arma, ishte nxirë rreth syve kshtuqë... njeriu njihet edhe n'sy shumë. Nuk mund të dalloje, kurse ftyra ishte e enjtur dhe nuk njihej lehtë.

M'u desht t'ia hapja buzët që t'ia shihja dhëmbët se e disha që dhëmbët nuk kanë psu asnjë ndryshim. Aty aty u bindëm domethënë që ishte Naseri. Dola. Dola jashtë dhe ju dhashë lajmin, kumtin e rëndë babait edhe vllait tim. Që, "Naserin e gjeta unë, aty është, i vrarë është". Nuk kishte transport atë ditë, nuk kishte mundësi kurqysh të udhëtoje, duhej në këmbë të vije. Nuk erdhëm rrugës kryesore se ishte, ishte me rrezik. Po erdhëm andej nga Kodra e Diellit që kishte... fushë ishte deri te Kodra e Diellit fushë ishte e tëra, po ishte ni rrugë që kishin kalu njerëzit rreth saj.

Çdo 50 metra 100 metra ne takonim një grup, pika të kontrollit domethanë, s'di çka ishin ata rezervist a... sepse ishin me mjekrra, ishin me flokë t'gjata po me uniforma t'gjithë. Na ndalonin, na ndalonin dhe na kontrollonin. I mbanin armët në gjendje gatishmërie për të shti nëqoftëse ne do të ndërmerim diçka. Ata mund t'mendonin që kushedi kush jem ne. Baba i Naserit kishte një veshje të trashë, një bundë si i thoshin atëherë. Sepse ishte i ftohur pak i sëmurë. Ata dyshonin sidomos te ai se mos mshifte ndonjë armë pas asaj veshje. Zbërthente ky ato pulla dhe u thonte që, "S'kom, s'kom gjë".

Njëri që ishte ma i egër prej tyre m'u duk tha, "A ke armë?" Ky tha, "Jo". Merre me mend tash po flet me një prind i cili sapo kish, ishte njoftuar që ishte vrarë i biri pikërisht nga këto forca. Tha, "Jo nuk kom", "A ke", tha, "n'shpi". Ktij i erdh te hunda si duket. "E në shpi", tha, "hajde shiko", tha, "a kom a s'kom". Megjithatë shpëtuam. Thashë, "Beqë", Beqir e ka pasë emrin, thashë, "Beqë, mos fol me ta, mos bëj kurfar muhabeti me ta. Çka t'thojnë kontrollë e bojnë edhe shkojmë sepse kta janë të paparashikueshëm dhe mund të ndodhë edhe ni e keqe tjetër mbi ni lajm t'randë".

Ata shkun të marrin ni makinë, ata dy vllazërit, unë erdha vetëm n'shpi. Unë duhej tash të sillja lajmin. Nuk ishte e lehtë dhe ma kishin kërku detyrën ma t'randë mu. I kisha gjetë unë 100 kamiona i kisha pru ma mirë se ta bija lajmin. Erdha dhe hyra brenda. Aty ishin motrat e Naserit, vllazërit ishin, ishte nëna, kishin ardhë edhe të tjerë. Duhej të filloja, duhej të filloja por duhej të filloja me kujdes dhe gradualisht. Them që, "Mund t'jetë i plagosur, kshtu na thanë". Po ma vonë po thom, "Nuk i dihet", kaq nuk thashë ma shumë.

Ajo nëna, shpirti i nënës e kupton mirë intuiten e saj, "E paskan vra", tha. U kriju ni gjendje shumë e rëndë aty dhe erdh pastaj edhe kamioni dhe të nesërmen ne duhej ta dërgonim për varrim. Por, ishte gjendje shtetrrrethimi dhe nuk lejohej më shumë se tre vet. Kurse për bartjen e kufomës lejoheshin katër vet. E morëm ni kamion me mushama, të mbuluar. Kamioni ishte i madh. Kamioni u mbush plot njerëz nga 25-26 njerëz te 30. E futëm aty edhe arkivolin.

Para se të hynim në atë kamion ne ktu ku hyt ju në hyrjen e derës vendosëm aty arkivolin të mbuluar me flamur dhe gjithë t'pranishëm që ishim nja pesë-gjashtë vet bëm një betim para arkivolit të tij. Ata që nuk hyn në kamion shkuan në këmbë. Nga një, nga dy se as tre nuk lejoheshin që t'shkonin te varrezat. Kamionin na ndalën te Xhamia e Llapit atje dhe nja pesë-gjashtë njerëz i zbritën, tjerët na

lanë si na lanë. Po na erdhën mrapa ata pastaj me makinat e tyre deri te varrezat atje. Atje përsëri ndodhi pastaj... se dikush u bashkangjit edhe rrugës. Përsëri ndodhi një betim atje.

Baba i tij pastaj ka kujtu ma vonë thotë, “E kom ndje vetën atë ditë krenar kur ndëgjova njerëzit tek betoheshin përpara trupit të birit tim”. Kshtu shkoj me ato dy ditë t’rënda dhe morëm vesh pastaj që në Prishtinë pastaj ishin vra edhe dy të tjerë. Sali Abazi dhe Xhelal Maliqi. Edhe ata dy, katër u vranë atë ditë në Prishtinë me 02. Kurse me 03 u vranë edhe dy në Vushtrri, Sali Mulaku dhe Ruzhdi Hyseni në Vushtrri. Edhe dy të tjerë u vranë me 03 mars në Ferizaj.

Anita Susuri: 03 mars? 03 prill.

Mehmet Hajrizi: 03 prill desha të them. 03 marsi mu m’u ka regjistru. Me 03 prill. Ka qenë, ka qenë një përjetim i fuqishëm ardhja e njerëzve pastaj për ngushëllime. Ktu vërshuan gati t’gjithë studentët e Universitetit të Kosovës atëherë kanë ardhë për ngushëllime dhe secili ma i guximshëm se tjetri. Vinin dhe flisnin për urrejtjen që kishin e shpraznin pikërisht në këtë shtëpinë tonën sepse e dinin që ktu mund ta thonë lirsht atë.

Po ne nuk dinim mund t’vijne edhe spiun të hyjnë brenda se kishte shumë, shumë njerëz. Nëna e Naserit kishte dëshirë t’i priste të gjithë ata nxënës, student, qytetarë, profesorë e tjerë. I shoqi i saj thoshte, “Mos eja sepse ti qan e nuk duhet të shoh lot”. Ky erdh te unë tha, “Po du t’vijë”, thotë, “të jap besën se unë nuk qaj”, thashë, “Ti edhe nëqoftëse qan nuk e korit familjen, mund të qash, mund të derdhësh lot”.

Nuk nxorri as një lot ajo grua, kurrë hiç ajo nënë gjatë gjithë pritjeve që bëri. Të gjithë qanin kur e përqafojnë kjo sikur të ishte statuj mermeri. Nuk nxirrte lot. Ndoshta pse i kishte, kishte dhënë nifar’ bese që nuk do t’qaj. Po s’di si t’i mund t’i mbante kur tjetri të derdh lotët në faqe e t’kap për qafe. Shkoj një herë kjo vala e parë e demonstratës, e demonstratës. Unë e quj kryesisht kryengritje, një kryengritje paqësore pa armë. Kryengritje që shprehte vullnetin, vullnetin plebishitar të qytetarëve të Kosovës për barazi, për t’qenë barabart me popujt e tjerë. Kaq, kaq, nuk kërkohet më shumë.

Kjo ishte edhe arsyeja mbasi pse për herë t’parë çështja e Kosovës pati jo vetëm një jehonë të gjerë në botë po edhe ni solidaritet. Të gjitha shkrimet botërore, dhe nuk ishin pak por ishin shumë. Ni libër i tërë ekziston ku janë përmbledhë ato shkrime për Kosovën. Pastaj, radio, televizione t’huja e tjera e tjera. Të gjitha, të gjitha e kanë përkrahë të drejtën legjitime të shqiptarëve për t’qenë t’lirë edhe të barabartë me të tjerët. Shkruanin natyrisht edhe, edhe shtypi ynë ktu që ishte si ishte n’atë gjendje.

Nuk mund të dilte në krah, në përkrahje të demonstruesve. Po shkruante sidomos edhe shtypi serb, të cilin ju e njihni shumë mirë sepse e keni studiuar dhe keni punuar në këtë temë. Villte vrerë. Villte vrerë, një për të paraqitur ngjarjen si një rrezik për t’gjithë Jugosllavinë që të tërhiqte me vete masat

represive të rënda, tërhiqte gjithashtu tendencën që demonstratat të kualifikoheshin si kundër revolucion. Kundër revolucion socializëm është vepra më e rëndë penale që mund të bëhet.

Atëherë kishte tendenca që të shpallej përsëri një gjendje ushtarake, një administratë ushtarake njësoj sikur në vitin 1945 kur u vranë dhejtra mijë shqiptarë. Mbase edhe këtu duhej të vriteshin njerëzit. Duke qenë e alarmuar me këtë që mund të ishin në dijeni zyrtarët shqiptarë në Tiranë, atje morën masa ata që të bëjnë një ristrukturim të ushtrisë shqiptare. Duke qenë e karakterit mbrojtës deri atëherë t'i jepin karakterin msymës, domethonë ofanziv.

Ishte bërë edhe një plan ushtarak për ndërhyrje me forcë në Kosovë. Nëqoftëse do të ndodhte një përshkallëzim i masakrës kundër shqiptarëve ose edhe i shpalljes gjendjes shtetrrrethimit ushtarak dhe administrimit ushtarak për një kohë ma t'gjatë ku do të, ku do të ushtrohej dhuna represale sistematike kundër shqiptarëve. Unë nuk mund të supozoj tash a ishte rreziku që do t'hynte, ndërhynte Shqipëria e po të ndezte lufta ktu, midis dy vende.

Për Jugosllavinë ishte rrezik edhe për faktin që do të ndërhynin pastaj forca të tjera nga jashtë apo pati një kërcënim të jashtëm të vendeve perëndimore demokratike që të mos përshkallëzonin dhunën ktu e terrorin po u ndal, u ndal me kaq. Nuk pati ndërhyrje tjera nga jashtë. Por edhe vet Jugosllavia ishte e paqartë çfarë ndodhi ktu dhe kush e bëri, si dolën kështu nga dheu njerëzit përnihërësh. Sikur me një sustë të komandoheshin për t'dalë. Në nifar' përfaqësie pastaj kom dëgju Ramiz Alinë t'u ndodhë edhe Shqipëria. Nuk do duhej të ndodhej. Sepse osht' njoftuar Shqipëria me kohë, me kohë. Të paktën nga organizata jonë.

Unë e kom udhëheq atë organizatë domethanë për një tetë vjet rresht. Në cilësinë e kryetarit t'saj kam shkuar në Ambasadat Shqiptare një tri herë dhe kam njoftuar në hollësi çfarë po pregadisim ne. Ju kam thënë që ne do t'bëjmë edhe demonstrata edhe protesta po nuk do t'jetë shumë e largët dita ku ne edhe do të ndezim armën. Do t'bëjmë edhe kryengritje të armatosur për t'u çliruar. Këto kanë shkuar në Tiranë sepse pastaj janë kthyer informatat përsëri te unë.

Kam shkruar një tri letra udhëheqjes shqiptare atëherë dhe me n'krye me Enver Hoxhën. Personalisht atij i kam shkruar. Letrat i kanë marrë t'gjitha dhe kanë bërë një vlerësim edhe të punës tonë edhe organizatës domethonë edhe letrat. Kom marrë përgjigje pastaj për to. Kështu që nuk mund t'them që nuk kanë qenë krejtësisht të njoftun. Nuk kanë qenë për datën kur do t'shpërthej. Ta zamë për 11 marsin. Po a do të ndodhte me 11 mars a do të ndodhte me 28 nëntor të atij viti, a do të ndodhte siç, atje dikund përmendej kjo datë për neve. A do të ndodhte, ndoshta edhe n'fillim t'viti tjetër. Po aty dikund do të thotë në këtë hark të kufizuar kohor.

Sepse Tito kishte vdekur dhe tash secili vraponte që të zej pozitën e vet. Serbia priste që të vdiste Titoja që t'i kthehej sulmit kundër Kosovës me qëllim që të suprimonte autonominë. Kroacia, Sllovenia po prisnin edhe ata të pavarësoheshin dhe të dilnin nga orbita hogjomoniste serbe ku e kishte mbajtur

sidomos Rankoivçi në kohën e tij. Ne nga ana tjetër edhe na ishim të vetëdijshëm që duhet të ndërmarrim diçka që në këtë krahurë potenciale të mos ndodhnim të papërgaditur. Duhej t'i tregojmë edhe botës ku jem, në çfarë gjendje jem dhe çfarë duam ne dhe t'jemi pjesë, si t'thush e zhvillimeve të ardhshme që secili të përpiqet për vetën dhe ne t'përpiqemi për veten tonë.

Nuk ishte parapa data, siç thashë, por ishte parapa ai hark kohor kur do të ndodhnin, kur do të ndodhnin zhvillime të tilla siç ishte kryengritja e vitit 1981. Shqipëria megjithatë e mori shpejt vetën ta them. Doli hapur në përkrahje të kryengritjes, në përkrahje të popullit vlla që e kishte, vllazërve të saj. Krahina e Kosovës konsiderohej dhe ishte pjesë e natyrshme e Shqipërisë. Pastaj, edhe bota, bota demokratike po kshtu ishte në krah të kësaj. Shtypi botëror shkruante që kjo demonstratë ishte si të thush fillimi i fundit të Federatës Jugosllave.

CIA amerikane po thoshte që, parashihte shpërbërjen e Federatës Jugosllave. Kriza ishte e thellë jo vetëm në çështjen kombëtare në Jugosllavi po në krye të kësaj teme të çështjes kombëtare ishte Kosova dhe shqiptarët nën ish Jugosllavi. Nga ana tjetër kur ngjizen, kur bashkohen krizat, kriza kombëtare me çështjet kombëtare, kriza politike, kriza ekonomike sidomos e tjerë. Kur t'bëhen kto të gjitha bashkë është vështirë ta përballoj këtë gjendje të temperaturës shumë t'largë për ni shtet, siç ishte Jugosllavia.

Të gjithë kanë parapa që pas vdekjes së Titës... ai ishte që mbante kohezionin, mbante... se do t'ndodhnin, do të ndodhnin ngjarje të tilla. Po nashta s'e kanë mendu që pikërisht në Kosovë do të nisë ky proces. Jo vetëm në Kosovë po kishte refleksion edhe në gjithë Jugosllavinë sepse e thelloj krizën dhe e filloj, si të thush, atë fundin, fundin e Jugosllavisë.

Pjesa e Shtatë

Anita Susuri: Pas demonstratave filloj edhe diferencimi, fillun burgosjet në masë të madhe të rinjëve, të aktivistëve, u vendos ora policore. Si ka qenë për juve? Po m'duket që ni numër i madh i aktivistëve edhe të OMLK-së janë burgosë në atë kohë. Si ka vazhdu pastaj klima për juve?

Mehmet Hajrizi: Ne nuk ishim në atë valën e parë të arrestimeve. Sepse ata, ata nuk dinin kush krejt osht' i involvuar aty, kush krejt osht' organizator. Pastaj, ne megjithatë kishim mbajtur ni konspiracion edhe ni disiplinë të rreptë. Prandaj edhe kish bërë t'mundur që dymbëdhjet vjet rresht organizata jonë t'u bënte ballë ndjekjeve policore. Megjithatë për të bërë arresime n'masë, regjimit të Beogradit i duhej të krijonte një kuadër edhe ligjor. Për këtë qëllim ata duhej ta kualifikonin kryengritjen si kundër revolucion.

Duke i dhënë këtë kualifikim sigurohej pastaj mundësia që ndërhyrjet t'jenë të rrepta dhe burgosjet t'jenë masive. Sepse ka ndodhë ni kundër revolucion dhe ni kundër revolucion nuk e bëjnë dy njerëz,

as pesë, as dhjetë, as 20, as 50. Fill pas demonstratave çarkulloj ideja njëherë e shpalljes së gjendjes ushtarake dhe të administrimit ushtarak në Kosovë. Mirëpo u hoq dorë ndoshta për arsyet që i thashë ma përpara.

Me 05 maj viti 1981 lidhur, po flas lidhur me shpalljen kundër revolucion të ngjarjeve. Me 05 maj mbledhet Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Në këtë mbledhje ku merrnin pjesë edhe gjithë udhëheqja e Kosovës, duke qarë domethanë që ishte me porosi nga Beogradi që të përkrahej kundër, shpallja kundër revolucion e ngjarjes. Unë kom lexuar gjithë proces verbalin e asaj mbledhjeje dhe e kam ktu. Kanë qenë edhe të botuara në ni libër të veçantë, 'Konferenca e 17 e Komitetit Krahinor të Lidhjes Komunistëve të Jugosllavisë'.

Sikur nga një dirigjent të gjithë diskutosjet e kanë përkrahur shpalljen kundër revolucion të demonstratave në Kosovë. I vetmi që ka dashtëkëtë kualifikim ta quaj më ndryshe ka qenë Dervish Rozhaja në diskutimin e tij. Pastaj, i sheh diskutimet e tjera i hudhun kundër Dervishit përse, përse po bën kualifikim ndryshe e jo ashtu siç po bënte shumica dërmuese. Të nesërmen osht' mbledhë Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë por nga baza ishte marrë pëlqimi për kundër revolucion gjoja. Atje konfirmohet kjo.

Kurse një ditë më vonë, me 07 maj, mbledhet Komiteti Qendror i Lidhjes Komunistëve të Jugosllavisë dhe atje Lazar Mojsov e shpallë pastaj kundër revolucion kryengritjen e Kosovës. Me këtë u hap mundësia, u dha leja që t'bëheshin arrestime n'masë. Njerëzit që kishin qenë ma përpara n'burg i morën dhe i futën në izolim nëpër burgje. Njerëz që pak a shumë kishin dëgjuar për të se ka folë dikund diçka i arrestonin në masë. Gjithnji kuturu duke gjuajtur si të thush në ajër, ku të qëllojnë.

Dikund edhe gjetën organizator të organizatave, e bën ni grup të madh të demonstruesve që e dënuan. Grupi i studentëve e quanin ata që e kishin formuar për ta qit', nxjerrë para gjyqit. Ishin pastaj me dhjetëra, mijë të dënuar për kundërvajtje dhe penalisht. Nuk kishte larg që mund të vinin e trokisnin edhe në derën e organizatës tonë. Kishin marrë megjithatë njerëz, anëtarë të organizatës deri edhe anëtarë të komitetit drejtues. Kishin marrë njerëz por pa e ditur që i përkasin një organizate. Ata e kishin pasë pastaj ma të lehtë që të qëndrojnë.

Megjithatë nga fundi i vitit '81 ata arritën të kapin për një kohë relativisht të shkurtër gjithë komitetin drejtues. Nga komiteti drejtues kishte mbetë vetëm Kadri Zeka që ishte në Zvicërr, vepronte atje jashtë. Ktu u arrestuan shumë dhe u organizuan pastaj gjyqe në shumë anë. Po dënimet për kryengritjen e vitit 1981 kanë arritur dikund disa shekuj, disa dhjetra shekuj vite burgu që janë dënuar. Ku u kapën një pjesë e konsiderueshme e organizatës tonë. Por shumica dërmuese përsëri kanë mbetë jashtë. Të cilët pastaj janë riorganizu dhe kanë hy në lëvizjen e bashkuar, ku ishte bashkuar edhe organizata jonë.

Anita Susuri: Ju jeni arrestu me 18 dhjetor po m'duket?

Mehmet Hajrizi: Me 18 vjetor. Po kur jam arrestuar unë komiteti drejtues kishte pasë qenë i burgosur atëherë. Unë nuk e dija, nuk e dija këtë. Mund të them që aspak nuk e kisha hallin tim personal, as t'familjes time. Pësia që më rëndonte më shumë në shpirt ishte që ishte, kishte kap si të thush kreu i organizës, udhëheqja e saj, komiteti drejtues po edhe komiteti ekzekutiv që kem pasë një tjetër organ të këtij, kësaj organizimi, të këtij organizimi.

Ndërkohë ne kishim vazhduar me trakte gjatë gjithë verës edhe kishim vazhduar të botojmë Gazetën Liria që kishte filluar të botohej në vitin 1980. Kishim botuar deri ku ne denonconim dhunën që u përdor në demonstrata ku ne u bonim thirrje qytetarëve që t'qëndrojnë në të drejtën e tyre dhe Lëvizjes Kombëtare gjithë organizatat sa ishin atëherë. Kishim përgadit edhe një program të frontit për Republikën e Kosovës, i cili nuk u arrit ata muj të realizohej.

Por që në vitin 1982 pastaj bashkohen disa organizata ku hyn edhe organizata jonë dhe zhvillohet ajo organizatë, zgjerohet. Fillimisht është qujtë Lëvizja për Republikën e Kosovës pastaj LPK është quajtur shkurt. LPK që ka vazhdu pastaj jetën deri në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në radhë të parë prej saj domethanë. Derisa u mbyll ai kapitull i rezistencës, i luftës dhe i sundimit serb e jugosllav në Kosovë. Ishte, ishte kjo ana më e randë shpirtërore emocionale e një organizimi rreth dymbëdhjet vjeçar që u rreziku edhe u dëmtu aq keq e aq rëndë në vitin 1981 dhe '82 vazhdun pastaj këto.

Të tjerat, të gjitha të gjitha ishin më të, më të lehta sepse janë edhe personale. Unë tri drama, tri goditje t'rënda veçanërisht shpirtërore po thom, se kto fizike mos ta përmendi. Shpirtërore kam pasur gjatë burgut. Një kur kom pa dimenzionin e arrestimeve në organizatën tonë. Dy kur më 17 janar ishte vrarë anëtar i komitetit drejtues të organizatës tonë Kadri Zeka bashkë me Jusuf Gërvallën dhe Bardhosh Gërvallën.

Këtë lajm nuk e kom marrë unë më 17 janar po e kom marrë në fund të prillit. Sepse s'kam pasë unë kurfarë gazete as vizitë, as... po erdh një djalë aty që kishte marrë pjesë me një demonstratë në rastin e një vjetorit të demonstratës të '81-shes dhe ishte i anës së Kamenicës andej. M'tregoj që është vrarë Kadri Zeka. Kadri Zeka është vra? Kjo ka qenë goditja e dytë e randë që kom përjetuar. E treta ka qenë kur janë vra edhe dy anëtarë tjerë të organizatës tonë Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha në vitin 1974, më 11 '81, më 11 janar, më 11 janar 1982. Në natën midis, kësaj, 11 edhe 12 janarit.

Aty... janë rrethu, ata kanë vendosë të rezistojnë me armë dhe më në fund janë vrarë, janë vrarë te dyt. Ngjajshëm si Afrim Zhitija dhe Fahri Fazliu më vonë. Edhe Afrim Zhitija ka qenë anëtarë i organizatës tonë atëherë. Organizata jonë ka dhënë 13 dëshmorë e heronj që kanë dalë prej gjirit t'saj. Edhe atë ditë këtu ku u vendos pllaka e kam thënë këtë. Prandaj, atë ditë më shumë po bëheshin homazhe për ata 13 dëshmorë të saj sesa për vet organizatën dhe me meritë. Me meritë po bëhej kjo, bëhej mirë.

Anita Susuri: Po du m'u kthij te arrestimi juj fillimisht, më m'tregu se si kanë ardhë, a keni ide si kanë ardhë deri te ju edhe si ka ndodhë arrestimi?

Mehmet Hajrizi: Si... unë kam qenë i burgosur në vitin 1979, po kështu në dhjetor. Atëherë isha dënuar vetëm me dy muaj sepse nuk nxorrën gjë sepse e dija që jom i pari aty që duhet t'flas dhe i fundit. Nuk doli asgjë. Dy muaj kanë zhvilluar hetime. Tashmë po më njihnin ata që kishin pasë punë me mua atëherë në '79-ten. U pata liru unë atëherë, vetëm me një dënim për propagandë kundër regjimit.

Se si e kanë marrë vesh rrugën për t'ardhë te unë, këtë nuk e di as nuk jam e interesuar ta di kurrë. Nuk më është dashtë ta di. Vetëm për një gjë jam i sigurt që shumë organizata thonë që nga brenda njerëz të gabuar që kanë hyrë në demonstratë, kanë hyrë në organizatë e kanë dëmtuar dhe kanë denoncuar organizatën. Unë jom i sigurt që nuk, nuk ka pasë ndonjë denoncues që ka shkuar vullnetarisht të trokas në duart e policisë dhe t'ju thotë kam për t'ju thënë diçka, të bëj ni denoncim të ksaj.

Se kanë folë pastaj njerëzit kur kanë hy në sistemin e torturës çnjerëzore që ta bënin, aty pastaj nuk osht' ai denoncim. Osht' ni gjendje tjetër. Po unë edhe isha i përgaditur që do t'ndodhë ni ditë ky arrestim, sidomos në ato valët e... për ma tepër që isha ni familje e përndjekur jo vetëm kohët e fundit dhe jo vetëm për vllaun tim që kishte qenë n'burg po edhe ma herët edhe ma gjatë. Kishte pasë ni histori të dhimbshme si familje. Edhe po t'mos kishte bërë askush asgjë në shtëpinë tonë, ata do t'vinin të trokisnin ktu, të merrnin dikë sa për ta pasë brenda.

Për më tepër që ato kohë ishte vra edhe Naseri dhe kishin ardhë ata dhjetra mijë njerëz, jo pak, dhjetra mijë njerëz kishin hyrë e dalë në shtëpinë tonë. Kjo do të ishte e mjaftueshme që t'vijnë të marrin. Po nuk ishin kto asnjëra. Ata kishin ra në gjurmë të organizatës dhe mua nuk më morën të parin po më morën diku në mes. Kam qenë, kam punuar në arsim atëherë. Kam qenë n'shkollë n'orë të mësimi. Njëri prej atyre hetuesve që kam pasë unë në '79-ten e hapi derën e klasës ku isha brenda dhe m'tha, "Kem pak bisedë me ty, a po del jashtë?" Unë e njofta atë shumë mirë, e dija përse po m'thret. Thashë, "M'fal jom në orë të mësimi, tash edhe pak mbaron ora prisni dhe vijë unë. Vijë unë dhe bisedojmë".

Dritaret ishin në anën e kundërt të klasës dhe unë gjithmonë kisha paramenduar që kur t'vijnë të më arrestojnë, nëqoftëse vijnë n'klasë t'më arrestojnë unë do t'kceja për dritare dhe nuk ishte larg mali dhe futesha brenda. Pastaj vështirë do të ishte. Kurse ni revole, do ta them këtë me keqardhje, unë kam punuar në arsim gjithnji i armatosur. I armatosur po kurrë asnji nxënës i imi nuk ka mujtë me vrejt domethënë që unë kam armë n'trup. Atë e kam mbajtur që nëqoftëse m'duhet të ikë dhe armën e kam pasë pjesë të trupit. Edhe në shtëpi domethonë edhe aty ku kom fjet e kom pasë pranë. Me qëllim që të gjej rastin që t'shpërthej rrëthimin dhe të shmangem.

Kishim lënë gjithmonë dalje rezervë në ato baza ku ne po bënim mbledhjet po edhe në shtëpi edhe në fshehjen e materialeve. Aty mendoja edhe n'klasë po t'vinin mendoja që të kërceja në dritare dhe pastaj kur t'dal jashtë nxënësve nëse ata më vijnë mrapa unë mund t'them që unë shtij, mos m'u

afroni. Derisa të hy n'mal e pastaj gjej hall atje, nuk ishte ndonjë punë. Kisha përvojën që t'mund të shmangem.

Ai hyri. Atë ditë nuk kisha revole me veti sepse kontrollonin pas demonstratave, kontrollonin edhe nëpër autobus. Kisha frikë mos po m'gjejnë me të dhe m'çojnë atje tani del, si thonë, nxjerr ni kashtë e dalin gjashtë. Nuk e kisha me veti. Ai e shoh që ishte jo vetëm insistues po pashë që mrapa po ju thotë tjerëve si duket, po ju bon me kokë dhe pashë që ata kishin ndërmend të hynin të gjithë brenda dhe t'më arrestonin aty, para nxënësve. Do t'ishte gjendje e randë për ta. Që t'i shpëtoj asaj, ky ishte shkak, që t'mos e shohin dramën ata aty brenda dola.

Dola dhe hyjmë në sallën e arsimtarëve, aty më arrestuan dhe po shkonim drejt makinës. Kush i ka njoftu, kah morën vesh nuk di. Nga t'gjitha klasët kanë dalë nxënësit jashtë. Kanë dalë jashtë që t'më shikonin ose të merrnin përshëndetjen e fundit. Një nxënëse atëherë 13 vjeçare, ka pasë kerrin e krejt, dhe ka shkru aty për aty një poezi. Një poezi për mua si më morën, ashtu si e ka pa ajo. Tash ajo është poete dhe ka bërë dy libra. Ni Kimete Krasniqi. Ka shkruar edhe poezi tjera por këtë poezi e ka botu tash në përmbledhjen e saj të parë.

Kom parë pastaj atë përjetim të nxënësve t'mi që ende, ende e mbaj gjallë, ende e kujtojnë, ende e flasin, ende të mbajnë si t'thush, si një ankth të asaj kohe në shpirtin e tyre. Aty, aty më arrestuan dhe... me 18 dhjetor siç the. Meniherë po atë ditë, po atë ditë kanë filluar hetimet po atë ditë kanë filluar tortuar për t'vazhduar pastaj në mënyrë sistematike. Jo vetëm ndaj meje ndaj të gjithë të arrestuarve. Ajo që m'ka, m'ka ardhë ma rond osht' kur kom pa djem të ri, se vajza s'ke mund t'i shohim ne edhe gratë, kanë qenë në pavijone tjera për to. Kur kom pa djem t'ri, djem t'ri 15-16 vjeç t'përgjakur e të mavijosur.

Unë e kom pasë n'dhomë ni rom. Ai i Fushë Kosovës ishte dhe me shoktë e vet kanë dalë e kanë pritë trenin që ka ardhë nga Shkupi për të hyrë në Fushë Kosovë. Po treni ka pasë semafor përpara që duhej të ndalonte para se të hynte në Fushë Kosovë treni, ka pasë semafor për t'pritur që t'vijë treni nga Peja e tjerë. Që të ipet pastaj drita e gjelbërt që t'kaloj. Aty saherë osht' nalë treni ky me shoktë e vet kanë hyp nëpër vagona, në tren të mallrave, dhe kanë marrë sidomos kpucë. I kanë gjujt në arë me misër të mbjellur nga vagoni dhe ka zbrit vet. Treni pastaj ka shku. Kta janë hi i kanë mbledhë kpuctë edhe i kanë shitë.

Kishte ra n'burg, Sefedini. Në dhomë m'kishin heq dikur nga ajo qelia në vetmi që të mbajnë. T'ju them, ajo, vetmia ime dukej përafërsisht kshtu do t'bëj një përshkrim, ishte n'beton pastaj disa drresa n'formë të ni tavoline t'oborrit. I kishin vendosë nja katër këmbë dhe drrsat që lëviznin ato, ku mund të hypje për të fjetur. Po nuk kishte asgjë për të shtruar në drresa as për t'u mbuluar. Vetëm ajo ishte ashtu. Kur hipja n'të ajo lëvizte anash sikur kur t'përkund.

Dritarja nuk kishte xham, po kishte një llamarinë të shpuar krejtësisht ku hynte t'fotit e janarit, dhëtorit dhe janarit. Kur jom arrestu të dhejtorit. Ishte shumë ftohtë, s'kishte me çka të mbulohehe. Unë edhe ashtu isha në një ftohje të thellë kur kisha shkuar. Kisha barna me vete, m'i morën barnat dhe s'mi dhanë kurrë ma. Nuk m'dhanë barna tjera mandej. Ka atje një, një enë si qyp, kibëll i thoshin, ku kryen nevojat fiziologjike njerëzit. Ajo kish qenë plot e përmbushur dhe nuk mund ta hapje, nuk mund, ishte e tmerrshme domethënë e pa pastruar.

Anita Susuri: Kjo ka qenë në Burgun e Prishtinës?

Mehmet Hajrizi: Kjo në Burgun e Prishtinës ishte. Ende s'kom qenë ta shoh burgun tash që osht' hapur. Po duhej t'shkoj ta shoh atë dhomën fillestare ku m'kanë vendosë në atë qeli.

Anita Susuri: Në cilin kat ka qenë kjo?

Mehmet Hajrizi: Poshtë, poshtë ka qenë. Poshtë ka qenë jo lart. Sidomos ajo, ajo dritare me ato e hapur pa xham, ajo të tmerronte fare nga të ftohtit. Nga ana tjetër ishte edhe trupi i dërrmuar, ir rahur, i mavijosur, i enjtur. Po ma vonë i nxirrnin njerëzit nga aty dhe i vendosnin në dhomë. Dhomat, dhomat ishin jo me formë të rregullt sepse vet burgu osht' ni gjysëm rrethi prandaj edhe dhomat vijnë te dyrtë me ngusht kurse andej, nga shëtitörja ma gjon. Vijnë kshtu në formë të trapezit.

Aty më vendosnin dikund dhëtë vet. Nuk ka pasë shtrat aty. Filnim poshtë në dysHEME. Në mbrëmje duhet të shtriheshim të gjithë. Kanë qenë disa si dyshek, ato shtroheshin, kishte dyshek, dyshek të shtypur kushedi prej pas Luftës së Dytë Botërore, s'ndihmonin shumë. Ata dyshek u dashke në mëngjes të palosen ni qosh e jo të ulesh në ta ditën. Se ditën duheshe të uleshe në dysHEME dhe duhej t'i ndroje pozitë e trupit ku nuk t'dhem ende.

Vinin më merrnin mua orë e qas, natën e ditën, sidomos natën. Kur kthehesha pas torturave, dikund ora 03:00 t'mëngjesit ishte zënë vendi. Sepse ne bëheshim si sardina. Të gjithë domethënë pranë njëri tjetrit. Dhe për mu nuk kishte vend ku të hyja, ku të shtrihesh tash. Nga shtëpia më binin qepë. Qepë. Vllau im e kishte përvojën e Burgut të Prishtinës dhe mbase edhe prej tij domethënë mund t'ketë ardhë kjo, por edhe unë kisha kërkuar qepë.

Qeptë, qeptë janë t'mira kur goditesh dhe enjtet dhe mavijoset trupi. E qet' qat' qepë edhe mund të ndihmojnë. Kto qepë mbareshin në një pllakare, ni dollap i metalit që mbahej në koridor dhe mbaje aty gjë sendet e tua që t'kanë ardhë prej shpije. Vonë nisën m'i pru ato po vinin. Pastaj m'u leju edhe ni letër ta dërgoja në shtëpi dhe vllai im më dërgoj ni letër edhe tash po m'tregon ky që vajza jote ka vdekur. Kisha një vajzë aty dikund gati një vit jetë kishte bërë.

Me gjasë kur kanë hyer brenda ata në shtëpi kanë mbajtë dyrë hapur e ku ta di unë, kur kanë bastis, ku ta di unë sa kanë qëndruar aty deri kanë kontrolluar. Vajza e vogël dhe mund t'ketë marrë ndonjë

ftohje t'thellë. Kishte vdekë nja ni javë, as ni javë jo, pesë ditë m'duket pasi jom arrestuar unë. Kjo ishte prap, prap një nifar', nifar' gjendje e rënduar tash për ni fmi tëndin domethënë që nuk ishte krejt e lehtë ta përballoja atje pamarrë parasysh çfarë gjendje je.

Kur vija nga hetuesia në orët e vona, të gjithë ishin fjetë, përveç Sefedinit. Ky romi nga Fushë Kosova. Kurrë nuk flinte ai, gjithnji e kom gjetë të zgjuar. Bac më thoshte. Nuk dinte shkrim lexim. Ai më diktonte unë shkruja letra gruas të tij të dashur që sapo ishte martuar. Diktonte dhe unë shkruaja ashtu siç diktonte. Nuk thoshte, "Edhe", por thoshte, "Ere", "Ere mirë jam ere mos u mërzitni", unë krejt i shkrujsha "Ere, ere", ashtu siç diktonte (qeshë), siç diktonte.

Ai m'rrinte gati kur vija i merrte ato qeptë. I kërkoja gardianit kur vija i thosha, "Vetëm ni qepë të lutem ta marr", me mirëkuptim ma jipnin. Ai i merrte qeptë dhe m'i vendoste trupit. Kryesisht lart. Kem pasë ni banjë jashtë në shëtitore që e kishte derën aty në rrugë, jo në rrugë, po në atë shëtitoren ftohtë. Ishte plot borë aty dhe ne rrobat u dashke t'i lëmë, duhej t'i lënim në borë e të hynim ashtu lakuriq brenda që të pastrohemi. Brenda nuk kishte dritë. Banjo ishte e vogël, me thënë ni metër, ni metër e gjysë evetualisht jo ma shumë. Dhetë vet përpjekun me njëri tjetrin, s'mund të fërkoheshe. Lshonin ujë sa lshonin edhe, "Dil përjashta".

Kur hapet dera ni ditë Sefedini kishte pa plot kso mavijosje të trupit që e kishte trajtu. Kur ai po sheh që kisha edhe këmbëve unë plot me asi... tha, "Baci Mehmet, çka ke n'kamë kshtu?" Thashë, "Po ti e din i ke pa kto", tha, "Jo unë kto kurrë s'i kom pa s'mi ke tregu ti". Kto ishin ma pak t'rrezikshme dhe s'ja kom thanë kurrë. Veç i leja që t'shërohen vet. "Po çka t'paskan bo?" Ishin bo kamtë zi krejt, trupit. Shqetësohej Sefedini. Mbiemrin e kishte Sefa. Ai gardiani serb ia bojke, "Dupli Sefa" (qeshë).

Kam shkuar Fushë Kosovës bashkë me Haxherën, me shoqen time, e kemi kërkuar. I pysnim njerëzit, "A keni ktu naj Sefë, Sefedin në lagjen tuaj ose në Fushë Kosovë?" Nuk na thanë. Kushedi pse edhe çka na merrnin. Po nuk kom mund ta gjej. Kisha dashtë ta gjej atë njeri vetëm t'shpër mirënjohjen e thellë dhe ta falënderoj, ta falënderoj.

Anita Susuri: Në vetmi sa keni qendru në atë dhomën?

Mehmet Hajrizi: Në dhomën e parë atje, s'ka qenë aty ma shumë se as që kisha mund ta përballoja ndoshta ma shumë aty në atë vetmi të ftohtë dimër. Duhet t'ketë qenë dikund dhetë ditë ndoshta. Pastaj kalum ktu.

Anita Susuri: E në kohën kur ju kanë arrestu a e kanë ditë ata çfarë roli keni pasë ju në organizatë?

Mehmet Hajrizi: E nuk e kanë ditë edhe ktu tash du ta theksoj edhe një, një kujdes të krejt atyre që ishin, kishin qenë bashkëveprimtar me mu dhe që e kanë ditë që unë jam udhëheqës i organizatës. Asnjëni nuk e ka thënë këtë. Prandaj, unë nuk jom dënuar si udhëheqës i organizatës.

Anita Susuri: Nuk osht' kuptu kurrë.

Mehmet Hajrizi: Ata nuk e kanë kuptu kurrë. Kur erdhëm në gjykatë, njëni nga anëtarët e komitetit drejtues, Berat Luzha, kur erdhë në gjykatë po përgaditeshin t'na shpallnin dënimin. "Mehmet", tha, "a do t'bijnë tamon teshat që do t'i prejnë?" (qeshë). Se do të dënohesha sigurisht ma shumë. Po nuk osht' përmend kjo dhe nuk osht' ditë.

Anita Susuri: Ju jeni dënu po m'duket në vitin '82?

Mehmet Hajrizi: Në korrik. Dikund prej 08 deri me 10 korrik duhej të zgjaste, duhej të zgjaste gjykimi nja katër-pesë ditë po nuk di cila qe arsyeja e shkurtuan. E shkurtuan. Ne atë ditë, ditën e parë domethanë, pam që ndonëse kishte qenë në aktakuzë, Hydajet Hyseni njëni prej anëtarëve të komitetit drejtues, nuk ishte i pranishëm aty në gjyq.

Unë kisha pa disa vendime të vazhdimit të paraburgimit ku shkrunte, ky, ky, ky Jakup Krasniqi, Berat Luzha, Nezir Myrta e tjerë me emra, Mehmet Hajrizi kanë vepru kshtu, kshtu, kshtu bashkë me Hydajet Hysenin i cili ndodhet në arrati. Ky ka qenë nifar' lehtësimi për mua. Thashë paska shpëtuar njëni prej nesh dhe ai tash i përtrin radhët, sikur që kisha bërë unë me 1974 kur mbeta i vetëm nga gjithë udhëheqja. Thashë tash i përtrin radhët dhe mirë, n'rregull do t'jetë.

Kshtu e kishin marrë edhe të tjerët. Berat Luzha m'thotë, "Po e kom marrë ni vendim të tillë ku thuhej që është në arrati". I kisha besuar. Ajo kish qenë sigurisht një gënjeshtër e radhës. Nuk kishte qenë në arrati po kishte qenë në kohën kur filloj gjykimi ai kishte pasë probleme shëndetësore dhe nuk e sollën. Ne tash po e kuptojmë për herë t'parë që ai nuk qenka në arrati po ku osht' atëherë? Mos e kanë vrarë? Ku osht'? Si osht'? Tham që ne nuk flasim as nuk duam të jemi ktu në gjykatë për pa e sjellë edhe shokun tonë që na mungonte aty.

Ndërkohë ata shkun e sollën ni, çka me të thanë, një, një rezultat të një doktori shqiptar i cili thoshte që ai osht' me probleme shëndetësore. Po po na vinte nifar' konfirmimi që domethanë osht' dikund se ka ndonjë problem domethanë, mjafton për ne që t'ishte gjallë. Pastaj, fillun po patëm thënë që nuk flasim. Unë edhe Gani Syla ishim në një dhomë, na kishin ndarë neve para se të deklarohemi para gjyqit aty dhe po themi që a osht' mirë ne që t'mos flasim n'heshtje, kta na dënojnë se na dënojnë gjithqysh, folëm e s'folëm. E paraqet mbrojtjen ose s'e paraqet ti mundësh edhe m'u mbrojtë në heshtje.

Vendosëm që po flasim. Shkova unë n'sallë, më morën përpara. "A don të flasësh?" Thashë, "Po". Paraqita unë, thashë disa fjalë për t'cilat pastaj shkroi ni gazetar, Rustem Rugova quhet. Shkoj t'nesërmen që fliste kshtu, thoshte kshtu, ai kshtu, ai kshtu. Ndoshta për t'ja ndihmu pak edhe gjyqit që t'dënohet ma rreptë. Me ia kujtu çka tha. Ishte nifar' si prokurori n'veti domethonë ai me kto

qëndrime (qeshë). Pastaj shkroi edhe në vazhdim një në formë fitoni në disa vazhdime tek Rilindja të atyre ditëve për vet organizatën në disa radhë.

Unë isha në Prizren, më kishin dërguar. Kur kishin mbaruar hetimet më kishin dërguar në Burgun e Prizrenit. Nga Burgu i Prizrenit na sollën pastaj për t'u dënuar. Ishim disa atje, jo pak. Na sollën për t'na dënuar në Prishtinë. Aty takova edhe njerëz që s'i kisha parë përpara. U kry dënimi, procesi gjyqësor, u shqiptu dënimi dhe na kthyen n'dhomë.

Anita Susuri: Juve ju dënun me dymbëdhjetë vite?

Mehmet Hajrizi: Dymbëdhjet vjet, po. Ni gardian erdhi n'dhomë e hapi derën dhe po m'drejtohet mua. Gardian shqiptar ishte, me zë t'lartë thirri, "E Mehmet Hajrizi", e pashë që po përpiquej të shprehte respektin dhe mirënjohjen po nuk mund ta thoshte se mund dikush ta denonconte po e tha, e tha krejt çka kishte për t'thënë (qeshë) dhe m'bëri përshtypje t'mirë. Ni burrë i ndershëm, s'ka randësi njeriu ku punon, a osh' në burg a osh' ktu aty, nëqoftëse ai në shpirt është në paqe me vetvetën.

Pastaj u kthym përsëri atje në Prizren. Atje kisha kryesisht n'dhomë do djem të ri të pa formuar ende po me zemër t'zjarrtë, me atë vullnet, me atë qëndresë që nuk e harroj. Mbaj miqësi ende me ata. Atë ditë njëri prej tyre ishte ktu kur u vendos kjo pllaka.

Pjesa e Tetë

Anita Susuri: Zoti Mehmet ishit t'u m'tregu për burgun edhe Burgun e Prizrenit sa keni qëndru? Thatë që shumicën e kohës ose n'fakt gjithë burgun e keni kalu në burgje hetuese. Si ka qenë në Prizren?

Mehmet Hajrizi: Hetimet kanë vazhduar dikur gjashtë muaj në Burgun e Prishtinës. Pastaj për t'liuar vend për t'burgosurit e tjerë që mirreshin për hetime ktu, ne na nxorrën nga disa nga Burgu i Prizrenit dhe mu më dërgun nga Burgun i Prishtinës mua më dërgun në Burgun e Prizrenit. Kanë shpërndarë nëpër burgje të ndryshme edhe në Mitrovicë edhe vende tjera. Po mu m'çuan në Burgun e Prizrenit.

Atje gjeta n'dhomë djem të ri, pa i ra brisk ftyrës. Po siç thashë ma përpara shumë të vendosur dhe shumë të guximshëm, shumë të qëndrueshëm. Aty u bohej qefi që ishim ne aty ma tjetër, e pak si ma t'vjetër ishim unë që vija nga ni organizatë që kishte bërë përvojë t'gjatë veprimi edhe Shemsi Reqica që ishte burgosë me Ukshin Hotin e Ali Alidemaj e tjerë.

Prandaj, ne tash, ne të dy përpiquehim që bisedat t'i kanalizojmë në edukimin e atyre t'rive, në informacione të duhej t'ju jepnin edhe intelektual ndonjëherë e kshtu me radhë. Po bëhej, bëhej një debat i mirë aty me të rinjtë e atyre anëve. Aty kom qëndruar më shumë se një vit, po. Pastaj, jemi

dërguar disa prej nesh në Novi Sad. Të tjerët u shpërndan nëpër burgje të tjera. Në Novi Sad ishte burg hetues, ishte burg shumë i vjetër dhe ishte burg rigoroz.

E di në Zrenjanin ka qenë m'duket Ramë Buja dhe kur erdhi e prun aty tha, "M'kanë sjellë ktu me ni vendim për riedukim intenziv". Domethanë kërkohet burgu i Novi Sadit si ni burg veçanërisht i rëndë. Aty kem qenë nëpër dhoma siç tregova ma përpara të ndarë secili. Për mua kishte rëndësi që të evitoj ngatërresat me t'burgosurit politik të veprimtarive të ndryshme kriminale. Ata shpesh herë edhe porositeshin që të nxisin konfliktin dhe t'i rrahin t'burgosurit politik shqiptar...

Anita Susuri: Po mendoni t'burgosurit ordiner që kanë qenë?

Mehmet Hajrizi: Po. Aty ishin njerëz vrasës, njerëz delekuent të hajnisë e tjera. Kryesisht, kryesisht të rinjë. Po shpesh herë edhe me prirje agresive. Ndonjëherë vinin edhe njerëz të smurë, të smurë mentalisht, psiqikisht. Unë kom pasë n'dhomë ni kohë tre me epilepsi për shembull. Aty kom pa që kur njëni bie për toke prej tyre edhe kta tjetër që janë me t'njejtën smundje shtriheshin menjëherë. Ndikonte, ndikonte njëri te tjetri. Ndodhte te tret shtriheshin për toke. Gjendje të randa shëndetësore po edhe ata vunin shumë kur i kapte kjo krizë.

Pastaj shkarravitën nëpër dysheme, bien për toke dhe mund të rrezikohen që t'bien me kokë n'beton. Pastaj vjellin edhe bëhen, bëhen të rëndë për t'i duru brenda. Jom marrë me ta. Jom marrë me ta. Një e kom pasë afër kur fleja unë dhe kur e kapte atë natën, ai s'kishte si të rrëzohej se ishte ratë. Po vinte i mshonte shtratit tim me dorë për të treguar që jam në gjendje t'rëndë. M'duhej të zgjohesha që të afrohem dhe t'i ndihmoj.

Domethanë edhe nëqoftëse nuk janë në këmbë ajo krizë i kapë ata në gjendje të tillë edhe për së rati, edhe kur janë rat. Zgjatë kjo dikund rreth gjysmë ore më së paku deri në orë. Kanë tëk thyera pastaj edhe ndoten po osht' shumë e randë. Ishin për shembull në shëtitje jashtë dhe papritur vetëm kur pashim ranë n'shpinë, u rrzu dhe ra për toke. U dashke të merreshim. Kërkush nuk shqetësohej për kto punë që t'shkonte të ndihmoje aty. Ne duhej me solidaritetin tonë ta bëjmë këtë.

Ni djalë kushedi qysh kish ndodhë, dukej se ishte rritë me ni familje të kamur dhe e shihja edhe nga pamja e ftyrës që ishte ni djalë i kujdesur nga familja mirë. Mund t'kishte edhe prindërit intelektual po edhe t'pasur. E zija edhe kur i sillnin rroba e tjera që osht' i tillë. Kishte vrarë ni bashkëmoshatar të tij dikund 16-17 vjet ka qenë ai. Nji ditë ashtu siç ishte ulur ra përmbys me ballë për toke dhe të gjithë e pam dhe të tjerët aty. Asnjëni nuk lëvizi që t'merret me të.

Unë shkova e mora, e ktheva mar, e ktheva në krah po shoh që po merr frymë ia kqyri pulsën dhe po e thras. Marrë do ujë, i qes ujë ftyrës dhe qafës e tjerë e tjerë për ta pru n'veti. Dikur u përmend dhe erdhi, erdhi n'gjendje. Tash shkon i pytë ata, "Kush, a u kujdes dikush për mua?" Si duhet ai e kish pasë edhe përpara ndoshta. Po gjendja pas vrasjes atij i ka shkaktë atë ankth që nuk e linte t'qetë. Ata i

thonë, “Po”, “Kush u kujdesë?” Thonë, “Hajrizi”. Çuditet. Si osht’ e mundur ni shqiptar, anti shtetror i Kosovës të kujdeset për mua. I ka tregu si duhet edhe familjes.

Kur merr vesh vjen mu edhe m’përqafton thotë, “Ti ma ke shpëtua jetën. Unë do t’vdisja po t’mos kishte qenë ti”. Gjithë kohën pastaj sillej me mua sikur të ishte ni vlla i vogël (qeshë). Tash nuk kishte rëndësi për mua çfarë kombi është, çfarë kombësie. Ishte një i ri fat keq që i kishte ndodhë kjo qysh i kish ndodhë. Ai nuk ishte nga ata hajnia, nga ata, jo. Por ishte djalë i kultivuar, ishte i edukuar po i kishte ndodhë dhe nuk mund ta përballonte, nuk mund ta përmbante gjendjen.

Kur m’pyste ndonjëherë, “Sa je i dënuar?” Dhe ju tregoja. “Çudi”, thojke, “pse s’e vret vetën ti? Unë po t’isha dënuar kaq sikur ti do t’kisha vra vetën menjëherë, do t’bëja vetëvrasje”, thashë, “Mu kurrë s’më shkon ndërmend vetëvrasja djem të mirë. Nuk e vras unë vetën”. Por ju tregoja edhe përse jam. Osht’ tjetra interesant gjithashtu. Plot t’rinjë serb po edhe t’vjetër kishin mirëkuptim për veprimtarinë time.

Thoshin... ndoshta jo pse unë i kisha bind, unë ju flisja atyne për drejtësinë e luftës që bëm ne. Po thojsha, “Ne s’këm bërë asgjë, s’këm vrarë askënd, ne vetëm kërkuar që t’jemi t’barabartë siç janë serbët, siç janë kroatët, siç janë maqedonasit, t’jem edhe ne t’barabartë kurgjo tjetër. T’kemi një republikë siç e kanë nga një republikë gjithë populli”, “Po mirë”, thoshin n’fund, “s’ka ktu kurgjo t’keqe. Pse s’ju jepin juve republikën? Unë po t’isha ua kisha dhanë republikën meniherë”, (qeshë). Solidarizoheshin me mua. Ndoshta mendonin që po ma lehtësojnë edhe burgun ashtu.

Ndonjë tjetër thoshte, “Unë kur t’shkoj n’shpi do të dërgoj ty para. Ty a të dërgojnë para ndonjëherë nga shtëpia?” “Po më dërgojnë”, “A t’kanë dërgu ndonjëherë për shembull dhetë mijë denar?” “Po ka ndodhë që kanë dërgu”, “A ka ndodhë që të kanë dërgu dhjetë mijë e 500 denar?” “Jo kshtu nuk dërgojnë kurrë”, “E unë do t’i dërgoj dhjetë mijë e 500 kur t’më lshojnë, dije që janë t’mijat ato”. Nuk i dërgoj asniherë po ishte e mjaftueshme që e përmenden këtë (qeshë).

Erdh niherë vllau i madh, baba i Naserit. “Si po kalon”, tha, “ktu n’burg me njerëzit n’burg brenda?” Thashë, “Mirë”, thashë, “i kom t’gjithë hajna”, thashë, “dhe i dëgjoj me kureshtje kur m’tregojnë”, thashë, “kshtuqë me nifar’ mënyre e kom mësuar”, thashë, “në detaje hajnin prej tyre”. “Ani bre vlla”, tha, “bile ni zanat merre sa je qitu në burg” (qeshë).

Anita Susuri: I përmendet vizitat, vizitën e vllaut po edhe vizitat e tjera nëse mundesh me na tregu qysh ka qenë për familjen me ardhë deri në Novi Sad? A ka qenë e vështirë rruga?

Mehmet Hajrizi: Ka qenë e rëndë sepse vajtje ardhje bënin dikund rreth një mijë kilometra. Një mijë kilometra. E para e punës gruan time nuk e pranonin n’punë. Niherë e kishin pranë gabimisht, gabimisht po thom n’thojza, në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Obstetikës. U bë mir. E pam atë tabelën ku kishin dalë ata që ishin pranë, ishte emri i saj, n’rregull. Pastaj kur shkon kjo paraqitet n’punë i thonë, “Jo ti nuk je pranë”.

Shkoj një shok i vllaut tim Zeqirit që t'shikonte se e njihte drejtorin. 'Pse e keni heq nga lista gruaja që është pranuar këtu në punë?' Ai i kishte thënë, 'Për besë kemi qenë të detyruar se ka ardhë nga Komiteti i Lidhjes së Komunistëve na kanë kërkuar që ta heqim'. E kanë heq dhe ma s'e kanë pranuar kurrë deri në '85-tën a '86-tën. Tani ka hy në punë aty.

Po du t'them që nuk ishte gjendja ekonomike materiale që të përballohej një vizitë në Novi Sad sepse kushtonte, kushtonte të paktën sa një rrogë e atëhershme mesatare. Edhe vllazërit e mi nuk ishin në ndonjë gjendje t'mirë materiale. Ishin edhe ata keq. Po kjo hajde e fundit. Po e para ishte rëndë sidomos për fmitë e mi që ishin t'gjithë t'vegjël. Ishte akoma ma e rëndë për prindërit e mi që ishin shumë të moshuar dhe nuk mund t'vinin.

Baba im nuk ka ardhë në vizitë kurrë asniherë, nuk ka mund t'vijë për moshën e tij që ka qenë mbi 80 vjeç. Ai vdiq pa m'parë mua. Kur erdha nuk e gjeta. Dy javë pas vdekjes t'tij vdiq edhe nëna, as atë nuk e pashë. Po nëna erdhë niherë në Novi Sad. Nji shok i vllaut t'madh, Beqiri, shok i punës kishte ni makinë dhe thotë, "Jam gati që me makinën time ta dërgoj nënën e Mehmetit që ta vizitoj në Novi Sad". Vllau i tij po kshu kishte qenë i burgosur politik me LRBSH-në e Adem Demaçit të viteve të '60-të.

Erdhi ai dhe ma solli nënën. Jam mirënjohës atij njeriu që pashë nënën dhe që m'pa ajo mu. Erdhi, erdhi në Novi Sad dhe atje fillimisht ne i bënim vizitat me atë rrjetën e hekurt të metalit që e shef ftyrën e tjetrit të katerorizuar me atë hekurat. E pastaj na dërgonin në ni dhomë, ni dhomë t'madhe e të gjatë që ishim larg njëri tjetrit kur vinin në vizitë. Ni tavolinë e vendosnin n'mes, tavolina mbulohej me një bez deri n'tokë. Ata t'burgosurit që e pastronin pastaj sallën aty m'treguan që n'atë tavolinë ka një magnetofon që inxhizon bisedën brenda.

Po unë e merrja me mend dhe e disha që bisedat tona inxhizohen edhe për arsye se po flisnim shqip. Ata nuk kuptonin prandaj inxhizojnë që pastaj t'i përkthejnë dhe të kuptojnë se çfarë po flasim. Tavolina vendosej përpara meje nja tri-katër metra edhe nja tri-katër metra larg ishin ata që kishin ardhë n'vizitë. Domethënë nja tetë metra ishim larg njëri tjetrit. Vizita ishte një herë n'muj dhe zgjaste 15 minuta deri 20 maksimumi.

Që t'vije në radhë që të hyje në vizitë duheshe të prisje gjithë ditën atje dhe në mbrëmje në errësi të ktheheshin, vinin në shtëpi. Rruga ishte e gjatë. Me tren duhej të udhëtohej deri në Beograd, në Beograd pastaj duhej të ndrrohej dhe të merrej një autobus për të arritur në Novi Sad dhe kur vinin atje, vinin të dërrmuar, të dërrmuar, fmitë sidomos. Zakonisht e porosisja Haxherën, "Mos i sill fmitë", sepse kisha frikë se do t'sëmuren e do... edhe ashtu na kishte shkuar një. T'mos ndodhë e keqja edhe me kta tjetër. Por megjithatë ndonjëherë nuk duroheshin e vinin.

Anita Susuri: Çfarë moshe kanë qenë fmitë?

Mehmet Hajrizi: Atëherë unë i kom lanë kta me ni shtëpizë t'vogël ktu përpara në oborr. Po kur kom ra n'burg unë unë vajza ka qenë katër vjeç, djali i madh ka qenë dy vjeç kurse tjetri ka lind gjashtë muj pas arrestimit tim. Ky i vogli ishte rritë tash dhe kishte fillu edhe t'flas kur po vjen atje. E pys... kishte ardhë bashkë me motrën po m'duket, me motren e vet, me Albanën. Kur jom arrestu unë i kom lanë me ni shtëpizë e vogël krejt, si kasolle ka qenë.

Pastaj e kanë ndërtuar vllazërit nga t'hollat që kanë marrë që kisha shitë shtëpinë poshtë kam qenë në qytet dhe kanë ndërtuar këtë shpinë ku jemi tash ktu, këtë shtëpinë. Domethënë është e ndërtuar në vitin 1982 kjo shtëpi. Prandaj ka erën e shtëpisë t'vjetër, t'mykut. I kisha lënë atje. Po e pys tash, thojsha s'më tregojnë kta, kisha dëshirë kur po dalin në shtëpinë e re familja. Thashë ta pys djalin e vogël ky osht' i singertë dhe m'tregon.

Thashë, "A keni hy në shtëpinë e re?" "Po", tha. Thashë, "Shumë mirë". I besova dhe u binda që ka hy. Vajza, e motra, tha, "Jo s'osht' e vërtetë", tha, "s'kemi hy ende në shtëpinë e re". U zu tash n'rren ai. Tha, "Unë kom hi disa herë", (qeshë). Ai kishte hi në shpinë e pa pregaditur ende, e pa meremetuar (qeshë). "Kom hy", tha, "disa herë". E kuptum tash thashë, "Mirë shumë".

Anita Susuri: E qysh ka qenë reagimi i fmive t'juj ndaj juve në vizita?

Mehmet Hajrizi: Ata, ata shikonin të habitur, shikonin t'habitur dhe tërë kohën shikonin drejt meje po ktheheshin dhe shikonin ata gardianët që rrinin n'mes anash, që survijonin bisedën. Kishin prej tyre ni drojë, kishin dëshirë ata t'mos jenë që ne t'jemi bashkë dhe t'përqafohemi njëherë se nuk mund t'flisnim as dorë më dorë. Nuk lejonin.

E ndjeja që nuk, nuk... ma t'libër ishin shumë kur m'shkruanin dhe ju shkruaja letra. Me letra komunikoj. Komunikoj me ta mirë domethanë. Osht' ky libri 'Korrespondent në cenzurë' që... po megjithatë ishte nën cenzurë. Nuk mund të flisje gjithçka, për më tepër që Haxherja e kishte ni dosje dhe duhej shumë kujdes që t'mos lëm asnjë mundësi që mund ta kapin ni fije dikund që do ta rrezikonte këtë.

Fundi fundit në qoftëse ti do t'shkruje diçka atje që është e dënueshme nuk vinte letra n'shipi. Unë jom kujdes që t'mos ndodhë kjo po shumë letra nuk kanë ardhë as te unë as te kta, kanë humb. Disa që kanë shpëtuar janë ruajtur, u botuan ato në ni libër po u botuan vetëm letrat me fmitë edhe me bashkëshorten. Po me vllazërit, me motren time, me prindërit e mi nuk janë botu sepse do t'bohej voluminoz shumë libri dhe mbetën ato pa u botuar.

Anita Susuri: E kshu gjuha me cenzurë a ka qenë qysh... çfarë fjalë keni përdorë për me tregu diçka e mos me u kuptu?

Mehmet Hajrizi: Letrat, letrat ishin, ishin problem në vehte sepse mund të nxirrnin informatë edhe nga letra prandaj duhej patur shumë kujdes. Për shembull, po përmend në burgun e parë kur isha dënuar në vitin 1979, atëherë u arrestuan shumë veprimtar për shkak të një trakti me, ma i gjatë se t'gjitha traktet tjera që kishim shpërndarë ne, organizata jonë, në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës. Ky trakt ishte hartuar dhe shpërndarë pas një vizite që kishte bërë Josip Broz Tito ktu në Kosovë dhe la porosi që të luftohej ma egërsisht kundër Lëvizjes Kombëtare të Kosovës.

Ne pastaj e demaskum këtë dhe treguam kush është Titoja i vërtetë. Cili osht' anti shqiptarizmi i tij e tjerë e tjerë. Shkrujtëm dhe filluan pastaj që t'kapin. Po nuk dinin kush e ka bërë këtë dhe kapnin njerëz. Morën sidomos nga Lëvizja Nacional Çlirimtare e Metush Krasniqit disa po më morën edhe mua bashkë me Gani Sylën. Atëherë traktin e kisha shkruar unë. Duhej shkruar një letër në shtëpi. Që të shkruja këtë letër duhej ndryshuar krejtësisht sintaksa ime dhe kaliografia të bëhej krejt ndryshe se kisha frikë se kanë pasë ekspert kta që e studiojnë dorëshkrimin edhe e gjejnë, e gjejnë njeriun edhe n'bazë të saj, e vërtetojnë aty ku dyshojnë.

Këtë e bëja me qëllim që t'i shmangen rrezikut që t'më identifikojnë në bazë të gjuhës edhe të shkrimit. Krejtësisht e ndryshoja. Shkruja ndryshe që s'ishte edhe punë e lehtë ta ndryshoja shkrimin. Atëherë i kanë studiuar këto ekspertët e veçantë të kriminalistikës për të gjetur, për të gjetur për të vërtetuar. Për shembull, po përmendi ni rast, kur osht' kap programi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve të Adem Demaçit ata kanë dyshuar që ai program do t'jetë shkruar ndoshta në Tiranë dhe jo këtu në Kosovë.

Ishte emri i Adem Demaçit që përmendej që ai e ka shkru po nuk besonin. Prandaj, kanë bërë analiza, analiza të hollësishme, thonë tetë muaj, derisa u vërtetu saktë që shkrimi është autentik i Adem Demaçit. Janë n'gjendje domethënë, ish n'gjendje të nxirrnin n'hetuesi edhe emra të vërtetë të atij shkrimi. Kisha frikë që do të gjendesha që isha autor i traktit dhe po t'vërtetohej kjo atëherë do t'dilte punë. Se nuk kam mundur unë vet t'i shpërndaj traktet në shtatë qytete të Kosovës në të njejtën orë. Duhej t'i thosha edhe njerëzit kush kanë qenë atje. Po shpëtova.

Ni letër e shkrova n'shpi m'duket edhe atë letër krejt të çoroditur edhe në sintaksë edhe në... u përpika të shkruj ashtu si... ata e dinin që unë s'isha analfabet, isha intelektual po megjithatë unë kisha shkruar aty sikur ni gjysmë analfabet. Për ta kamofluar këtë. Letrat, kom lexu edhe letra të tjerëve. Diku diku kanë shkruar më hapur domethënë. Që kanë shkruar. Po unë kom qenë shumë i kujdesshëm për arsyet që i thashë ma përpara. Letrat janë ba edhe me alegori, me simbole, me... për të thënë diçka që nuk do t'kuptohej lehtë. Se di a e përmenda për shembull rastin e atyre patateve...

Anita Susuri: Po, po.

Mehmet Hajrizi: E t'i thush tjetrit nxjerrni patatet se prishen e bahen e kshtu, në të vërtetë nxjerrni materialet ose nxjerrni revolen që të mos ndryshket e të mos priset e kshtu me radhë. Kshtu, ksi far' simbolika ka pasë e metafora të ndryshme që janë përdorë, janë përdorë.

Anita Susuri: Çfarë, për shembull, qajo po m'intereson? Qajo me simbolika?

Mehmet Hajrizi: Ka pasë kso. Unë edhe prej ktyne madje jom përmbajtë për aq sa kom mujtë. Po jom përpjekë që letrat e mia t'kenë ni rol edukativ te fmitë sidomos. Kurse ndryshe për shembull shkruj me vllëzërit, me prindërit e tjerë. Po ktu me fmitë osht' edhe ma vështirë të komunikosh me fmitë, janë botë n'vete dhe botë e veçantë fmitë. Që nuk osht' lehtë të hysh n'botën e tyre dhe t'komunikosh me ta. Janë si të thush edhe vlerësues ma t'mirë edhe për ato që i lexojnë.

Ka shkruar dikund Bedri Dedja është ndër shkrimtarët ma t'mirë që ka bota shqiptare për fmi. Bedri Deda ka shkruar shumë për fmi dhe me profesion ka qenë psikolog . Ka qenë edhe kritik letrat. Ka shkruar për krijimtarinë letrare, për fmi sidomos. Bedri Dedja thotë, 'Nuk ka nevojë kurfar' kritike për letërsinë për fmi. Ke shkru ni libër për fmi? Po. Shko ni dite dhe tek lozin fmitë thirri që t'vijne dhe ta lexojnë librin tënd. Ulu dhe lexo nga libri yt. Nëqoftëse fmitë rrijnë gjithë kohën sa ti lexon aty, libri yt ka dhanë provimin është i mirë. Nëqoftëse ata ndëgjojnë pak kohë dhe ikun, shkojnë te topi i tyre dhe vazhdojnë lojën...' ky osht' kritiku ma i rreptë që ta ka vlerësu librin tënd që nuk osht' për fmi, nuk osht' i mirë.

Janë të ndjeshëm, kanë botën e tyre. Është interesant letrat e tyre që shkrujnë, janë interesant vizatimet që ata bëjnë. Ajo që m'ka ra n'sy osht' që kta kanë vujtë edhe n'shkollë kur kanë shku pastaj. Nuk kanë tregu që e kanë babain n'burg.

Pjesa e Nëntë

Anita Susuri: Zotëri Mehmet ishit t'u na tregu për korrespondencën edhe për fmitë e ju, ato letrat që i keni dërgu për simbolikën që keni përdorë.

Mehmet Hajrizi: Letrat siç thashë, komunikimi me fmi është i vështirë, po përpiqesha që t'hyj në botën e tyre dhe t'i përshtatem asaj botës me të dhe të ndikoj sa ishte e mundur edhe prej atje të ndikoj në edukimin e tyre. Një bashkëveprimtar i imi e ka lexu atë librin 'Korrespondent në cenzur' që e kam pasë me fmitë. Kur erdhi ktu, Hasan Malaj, vllau i Rexhep Malaj. Kur erdhi ktu i tha Haxheres, "Ti", tha, "s'kishte qenë vetëm gjatë burgut. Mehmetin e kishe pasë ktu", (qeshë). I ka lexu letrat dhe sigurisht unë përpiqesha nëpërmjet letrave t'jem prezent në familje domethënë sa t'jetë e mundur.

Po ka pasë edhe raste ku njerëzit fshehurazi kanë nxjerrë edhe ndonjë poezi, ndonjë shkrim për jashta. Sigurisht me rreziqe. Tash ka pasë mundësi për shembull në rroba dikund t'futet ndonjë letër e butë që

nuk mund të dallohet, ta zam në jakë të kmishës a diku tjetër ktu. Në bukë nuk ke mujtë ose në ato tepsitë që gatujnë diçka s'ke mujtë sepse ato i kanë pre, i kanë pre dhe i kanë kontrollu.

Kshtuqë ta prishnin krejt atë ushqimin t'u i fut dur të aty e thikat, ku ta di unë. Duhej të ishim t'kujdesshëm edhe në gjuhën e zopit madje edhe në ato që donim t'i nxirrnim jashtë ose t'i fusnim brenda. Kontrolli sidomos në burgjet hetuese osht' shumë ma rigoroz. Siç ishte Burgu i Novi Sadit bie fjala.

Anita Susuri: E cila ka qenë arsyeja që ju keni qenë n'burg hetues? A veç rastësi apo e qëllimshme?

Mehmet Hajrizi: Nuk e di, nashta duhet pytë ata (qeshë).

Anita Susuri: S'e keni kuptu domethonë? Deshta edhe me ju pytë për leximin që e keni bo n'burg ndoshta. A keni pasë t'drejtë për gazeta? Libra?

Mehmet Hajrizi: Jo, në hetime jo. Në hetime s'ke pasë t'drejtë as letra, as kurfar' mjeti të informimit, kurfar' gazete asgjë të shkruar domethënë. Kurse pastaj kur t'mbarojnë hetimet po. Parapaguanim Rilindje dhe me postë i dërgonin. Por Rilindja kurrë nuk vinte, ose jo vetëm Rilindja, edhe gazetat e tjera. Bile kishim edhe gazeta të Kroacisë e të Serbisë që i merrnin edhe t'burgosurit tjerë kishe mundësi pastaj t'i lexoje. Kam përcjellë. Po edhe ne, edhe ne i merrnim ato. Rilindja për shembull vinte nja tri-katër ditë me vonesë gjithmonë. Po neve s'na prishte punë. Kryesorja mbaheshim të informuar.

Anita Susuri: A kanë qenë të censurune ndoshta ndonjëherë edhe gazetatat?

Mehmet Hajrizi: Po kur gazeta ka pasë diçka që atyre ju ka dashtë që t'mos ta kesh ti atëherë s'ta kanë dhanë fare. Kjo ka qenë forma e censurës domethënë po jo me heq ndonjë faqe, a ndonjë fletë. Po ka pasë raste.

Anita Susuri: E brenda burgut m'tregut ma herët që ka pasë edhe punë që keni bo që ju ka rëndu edhe shëndeti.

Mehmet Hajrizi: Po ata na thanë që nëqoftëse doni t'dilni t'punoni, mund të dilni. Kjo na vinte mirë se do të takoheshim të burgosurit shqiptarë mes veti. Deri atëherë gjuhën shqipe kishim nisë ta harrojmë ta flasim. Pa folë kurrë shqip veç vet me vete. Nga ana tjetër na vinte pak inat që t'dalim dhe t'punojmë për ta. Megjithatë kishin pasë vendosë t'gjithë që po të dalim. Kjo ishte mirë edhe të ndrrosh pak ambientin që osht' vet qëndrimi në ni dhomë, shtatë, tetë, dhjetë vjet bon efektin e vet edhe psikologjik tek njeriu. Osht' ajo psikologjia e burgut që është e rëndë dhe sigurisht ka edhe efektin për të tjetërsuar si personalitet.

Dolëm, dolëm t'punojmë po puna ishte e rëndë, punohej me beton. Me beton bëheshin figura, jo figura po bëheshin punë t'betoni me ksi shtylla të betonit. Pastaj ato anësoret e rrugës që vendosen. T'randë janë ata, t'mdhej. Pastaj kishe punë me beton, duhej të punoje në beton. Unë ju thashë, "Jam shofer", dhe ma dhanë ni asi vinçi me ato stetika që i ka përpara për t'bajtur peshë. Kisha, duhej aty ku ka qenë ni fushë e rrafshët ku prodhoheshin ato elementet e betonit, duhej tash të transpotohen ato prej aty dhe t'çohen me ni vend ma larg dhe të stivohen në grumbuj.

Ato i kom bartur unë me atë makinën time. Atje pastaj vinin njerëz t'i marrin me kamiona që i blinin ato. Ka pasur rast kur kamionët kanë qenë të shqiptarëve, të Tetovës. Ndonjëherë kur kishte mundësi ndonjë përshëndetje e bënin domethënë. Niherë njëni m'tha, "A ta sjellë ni shishe raki?" Thashë, "Po ku po t'shkon mendja te rakia. Po çfarë rakie hiq rakijes s'du raki", (qeshë). Po aty ishte kontrolli shumë i rreptë i gardianit.

Një gardian shumë i ligë, shumë i poshtër. Ai m'kontrollonte... kur ngarkoja tash kto i kapja, unë kta bllokat e betonit që janë për ndërtime, kanë qenë dikund nja 50-60 blloka që i kapja përiherë unë të gjithë ata blloka. Ashtu siç ishin, jo me këto thikat, pirunët poshtë m'i kapë, po ky i kapje bllokat që t'i shtrëngoje mes vete. Po t'i shtrëngoje shumë mund të theheshin bllokat dhe rashin t'gjithë poshtë. I kapja, tash isha mësuar sa është masa për t'i shtrënguar aty. I kapja dhe i ngarkoja në kamion drejtpërdrejt me këtë mjetin.

Ai gardiani dyshonte edhe mos kom fut unë diçka n'blloka kur e kom stivos aty mos kom fut diçka e po ia qes atij n'kamion që ai tani t'lexoj porosinë time. M'hynte... unë e ngreja ata lart dy-tri metra, tri metra që mund ta vendosësh në kamion, kamioni ishte i lartë, i madh. Ai vinte dhe m'hynte ndonjëherë përfundi asaj që kisha ngritë unë, 60 blloka, i shikonte mirë çka ka. Kishte rrezik. Se nganjëherë ata bllokat, gjon ishte dikund ni metër e gjysë a dy s'di sa ka qenë, kishte rast kur bllokat rashin kah pak poshtë bëhej si hark. Po t'binte vetëm një ata do t'rashin gjithë domethënë.

Kisha rrezik që ta mbys unë atë njeri. A ishte i vetëdijshëm që po rrezikon, a ishte asi trimoshi që hynte në atë rrezik, po unë shqetësohesha tash më shumë se thojsha e mbys dhe kë mbyta, ni maskara dhe tash duhet të shkoj në gjyq përsëri tash unë për të. I thom niherë, "Mos m'hi nën kta bllokat se kta bijnë ndonjëherë, do t'bijnë n'kokë", thashë, "unë nuk po di qysh". Ai kishte mundësi me hyp atje ku i marrsha unë, me hypë me kqyrë atje. Por jo... kam pasë shqetësim për këtë njeri që s'kisha asnjë dhimbje për të po edhe me m'pasë thanë a po don ta vrasësh nuk do ta vrisja. Pse ta vras një njeri fat keq që ka ardhë me marrë do para për ta mbajtë familjen e vet. Por mund ta vrisja.

Kshtu kam punu nja, punova nja dy vjet ndoshta. Mot mot e gjysë a dy vjet. Kom pasë zakon unë në burg mbaja shënime. Mbaja shënime për ato që lexoja. Aty ktu ndonjë koment t'vogël me kujdes se nuk lejonin që ato t'i marrësh në shtëpi. Unë kisha bërë shënime edhe në Novi Sad edhe në Prizren. Në Prizren arritëm disi ta nxjerrim ni laps me Shemsi Reqicën se nuk lejonin lapsa n'burg. Kurse në Novi

Sad lejonin të kesh laps dhe merrja shënime. I kom edhe sot nja 20 fletore të mbushura me shkrim të im krejt se duhej t'i kurseja fletoret që i kom marrë atëherë.

Njerëzit që dolën para meje nga burgu ua morën fletoret me shënime. Kur dola unë ishte një serb, serb i Vojvodinës. Atyre serbëve të Vojvodinës serbët u thonë llallë. Llalla ka qenë njeri i urtë, nuk, nuk e kishin atë egërsinë e sjelljes prej gardianit serb. Kishte fillu megjithatë fryma e transformimeve në Ballkan. Prandaj, edhe në Serbi kur intelektin verbal ishte hequr. Mund të flisje pak më lirë domethënë, e tjerë. Kur dola, unë i kisha marrë fletoret të gjitha i kisha fut me në çantë çka kisha mveti. Ai e mor' po i kontrollon t'parat. E çeli, po i sheh shkrime, shkrime. S'kishte gjë tjetër. Dikur m'pyti, "A janë", tha, "t'gjitha sikur kjo?" Thashë, "T'gjitha", "Hajt", tha, "*nosi*", baju domethënë.

I mora fletorët më shpëtuan. Ka shënime nga librat që kam lexuar. Kam lexuar shumë në burg. Atje nuk kishe vend ku ulësh në Novi Sad për shembull po as në Prizren. Për Prishtinë ma mos t'flas. Atje i kem pasë shtretërit po nuk ke guxuar të ulesh në shtrat ose të shtrihesh, në asnjë mënyrë. Kjo ka qenë e dënueshme dhe aty meniherë pa një pa dy ka fillu karbaçi të punoj për riedukim. Prej orës 03:00 masdite kem pasë t'drejtë t'bijmë t'flejme deri në ora 05:00, dy orë. A beson ti që kurrë unë nuk kom fjet ato dy orë, kurrë s'i kom shfrytëzu për gjum.

M'bëhej mirë që ora 03:00 mund të shtriheshe dhe s'mund t'vinte kërkush të thonte pse ke ra. Sepse ora 03:05 binte në sirenë që duhej të gjithë të ngriheshin në këmbë dhe të qëndronin gatitu në nderim të Josip Broz Titos që paska vdekë në qat' orë. Ne shqiptarët nguteshim shpejt në ora 03:00 t'bijmë sa s'ka ra ajo sirena që ta zëjmë shtratin. Se mund t'kontrollonin ata edhe nëpërmjet asaj vrimës vëzhguese nga dera e dhomës. Po gjatë ditës lexoja diçka ma t'lehtë dhe të gjitha në këmbë.

Në shtratin e epërm, se shtretërit kanë qenë kështu të marinarëve, domethënë në kat poshtë, kati tjetër lart. Në shtratin e epërme tamon më vinte që ta vendos librin dhe të mbështes duart pak aty dhe t'lexoj ashtu në këmbë ose t'marr shënime. Kurse prej orës 03:00 deri në ora 05:00 merrja tash në literaturë shkencore që t'lexoja ma serioze diçka kur s'dëgjohej asnjë zë. Të gjithë flenin ata kolegët e mi hajna e kriminel. Flenin në atë kohë unë mund t'lexoja diçka më serioze domethënë. E kom shfrytëzu qit' dy orëshin për lexim serioz, ma shkencore, ma t'randë që t'lexoj.

Libra m'kanë sjellë nga shtëpia. Aty kishte libra pak jo shumë dhe të përzgjedhura edhe ato që i kishte dërguar sigurisht Sekretariati Krahinor i Jurisprudencës ktu. Na jipnin po ma shumë kanë sjellë nga shtëpia. Nga shtëpia m'kanë sjellë çdo muaj nga dhjetë 15 libra dhe i kanë kthyer pastaj ato që i kisha lexuar. Gjithë i kam ngarkuar, kanë qenë të ngarkuar me libra për t'i sjellë atje dhe për t'i kthyer në shtëpi. Disa libra kanë humb krejt, nuk, nuk i kanë marrë.

Anita Susuri: Me postë ju kanë dërgu librat apo?

Mehmet Hajrizi: Jo, jo kshtu familja n'dorë, n'dorë. Po unë kur i kom kthyer pastaj çantën me rroba se unë s'kom pasë rroba burgu. Meqenëse ka qenë burg hetues rrobat kanë qenë kto. Kurrë s'kom veshë rroba burgu unë. Kom qenë me kto rrobat e shtëpisë, rrobat e mija. Po kto duhej kthyer në shtëpi për t'i pastruar, atje nuk i pastronin. Mbushej ni çantë rroba se gjatë gjithë muajit ishin bërë disa palë rroba pa pastru, të brendshmet e tjerë. Ato ktheheshin me ni çantë që t'pastrohen dhe pastaj të sjellin të pastërta mujin tjetër e kshtu me radhë.

Përveç ksaj ni çantë tjetër mbushej me libra, me libra për t'i kthyer. Kur kom dalë nga burgu mbetën dikund nja tre-katër bashkëveprimtar që bashkëvuajtës si të thush aty dhe ju lash librat e mija. Kanë qenë dikund mbi 150 libra që ju kisha lanë. Kisha libri, m'sillnin libra....

Anita Susuri: E bashkëveprimtarët që i përmendet, qysh ka qenë komunikimi juj n'burg? Sa keni arritë me bisedu ose...

Mehmet Hajrizi: Po. Në Burgun e Prishtinës ke mund të bisedoje nëqoftëse e ke fqinjë në dhomë, në dhomën tjetër. Atëherë trokitet n'muri edhe afrohet e flitet n'muri. Ati e vendosë veshin atje dhe e ndëgjon, e ndëgjon bisedën. Nga ana tjetër e kem pasë edhe disa trokitje, jo vetëm n'muri po edhe në kta radiatorët. Në radiatorët kur trokisje mund të dëgjohesh në katin tjetër. Trokitjen e bënim për të njoftuar dikë që ktu është ni i burgosur politik i Kosovës, po ma shumë jo. Vetëm se ai e dike që n'këtë dhomë qenka dikush se po na troket, ka domethënë.

Anita Susuri: Trokitja m'duket ka qenë si ni melodi?

Mehmet Hajrizi: Ka qenë. Ka qenë gati ngjajshëm sikur ajo e alfabetit të muzeut. Trokisje fjalët që flisnim. Për shembull, 'Republikë! Kushtetutë! Ja me hatër ja me luftë'. E tash trokitjen ti e bon, 'Republikë!' tri trokitje, 'Kushtetutë!' e tjera trokitjet i bën sipas saj dhe ajo e kuptonte pastaj që je dikush nga organizata po jo cili saktë pa folur. Tjetra që ishte me rrezik t'lartë mund të dilje në dritare dhe dritarja shikonte nga shëtitorja.

Shëtitorja është e vogël jo shumë e madhe se osht' ndarë në dy pjesë. Mund t'ketë ndoshta krejt nja dy-tre ari vend ku shëtitet në ni gjysmë rrethi. Lart ni karakoll rrin polici atje gardiani dhe vështrojnë krejt poshtë secilin si po sillet. Nuk mund të komunikosh, nuk mund të lesh diçka, nuk mund të marrësh diçka. Se mund ta lë dikush ni letër dhe ti të përkulësh ta marrësh atë letër. Jo ato shikoheshin shumë mirë, kjo s'mund të ndodhte.

Një hajn niherë m'ka thënë në Prishtinë tha, "Unë e kom marrë, e kom marrë vendimin për hajnitë që kemi ba, sa i kem?" Ai për shembull i ka kry 50 hajni para se me ardhë n'burg. Po ata i kanë identifikua ta zam dhetë. Tha, "Na e dishim që duhet t'pranojmë ndonjë prej tyne. Po sa ma shumë të pranosh ma shumë dënohesh", tha, "dhe kur e mora unë letrën, veç e kom rrumbullakësu", kush e di me çka se laps

nuk ka pasë. E ka rrumbullaku ose e ka ba diqysh e ka ngjyrosë pikat të cilat nuk i ka pranë, i ka lanë vetëm ato që i ka pranë. Kur del shikon atje jo s'po sheh kërkush në ni qoshe e gjun letrën.

Kur del tash ai hajni tjetër që kanë punu bashkë e din letra ku osht' sepse edhe ka folë ky me të. "Unë", tha, "e dija që m'ka dallu ai veprat që i kom pranë unë. Unë tash kur dola me marrë, t'u ecë", tha, "sikur mora n'thu edhe u rrzova, u rrzova për toke. U çova u shkunda dhe po m'dhem kama, po eci ku ta di unë po", tha, "e mora e shpëtova". Domethënë edhe hajnat i kanë mjetet e veta të komunikimit. Pse vet jeta e burgut t'i mëson këto. Nevoja domethënë i mëson njerëzit. Mbase edhe krejt studimet që janë bërë në historinë e njerëzimit janë nga nevoja. Ka pasë një nevojë që t'bëhet ajo dhe janë arritur.

Në dritare dilnim, dilnim dhe me kujdes flitshim por atje e para punës të shihte dhe të dëgjonte gardiani që po ruante atje. E dyta mund të kishte mjete përgjimi brenda në dhomën ku po flisje dhe kapeshin ato. E treta, vet t'burgosurit ishin të pa parashikueshëm. Nuk dije ti a kanë pru naj spiun n'dhomën tane edhe shtihet sikur t'jetë i burgosur ose edhe i burgosur n'fakt po që i kanë thanë, 'Nëqoftëse na bën shërbime ti t'vish t'na tregosh gjithçka që thotë Mehmeti aty edhe çka bon ai aty do ta letojme dënimin tënd, ti do t'dalësh nga burgu ma lehtë'.

Mund t'kenë gjetur edhe kanë gjetë njerëz të tillë bashkëpunues domethënë që i kanë dëmtu njerëzit n'dhomë, të burgosurit politik sidomos. Ishin kto tri rreziqe që mund të përgjonin edhe të dëmtonin. Ka pasë, ka pasë kso forma komunikimi. Në Prizren ta zam kanë qenë të mbjellura në shëtitore... Prizreni e ka pasë burgun ma t'ri edhe ma t'mirë se Prishtina. Kanë pasur edhe trëndafila t'mbjellura aty. Kshtuqë ndonjëherë mund edhe të merrnim ndonjë gjethe, ku ta di unë, dhe ta zëm librin që e kthen n'shpi e shtin ni gjethe trëndafili dhe e gjen e dashura dhe e sheh që po i bën ni përsëritje me ni lule brenda, brenda librit. Që edhe po ta gjenin nuk e merrnin aq seriozisht punën e ni gjethe në libër.

Atje te trëndafilat mund ndonjëherë kur shihnim që nuk osht' i kujdesshëm shumë ai gardiani, vendosnim në dhe ni letër që ta gjente ai kur t'vijë ose kur shkon, për shembull, n'banjo len dikund ni letër e mshef pak ma lehtë në tualet e tjerë e tjerë. Në format ndër ma të ndryshmet. Në Prizren gjithashtu duhej komunikimi me atë rrjetën dhe kishte një, një metal që mos t'mund të afrohet familjari afër rrjetës, afër teje që t'jep diçka prej asaj vrimës a ku ta di unë. Edhe ti e kishe ni hekur tjetër.

Unë kam shkruar edhe në parathënjen e këtij librit 'Korrespondencë në cenzurë'. Unë e kom pa aty fmijën tim që kishin rënë dhëmbët e qumështit dhe kishin mbetë vetëm kta dhëmbët e syrit. Derisa po qëndronte atje po flisja unë me familjarët, andej i pasha fmijën se si po kapte me gojë, me dhëmbët e saj atë hekurin që e kish larg dhe që e kish kap për dore e kapke. E shihja domethënë atë rezistencën e një fmije pengesën që ju ka vënë për t'mos e përqaftuar babain e vet, për t'mos i shkruar në prehër, për t'mos e gëzuar prindin që e ke afër.

Kurrë nuk e harroj atë pamje. Derisa po bisedoja me kta unë e shikoja atë si po kafshonte metalin, metalin që e kishte prekë me dorë. Edhe ky ishte komunikim. Po ipte ni mesazh ajo. Unë po e kuptoja shumë mirë mesazhin e saj. Ajo s'ipte mesazh, ajo bënte ni veprim fëmijëror por ishte mesazh për mua. Regjimi i burgjeve jugosllave duke filluar nga Prishtina dhe tutje gjithkund ka qenë i rëndë, ka qenë i vështirë. Ka pasë megjithatë dallime nga burgu n'burg. Disa burgje kanë pasë regjim ma liberal, pak më tolerant e disa tjera kanë qenë shumë të rënda.

Burgu i Novi Sadit ka qenë shumë i rëndë. Për shembull në Sombor kanë thënë që ka qenë pak më ndryshe. Ka qenë ma mirë. Kanë pasë disa leje, disa, ndryshe ka qenë. Kurse ktu në Novi Sad s'ke mujtë as të imaxhinosh atë se jo të kesh ndonjë të drejte kush e di çfare, jo.

Pjesa e Dhjetë

Anita Susuri: Para se me ju transferu nëpër burgje, a keni pasë ndonjë njoftim apo veç kanë ardhë ju kanë marrë se ka ndodhë transferimi?

Mehmet Hajrizi: Nuk ka pasë kurfar' njoftimi, jo, nuk bëjnë njoftime të tilla. Për më keq nuk e njoftojnë as familjen. Kanë shku njerëzit në Prizren pastaj me na vizitu neve ose kanë shku te gjykatësi hetues, te gjyqi duhej të shkoje t'merrje ni leje për vizitë e tjerë e tjerë. Nuk janë, nuk janë njoftu deri vonë ku janë, ku i kemi dërguar, ku kanë shkuar ata njerëz. Një mëngjes herët, ora para 05:00 duhet t'kenë qenë, na hapën derën, ndezën dritën edhe thotë, "Mehmet Hajrizi pregaditi gjërat tua, bëj gati dhe vijmë pas pesë minutave dil përjashta". Ne e kuptonim që po ndodhë transferimi.

Mbetën ata brenda, tjerët, u përshëndetëm. Pashë njëni prej tyne që kisha pasë pak ma shumë biseda edhe intelektuale, iu mbushën sytë me lot. Erdhën, dola. Shkuam poshtë në katin përdhesë të burgut dhe aty po vinin me radhë edhe të tjerë. U bëm dikund nja 15 po. Shumica dërmuese të organizatës sonë që kishim qenë në Prizren. Na ngarkuan pastaj ashtu t'lidhur në ksi far' kombi bus edhe u nisëm. Tash nuk dinim as ku po shkojmë, as ku përfundojmë. Po shihja që edhe gardianët e përjetonin rëndë këtë derisa shkonim rrugës.

Kurse aty brenda na prun nga pak supë ta pijmë para se të niseshim. Nji gardian ka qenë i Vërmicës të Prizrenit. Ai kur u nisëm me dalë m'pëshëndeti dhe e pashë që qajti, ai gardiani. Kurrë nuk e harroj atë pamje. Nuk kam mund ta shoh më atë njeri. Ni tjetër gardian, jo gardian po polic ky ishte se mbanin edhe polic aty në Burgun e Prizrenit. Ni polic i Dukagjinit dikund ishte, nji ditë derisa po dilnim në shëtitje koridoret edhe shkallëve poshtë dilnim në shëtitje. Ai shikon për dritare ne çka po ndodhi. Ky polici, unë isha m'duket i fundit nga po dilnim në shëtitje, dhoma jonë. Ishim na nja shtatë-tetë njerëz të burgosur.

Polici m'pa mu tha, "Mehmet", tha, "hajde pak mrena". S'po di. M'kish lanë përshtypje t'mira ai. Hyna brenda. "Ulu", tha, u ula. Ajo ishte dhoma ku rrinin gardianët dhe policët. "Si po kalon?" Thash, "Po, kshtu kushtet e burgut t'mira". Ushqimi ishte ma i mirë pak se në Prishtinë. Tha, "Të thirra t'vish ktu në qoftë çfarëdo nevojë që ke që mund ta kryj punë", tha, "mos ngurro unë e kryj porosinë". Kjo ishte hera e parë që po bisedonim bashkë. Kisha unë nevojë sa t'dush, kso nevoja. Po kisha edhe dyshimin, a osht' me t'vërtetë... ai m'linte përshtypje t'mirë ai njeri mirëpo megjithatë sikur ai zogu n'degë atje ti çon dorën me përshëndet dikond ai fluturon.

Nuk, nuk pata guxim. Thashë, "Faleminderit shumë. Megjithatë", thashë, "shumë faleminderit", thashë, "unë nuk du t'rrezikoj as ty as vetën, nuk mund ta bëj". Një herë kom dashtë të ikë nga Burgu i Prizrenit edhe aty se di a frikacak a çka ishte puna po nuk, nuk ika. Kisha problem me stomakun, jo pak po gjatë. Ni doktoreshë ishte serbe aty. Thoshte, "Sigurisht po han djath të bijnë prej shpije djath prandaj". Nuk kishte qenë aty halli po kishte qenë i glutenit. Unë kisha qenë intolerant në gluten, nuk e kom ditë domethanë. Kjo më nxirrte probleme. Tash për shembull nuk ha unë as bukë gruri, as kurgjo që ka drithëra t'bardha që i themi ne.

Nji dite më dërgun, më dërgun në Spital të Prizrenit. Nuk dijsa ku është spitali, ishte mjegull atë dite. Shkum dy gardian më çuan. Kur shkym aty hym te mjeku. Ai tha, "Duhet të bëjmë një analizë, shko deri në tualet që t'kem mostra". Shkoj unë hy brenda aty e msheli derën. Gardianët jashtë n'koridor. Shikoj ni dritare, kati i dytë ishte. Shikoj ni dritare e vogël po m'zinte mu me dalë. M'i shti kamtë ma së pari tani m'u kthy disi në bark dhe m'u lshu poshtë. Po nuk disha ku bi poshtë, nuk e disha edhe sa është lart, a ka edhe podrum ajo ndërtesë. Sa osht' e lartë. Nuk kisha diçka që mund ta marr. Unë mund t'përdorja për shembull ni rrobë deri diku m'u lshu me të po jo ma shumë. Nuk kisha ni çarshaf ta zamë që të lshohem deri poshtë.

Megjithatë ma merrte menja po unë mund t'kërcej ktu dhe lshohem te poshtë, ku t'bi le t'bi. Nuk e dija rrugën. Si të iku tash përpjetë do duhej... se n'qytet isha brenda. Duhej nëpër qytet. Kisha rrezik dikush do t'më kap se s'din a osht' ndaj kriminel a, thotë do ta kapi se... e u vonona bukur shumë (qeshë) unë aty duke menduar që të iku. Mbeta, mbeta. Nuk munda të vendosë. Se kisha frikë lartësisë nji edhe e dyta nuk ma merrte menja që unë mund të orientohej, sidomos në mjegull, drejt kufirit ose t'kisha dikënd të njohur aty që t'i shkoj në shtëpi e ai pastaj le t'më strehon dikund derisa t'krijohen kushtet, t'më ndihmoj dikush deri të kalohet kufiri.

Për shembull, deri në Vërmicë dikush po t'më dërgonte tani aty kufiri ka qenë afër dhe mund t'kaloj andej. Mbeta se po isha i interesuar, isha i interesuar që t'dalë. Jo aq shumë që t'i shpëtoj burgut se ajo pjesa e vështirë e burgut kishte kaluar. Gjashtë muaj hetime n'burg janë ma shumë se 16 vjet burg m'i mbajtë. Me gjithë qef kisha pranuar 16 vjet t'i mbaj burg po t'mos i kem gjashtë muaj hetime domethanë. Se janë shumë t'randa, t'randa edhe rrezik edhe për jetën.

Osht' hetuesia osht' faza ma e vështirë e burgut. Nuk kisha hallin aq shumë për veti por mendoja që po t'dal unë përpara i ripërtërij krejt radhët. Se edhe po mos t'dilja në Shqipëri s'më prishte punë mu. Unë mund t'qëndroja fshehur edhe në Kosovë që mos t'mund t'më gjenin. Kisha njerëz që do t'mund t'më strehonin dhe bëheshin baza të tilla që ti mund t'qëndrosh me vite të tëra dhe të veprosh. Pastaj edhe të kamuflohesh dhe ta ndrrosh krejtësisht pamjen e tjera e tjera. Shkurt nuk u krye ajo. Nuk u krye ajo iniciativë e mirë e dëshirueshme. Tjetër herë ma nuk kom pasë unë rast ku mund të shmangesha të ikja nga burgu.

Në Novi Sad nuk kishe gjithashtu mundësi. Ne kur dolëm t'punonim jashtë te betoni aty ishim t'vëzhguar. Nuk mund të shmangeshe. Sepse po të kishe mundësi, unë prisja mos po m'vjen ndonjë rast që të shmangem dhe të vendosim dikund nja tri-katër ditë a pesë ditë a një javë dhe t'mos lëvizë derisa ata t'i kryjnë vrapimet për t'gjetur. Kur ata thonë që kaloj kjo kohë, shkoj, s'kem çka bojmë. Atëherë unë të nisesha dhe llogaritja që edhe mund t'më zënë dikund ndonjë serb e ndonjë... gjuhën serbishte e dija mirë që nga fëmijëria dhe e flisja me theks mirë. Nuk isha nga ata shqiptarët që i thonë *lopata* (qeshë).

E kisha mësu bile nëqoftëse m'pyesin cila është festa jote fetare? Se i kanë shenjtët ata secili. Unë e kisha marrë ni temën, ni Svete timin. Që kur t'më pyetin cilin, se për me m'provoku unë i tregoja po e kom shenjtin që e festojmë n'familje e tjera e tjerë. Që t'mos, t'mos identifikohesha që jam shqiptarë në asni mënyrë edhe nëqoftëse duhej t'jem dikund në familje serbe. Nuk erdh ky rast, nuk erdh ky rast kurrë që t'mund të ikje. Se do t'ikja. Qoftë edhe ni vit para mbarimit të burgut unë do t'ikja nga burgu po t'më ipet mundësia.

Burgu i Novi Sadit çuditem kur kanë provu, ata djemtë që përmenda ma përpara, që t'dalin prej aty sepse ka qenë n'gropë. Aty ku shëtisnim ne ka qenë ni muri i lartë i betonit njëherë dikund nja tre-katër metra. Deri aty ishte rruga, kishte nivelin jashtë atje. Plus tani shkojnë edhe nja tri metra tjetër muri që duhej ti pesë-gjashtë metra t'ngjitesh përpjetë niherë e të rash pastaj n'rrugë nja tri metra poshtë. Ishte, ishte e vështirë kjo. Edhe po t'mund të dilje se lëre më që vëzhgohej ajo tërë kohën 24 orë. Ka qenë burg i sigurisë së lartë ai i Novi Sadit. Nuk m'u dha ky rast asniherë. Kshtuqë përfundimisht hoqa dorë nga kjo ide, nuk u bë puna.

Anita Susuri: Po kta që i përmendet që kanë planifiku ikjen në Burgun e Novi Sadit nëse mundeni me tregu se ishim duke bisedu kshtu privatisht e nuk kuptohet tash kush kanë qenë kta?

Mehmet Hajrizi: A, ishte, m'duket ka qenë ni Agim Leci. Ne e kem pasë ni Vehbi Leci, pastaj n'dhomë kur dolëm me punu. Ni burrë shumë i mirë dhe i vendosur, ata tjetër nuk i njihja. Ky ishte ai grupi që kishin dalë n'hyrje të Prishtinës kur kanë ardhë forcat serbe, kta e kanë ndaluar një kamion.

Anita Susuri: Gjatë demonstratave a po?

Mehmet Hajrizi: Gjatë demonstratave. E kanë ndaluar një kamion. E kanë zbrit poshtë shoferin, kanë kontrollu kamionin dhe kanë pa që kamioni ka qenë i mbushur plot armë. Sa kanë qenë ky grupi prej nja tetë a dhjetë vetëve kanë rrëmby armë, disa armë. Automatik. Edhe kanë ikë malit. Pastaj i kanë zanë ata dhe i kanë, se di a i kanë marrë krejt armët, po i kanë zënë atë grup dhe i kanë dënuar rëndë nga dhjetë 15 vjet. E njëri prej tyre kemi qenë bashkë me Vehbi Lecin, ni djalë i shkëlqyeshëm domethanë.

E ni bashkëveprimtar i tij me ato armët që kanë marrë atëherë, ka provu të ikë nga burgu po se di a me dikond tjetër a vet. Po e di kur erdh ai komandanti po na thotë, i burgut, që kshtu ka ndodhë. Ai na tregonte këtë për t'na dhënë mesazh që çka ndodhë me ju nëqoftëse provoni sikur ai. Që i kem thy kërbaç, që ka me pagu damin që ka bo ktu e tjerë e tjerë. Ishin ato krejt ironi e cinizëm. Na i tha ashtu.

Anita Susuri: Ju e keni mbajtur po m'duket nantë vite apo tetë vite prej burgut që ju është dhanë, po mendoj në fillim 12 ka qenë...

Mehmet Hajrizi: 12 aty afër nantë vjet kam qenë.

Anita Susuri: A ka ndiku Amnesty International a pse ju kanë...

Mehmet Hajrizi: Jo s'ka, s'besoj që ka ndiku dikush nga jashtë. Po atëherë për të treguar që ne e lam komunizmin mrapa dhe po hyjmë në ni epokë të demokracisë edhe në Serbi vendosën që t'i lirojnë të burgosurit politik. Se nuk mund të mbaje të burgosur politik për veprimtari politike n'burg ma me ni rend të demokracisë. Prandaj i lirun t'gjithë n'vitin '90 dhe '91.

Anita Susuri: Ju qysh e keni kuptu që po liroheni ma shpejt ose po vjen koha me dalë?

Mehmet Hajrizi: Nuk kom ditë unë veç kur m'kanë thanë, "Merri kto plaçkat e tua dhe dil jashtë". Nuk e kam ditë. Krejt çka m'është lejuar jam përshëndet me ata që mbetën aty. Edhe ata pastaj janë liruar po ma vonë. Nuk e kom ditë. Ka qenë befasi. Kur dal shoh edhe ni tjetër ni Nusret Ahmeti, tash m'duket punon me ni hotel dikund mos t'pastë dalë n'penzion. Ne kemi dalë bashkë, bashkë.

Ne kishim disa t'holla që kishim punuar po ato t'holla i kishte, i kishte bërë gati zero inflacioni. Dolëm ne me to dhe nuk dinim ne t'hollat as si duken as sa janë, as çka janë. Kur kishim nevojë t'pagujmë diçka biletën për shembull, na i nxirrnim krejt ato të holla merrni sa duhet. Se nuk kisha asnjë ide për vlerën e parasë sa ka vlerë as nuk dinim se sa kemi. I shihnim shifrat aty po nuk e dinim si osht', si osht' situata jashtë.

Kemi hyp n'tren, kemi ardhë në Fushë Kosovë të nesërmen n'mëngjes. Rruga osht' e gjatë kah Novi Sadi deri në Beograd udhëtohej me autobus tani në Beograd atje e merr ni tren n'mramje. Në mëngjes t'sjellë ktu. Mora ni taksi, s'kisha as si të njoftoj në shtëpi. Telefona s'kishte, s'kanë pasë n'shpi n'telefon

as unë s'kisha prej ku thras. Po erdha ktu n'mëngjes, vi te shpija, kqyri s'osht' kërkush. Shkova, ktu i kom vllëzërit afër. Shkova te ata. Prindërit kishin vdekur para një viti. Kishte shku Haxherja bashkë me fmitë te motra e vet domethanë, s'e kanë ditë që vij unë.

Erdhën dikur. Tani kanë tregu dikush që ktu osht' Mehmeti. Unë isha te vllau ma poshtë atje. Tek po ngjitem përpjetë erdhën kta. Kur m'kanë pa fmitë kanë ardhë m'u kanë gjujt në qafë. Filloj pastaj ajo ardhja e njerëzve plot e për plot vizita...

Anita Susuri: Çfarë date ka qenë kur jeni liru?

Mehmet Hajrizi: Dikund n'fund t'prillit ka qenë.

Anita Susuri: '90-të a '91-ten?

Mehmet Hajrizi: '90-të. Mandej duhet, duhet t'ketë qenë data 22 a 23, nuk e di saktë. E di që kanë ardhë shumë njerëz e tash ishte nifar' lirie për t'shkuar me pa, përpara jo. Kom qenë për shembull në '79-ten po s'ka ardhë kush me m'pa se do t'dilte problem. E humbnin vendin e punës njerëzit. S'ia shihja për t'madhe pse e bënin këtë. Mbaroj. Mbaroj burgu.

Anita Susuri: Qysh u ndjet ju krejt? Ma s'pari kur e keni kuptu që po dilni prej burgut që e keni lirinë? Çfarë ndjenje është ajo?

Mehmet Hajrizi: Ke ni keqardhje t'randë për ata që metën n'burg. Unë nuk kom qajtë po shumë, shumë nga ata bashkëveprimtarët e mi që kanë dalë para meje e m'kanë lanë n'burg kanë dalë me lot n'sy, kanë qajtë. Është e randë. Bile bile po ta pyesësh, "A po don t'dalësh?" Thotë, "Jo s'du t'dal". Aq randë t'vjen t'ia kthesh shpinën shokve që i ke aty, që ke kalu ni kohë t'gjatë me të, ke nda vujtjet me të bashkë. Nuk osht' e lehtë dhe nuk ndjen nifar' gëzimi, se di. Je si i humbur, nuk, si i mpitë. Se sheh, se sheh jetën reale, s'je n'gjendje të zbreshës me këmbë n'tokë.

Del pastaj edhe kur del duket e çuditshme, nuk disha të ecë unë rrugëve. Ishte, ishte e pazakonshme jeta tash. Ishin bërë megjithatë ato vite e kishin bërë t'vetën. Në Novi Sad për herë t'parë dhe pastaj na nxorrën prej atij burgu na çun me ni burg të ri që e ndërtun atje. Klicë quhet ajo paralagje e Novi Sadit. Na nxorrën prej atij burgut të kohës së Terezës. Aty kishte edhe fshatar. Aty kom dëgju për herë t'parë ni gjel tek po këndonte. M'dukej e çuditshme. Kom dëgju ni fëmijë tek qante, i vogël. Jom gëzu që dëgjova ni zë fmiye niherë. Nuk kisha dëgju të sjellë në nifar' gjendje të pashpjegueshme burgu.

Ndoshta nuk është kohë kushedi sa e gjatë n'vite për ni mërgimtar për shembull por nuk krahasohet me mërgimtar sepse ai osht' ne jetën e hapur kurse të jesh mbyllur dhjetë vjet e tetë vjet e nantë vjet, janë shumë. Lënë gjurmë në jetën e brendshme të njeriut derisa të ambientohet kur të kthehet pastaj në atë jetën reale. Ndryshe është jeta. Njerëzit i sheh, ndjen nifar' knaqësie kur të tjerët shef që e

vlerësojnë atë veprimtari që kemi bërë. Ty nuk të dihet a do të vlerësohet ndonjëherë dhe çka do t'thonë njerëzit. Mos mund të thonë, "Po çka hyni na nxori telashe tash shkun e bon kto veprime tash po na marrin edhe ne të pafajshmëve në burg" e tjerë.

Jo, shihja krejt një, një gjendje tjetër. Megjithëse ne kishim pasë përvojë të arrestimeve ma përpara e kishim parë se si nderohen dhe se si respektohen të burgosurit politik. Unë kam shkuar me vllaun tim kur ka dalë nga burgu mysafir aty e këtu, ishim n'vende ku kish ma shumë njerëz e tjera. Po ai shikohej jo si njeri që ka ardhë nëpër tokë, po ka zbritë nga qielli domethanë. E konsideronin disi si njeri të arrirë. Pse? Kishte qenë në burg, ishte marrë me veprimtari. Kshtuqë pak a shumë edhe ne e dinim se si do të pritemi. Po megjithatë kjo ndikonte në shpirtin e t'burgosurit politik si ni satisfaksion, si ni plotësim i asaj zbrazëtie shpirtërore atje që kishe. Njerëzit po vlerësonin punën, veprimtarinë, sakrificën që kishe bërë për ta.

Anita Susuri: Zoti Mehmet vitet e '90-ta kur keni dalë prej burgut ka ardhë nifar' fryme e re n'politikë. Ka fillu edhe paraprakisht ka qenë edhe Greva e Minatorëve në '89-ten. Pastaj osht' marrë autonomia e Kosovës. Nga ana tjetër '90-tat kanë fillu Pajtimet e Gjaqeve. Si e keni gjetë ju vetën në krejt kta? Qysh ka vazhdu aktiviteti ju?

Mehmet Hajrizi: Të gjitha këto kanë qenë kur unë isha n'burg. Edhe Greva e Minatorëve edhe suprimimi i autonomisë. Kurse ky aksioni, fushata për Pajtimin e Gjaqeve ishte në përfundim kur erdha unë. Nuk, nuk kom marrë pjesë n'to. Nja dy raste kom marrë tani ma vonë bile. Po jo në atë fushatën që ishte me Anton Çetën. Po me t'u kthyer nga burgu unë shihja ni situatë megjithatë më ndryshe, nuk ishte ajo.

E para e punës njerëzit ishin më të lirë që t'vinin dhe të vizitonin siç e përmenda më përpara. E dyta mund të flisnin më lirë sepse nuk ishte mo ai dënimi për, për delikt verbal nëqoftëse do t'flisje diçka. Ishte nifar' lirie e fjalës. Kjo ishte krejt rezultat i një procesi transformues që po ndodhte në gjithë kampin socialist e po ndodhte mandej edhe në Jugosllavi. Po gjeta një situatë të një inflacioni shumë t'lartë kur ishte zhvlerësuar paraja dhe kjo sillte me vete një krizë ekonomike të njerëzve. Fuqia blerëse kishte rëndë.

Po megjithatë njerëzit e organizuar, kush kishte makina mblidheshin ato dhe vazhdonin rreth e rrotull Kosovës për t'i vizitur të burgosurit që dilshin atëherë nga burgu me shumicë. Për shkak të lirimit që bëheshin t'burgosurve që t'mos kishte t'burgosur politik më nëpër burgje sepse kjo e rëndonte vet pozitën e Jugosllavisë në plan ndërkombëtar. Shumë të burgosur politik u lirun, disa mbetën për t'u liruar më vonë, ta zam n'vitin '91. Po sidoqoftë u lirun shumë t'burgosur sepse vet situata dhe vet zhvillimet historike që po ndodhnin në rajon e detyronin këtë zhvillim të lirimit të burgosurve. Kishte tash dilema që çfarë të bëhet, si të organizohemi.

Në përfundim vepronte LPK-ja por e ndarë në dysh. Një quhej me adresë tjetra pa adresë. Unë nuk mund të preferoj njëren e t'ij ktheja shpinën tjetrës. Ishte e pamundur sepse kisha respekt për të dy krahët domethanë, pavarësisht arsyt përse ishin ndarë ata. Shihja megjithatë t'njejt veprimtarë, njërin edhe tjetren. Kshtuqë një far' kohe jo fort t'gjatë mbeta të shikoj niherë si osht' gjendja, çfarë mund të bëj, ndonjë intervistë kush vinte të kërkonte prej meje, ndonjë prononcim. Aty kty më thirrnin në ndonjë manifestim që po organizonin.

Po dikund nga fundi i vitit '90-të u organizu kuvendi i parë i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Aty dikush m'kishte propozuar për këshillin qendror, ni organ i Lidhjes Demokratike. I kishin dhënë votat njerëzit, unë s'kam qenë n'sallë. S'e kom konsideru vetën as anëtar të asaj lëvizje dhe m'kishin zgjedhë në atë këshillin qendror. Nuk, nuk kundërshtova, shkova aty. Shkova. Pastaj u zgjedha edhe në kryesi të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe dobia që kisha une kryesore nga anëtarësimi aty ishte, e para pse shqiptarët e Kosovës ishin himogjenizuar rreth një ideje të kundërshtimit të sundimit serb.

Aty, aty ishte popullësia e mbellur. M'dukej sikur kisha ni nevojë unë shpirtërore që t'jem pranë atyre njerëzve dhe t'ju flas e t'komunikoj me ta ashtu siç unë e kisha konceptet e mija për t'komunikuar me qytetarët. Kam shfrytëzuar gjatë asaj kohe gjitha mundësitë që t'jem kryesisht në teren. Nuk kom qenë unë veprimtar i zyrës po i terenit. Kam dalë në teren dhe kam shkuar në katër anët e Kosovës dhe kam biseduar me qytetarë diku 300 diku 400 diku ma shumë qytetar, diku ma pak. Po kam biseduar me ta gjithë çfarë unë kam menduar.

Lidhja Demokratike e Kosovës atëherë nuk më kufizonte diskursin tim dhe çështjet që unë t'i bisedoj me njerëzit. I bisedoja ato që i mendoja unë, s'kisha marrë prej kërkujt kurfar detyre që t'bisedosh vetëm për atë ose për atë ose për atë. Jo. Kam shfrytëzuar atë kohë dhe e konsideroj një periudhë të kontributit tim t'hapur me qytetarët kudo, dhe janë shumë t'shumbtë janë ata. Për t'i sqaruar, për të ndikuar te ta, për t'i inkurajuar që pavarësisht konsekuencave që mund t'kenë të rezistojnë kundër ktij regjimi, të mos e njohin si regjim t'vetin dhe t'jenë kundër tij. Kundër tij me sa kanë fuqi.

E kujtoj edhe sot atë periudhë të atij veprimi që për mua ka qenë kontribut dhe ka qenë rezultativ. Domethanë nuk ka qenë kohë e humbur. Ndërkohë po bëj edhe veprimtari të tjera. Njerëzit atëherë nuk kishin, nuk kishin me çfarë ushqeheshin sepse regjimi serb i përjashtoi nga puna njerëzit. Nuk kishin mjete jetese. E përjashtuan edhe gruan time. Pse doli në ni grevë ni ditëshe që e kishte kërkuar sindikata e bashkuar atëherë.

Ishte formu nga LDK ni komision i solidaritetit kshtu e qujshin që të kordinohen ato ndihmat që do t'ju jipeshin njerëzve. Kushto që binte aty ndonjë ndihmë dhe e linte pastaj kordinohej shpërndarja e tyne. Mu më ftuan që t'jem kryetar i atij komisioni dhe u bëra. Punova dikund nja dy vjet nashta, jo ma shumë. Sepse shumë shpejt u dashtë tash të formohet ni institucion financiar që do t'financonte veprimtaritë shoqërore në Kosovë. Arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, akademinë e shkencave e tjerë dhe për këtë duheshin shumë para që t'jipshe ni rrogë sado t'vogël.

Ne disa veprimtar mendum që të formojmë një kshill. Kshill nuk e qunin ministri e quanin Këshill të Financimit. Ni Ministri e Financave ishte jashtë në qeverinë në egzil që ishte po ktu e qujtëm Këshilli Qendror për Financimin e Kosovës. U zgjodha kryetar i atij këshilli. Megjithatë regjimi serb e mori si ministri të financave dhe për këtë ni herë kur më burgosën në Prizren thanë, 'Ti je ministër dhe s'mund t'jesh ministër sepse ka Serbia ni ministër të financave, nuk kem nevojë për dy ministra'. Unë ju thojsha, "S'jom kurfar' ministri, jom një njeri që udhëheq dhe organizoj një organizatë që ka degët e veta në çdo rajon të Kosovës, në çdo komunë bile edhe nëpër fshatra".

Zhuri për shembull, Zhuri ka pasë këshillin e vet lokal, të vetin të veçantë. N'fund po tregoj ni detaj, kur më liruan pasi edhe më kishin goditur fizikisht tha, "Merri gjërat e tua që i ke", ishte ora 03:00 e natës. Na arrestuan disa vetëve po ata i kishin liruar dhe ata po më prisnin në qytet qashtu natën. Dola. "Merri", tha, "ku t'i ka marrë policia". Policia m'i kishte marrë mu te ajo rruga te Zhuri ku ndahet për...

Anita Susuri: Për Opojë, për Dragash.

Mehmet Hajrizi: Po, për Dragash. Ne po shkonim për Dragash për ni veprimtari që ishte atje. Atje m'tha, "Nxirri gjithçka që ke prej xhepave". Ne prej Hogoshtit po shkonim në Dragash. Domethonë prej ni skaji ma të largët të Kosovës në ni skaj tjetër. Kishim udhëtuar gjatë. Isha bashkë me një Muharrem Ibrahimini që ishte në Këshillin e Financimit edhe ai. Kryetar i Komisionit të Kontrollit. Ishte një veprimtar i mirë, një burrë i mirë që na ftoj t'shkojmë atje se kishte ni veprimtari. Isha edhe me Gani Sylën që ishte ni bashkëveprimtar i imi i hershëm. Po na ndalën.

Na ndalën në kryq aty ku ndahej rruga me shku për Dragash. Aty kishte qenë ni punkt i policisë. M'tha, "Nxirri nga xhepi krejt çka ke", i nxorra. Tha, "T'hollat ku i ke t'hollat? Nxirri edhe t'hollat", thashë, "Nuk kom t'holla", tha, "Nxirri të hollat se s'ti marrim", thashë, "Po, po s'kom", tha, "Dathi kpuctë". Mendonin që i kom mshefë t'hollat n'kpucë dikund. Nuk gjetën as aty. Kur na dërguan pastaj në qendër në Prizren, e mbaruan punën ata dhe thanën, "Merri senët". Po i marrë unë, çka kisha ni faculetë, ni laps. Gjëra të zakonshme. I panë ato.

Tha, "T'holla a ke pasë?" Thashë, "Jo, t'holla nuk kom pasë", "Aha. Mos janë ngatërru te na dikund", thashë, "Jo, jo nuk kom pasë", "Hiç", tha, "s'ke pasë t'holla a?" Thashë, "S'kom pasë". "Ti si ministar finansija?" edhe ti tha, "Ti domethonë qenke ministër i financave s'ke asnjë lek n'xhep, çfarë ministri?" (qeshë). M'u kujtu, m'u kujtu Luigj Gurakuqi kishte qenë ministër i financave edhe ai n'kohën e vet po kur e vranë ata dorasit e hallakatën nëpër xhepa duke menduar se meqë ka qenë ministër do t'ketë edhe para. Nuk gjetën asni, të themi ne tash cent, nuk gjetën asnjë para n'xhepet e tij që ishte ministër (qeshë). Edhe kta nuk gjetën asni para te unë.

Po kërkonin ku i mbanim paratë. "Ku i keni paratë?" Thashë, "Nuk kem ne para, nuk i mbajmë. I shpërndajmë meniherë aty për aty. I mbledhim i shpërndajmë". Po që është e vërteta ne nuk kishim

bukur shumë. Kishim diku çarkullimin mujor rreth tre milion markë. Kishin filluar me 20 marka rrogë arsimtarët edhe të tjerëve që i financonim. Pastaj u ngrit kjo gradualisht dhe deri në fund të dekadës shkoj 150, 170 euro m'duket ka qenë rroga e fundit që osht' dhanë para, aty në prag të luftës, në luftë.

Pjesa e Njëmbëdhjetë

Mehmet Hajrizi: Këshilli u formua me, sa di unë, me 06 shkurt të vitit 1992. U zgjeru shpejt. Bëm mijëra veprimtar në krejt Kosovën. Bëm edhe dokumentacionin financiar që t'mblidhen paratë për, duke qenë në ni kontrollë t'vazhdueshëm kishim kontrollin shumë t'rreptë edhe ditën kur u formua si këshill i krejt Kosovës tash i financimit kryetarët që ishin zgjedhur nëpër komuna t'ndryshme kanë qenë diku nja rreth 30 këshilla komunal edhe lokal, a ma tepër.

Unë ju drejtova ktyre kryetarëve të këshillave komunal, veprimtar t'mirë t'gjithë. Po unë duhej t'isha pak i rreptë n'fillim t'themelimit. I thashë do fjalë që nashta nuk duhej as m'i thënë. Që, 'Ju keni një përgjegjësi t'madhe të menaxhimit t'parasë të qytetarëve dhe kto para nuk mund të abuzohen qoftë edhe për një markë dhe ta dini që nëqoftëse kjo i ndodhë dikujt unë ndjej një përgjegjësi t'i ndjek keqpërdoruesin sa t'jem gjallë n'ketë jetë dhe një ditë do t'kemi gjyqet tona, do t'i paraqes edhe në gjyq dhe nëqoftëse vdes edhe në botën tjetër ka me ndjekë po pa e qit para gjyqit, sot para gjyqit moral e nesër para gjyqit penal nuk e lë'.

Nuk them që ata nuk bën pastaj abuzime pse unë i kisha thënë këto fjalë. Jo. Pashë shumë shpejt që kishin qenë të tepërta sepse pati aq rregull në atë organizim, pati aq pak humbje të parasë sepse mund të ndodhte që ua konfiskonin, u hynin brenda n'zyre kshillave dhe u merrnin paratë që gjenin aty. Pak kto kanë ndodhur, shumë pak raste, pak. Shkoj puna aq mirë e aq pastër... për rreth tri vjet rresht kom qenë n'krye të atij këshilli pastaj e kom lshu sepse isha tepër i angazhuar në kryesinë e LDK-së edhe për çështje të informimit pos tjerash edhe të terenit që përmenda.

Terenin tash duhej të dilje n'teren përsëri edhe nga pikëpamja e këshillit për t'i formuar këshillat komunal, për të asistuar zgjedhjen e kryetarëve të organeve të tjera të tyne e tjerë e tjerë. Kam dalë shumë n'teren edhe për këshillat e financimit. Bashkë me, sidomos me Ismail Kastratin që ka qenë ni ekonomist i shkëlqyer, vdiq para disa kohe. Bajram Shatri gjithashtu që ishte, ishte sekretar dhe që mbante proces verbalin. Kishim edhe një tjetër që, kishim anëtarë të këshillit qendror, jo pak po ishin nantë vet. Të gjithë veprimtarë t'mirë, të gjithë të përkushtuar, të gjithë të sakrificës. Sepse dihej që sakrifikoheshë aty.

Të paktë kanë mbetë njerëzit që nuk janë ndëshkuar nga policia, të paktë janë njerëzit që nuk janë arrestuar nga policia, të paktë janë njerëzit që nuk janë torturuar rëndë për këtë veprimtari nëpër kshilla. Kurse një prej tyre në aksion duke mbledhur kontributet e qytetarëve është vrarë nga policia.

Domethanë është bërë dëshmori i parë i Këshillit të Financimit. Shumë nga veprimtarë të Këshillit të Financimit kanë rënë n'luftë dhe janë shpallë dëshmor e heronjë e tjerë e tjerë.

Ishin njerëz të zgjedhur, njerëz të veprimit edhe njerëz të sakrificës dhe unë sa t'jem gjallë do t'jem mirënjohës për ata veprimtar të Këshillave të Financimit që vepruan. Vepruan me aq sakrificë dhe me atë privacion edhe familjar. Dikur vonë kemi filluar t'ju jepim veprimtarëve të Këshillave të Financimit edhe atyre nga 20 euro. Unë kam qenë kryetar te këshilli po nuk kam marrë asnjë finig nga këshilli. Sepse m'dukej që mu m'kishte hije t'jem ashtu. Ndërkohë që n'familje i kishim puntë pus ekonomikisht.

Shkoj mirë e mbarë. Pastaj e vazhdoj Ismail Kastrati udhëheqjen i cili edhe u arrestu dhe mbajti dy vjet e gjysë burg edhe për themelimin e Odës Ekonomike të Kosovës. “Po kur shkova”, tha, “n'burg atje, nuk m'pytshin për Odën Ekonomike po për kontributet që janë mbledhë”. Ne ktu mrena arritëm t'i mbledhim dikund mbi 60% të gjithë kontributeve që kishim prej tre milionëve n'vit. 40% i kemi marrë kontribute nga qeveria që na dërgonte nga jashtë.

Mund t'imagjinoni sa vështirë ishte edhe ato para të barten e t'sillen ktu në ni kontrollë të rreptë të policisë dhe edhe kto paratë ktu që mblidheshin këshilli qendror ktu pastaj duhej t'ia jepte kshillave lokal paratë t'i bartnin. Shumë veprimtar nuk kanë guxuar të hypin as në autobus, as në makinë po kanë shkuar maleve këmbë që t'i dërgojnë paratë në destinacion atje ku duhet dhe t'i shpërndaj me ngut sepse ndërhynte policia nëpër lokalet e tyre.

Veprimtaria e këshillit ishte gjysmë e hapur gjysmë e fshehtë. Përpiqeshim msheftë të mbahen. Para për shembull nuk mund t'gjenin ku hynin ata. Merrnin dokumentacionin po para nuk mbanim, shumë rrallë na kanë qenë rastet kur kanë gjetë diçka dhe kanë konfiskuar para. Janë shpërnda paratë me vështirësi. Njerëzit edhe në autobus kur kanë qenë i kanë fshehur ato para aty ku nuk janë bastis, nuk janë... megjithatë osht' kryer veprimtaria e këshillit në ni mënyrë, në ato kushte sado t'ishte e mundur t'rregullt për t'i shpërndarë ato para.

Nihere mbaj mend me ni tubim në Skenderaj, në Klinë, ishin mbledhë plot arsimtar e veprimtarë të tjerë dhe po bisedonim. Njëni prej arsimtarëve e kishte ruajtur pas dy-tri vjetësh a ma tepër, dy-tri vjet sigurisht, e kishte rujtë atë 20 markshin e parë që e kishte marrë si rrogë, nuk e ka harxhu. Aty e nxori para të gjithëve n'xhep t'kmishës, ishte vera po m'duket. E nxori dhe tha, “Shikoni, kto 20 euro kurrë”, tha, “nuk i harxhoj. Kto”, tha, “janë paret e institucioneve t'mija të Kosovës, të Republikës së Kosovës dhe i ruaj, i ruaj kto se i kom kujtimin ma t'mirë”.

Dikur u rrit ajo pagë ma shumë, bile bile ia kalum Serbisë. Serbia i kishte pagat ma t'vogla për arsimtarët sesa i siguronim ne. Sepse jepnin marka dhe marka kishte vlerë t'lartë kurse dinari kishte ra për toke. Kshtuqë shkoj, shkoj, megjithatë nuk ish edhe aq shumë e rëndësishme ndoshta vlera monetare që po ju jipej, ishte e rëndësishme institucioni i parë shtetëror që po organizohej brenda

Kosovës. Nji institucion qeveritar, ni digaster qeveritar. Kjo kishte efektin e madh moral edhe tek njerëzit.

Kshtu shkoj puna me Këshillin Qendror të Financimit. Ke botuar pastaj tre autor, ka autor ni libër që unë ua dhashë juve, që përbënte ni raport publik të këshillit për gjithë punën që kishte bërë. Ne dëshironim që kjo të bëhej si një raportim edhe para gjithë atyre veprimtarëve që kishin dhënë, atyre donatorëve, familjeve që kishin dhënë para. Kishin dhënë një herë bizneset e vogla gjithkush që kishte ni biznes t'vogël kishte të caktune ni shumë që duhej ta jipte po ishte në vullnetin e tyre i jepin apo s'i jepin. I kanë dhënë. Kanë dhënë shpesh herë edhe ma shumë sesa ju kemi kërkuar. Kem pasë rast për shembull që njeriu e ka shit lopën e qumështit për fmitë e vet për t'ia dhënë krejt Këshillit të Financimit.

Kish edhe veprimtar jashtë që mblidhnin edhe ata disa kontribute edhe i dërgonin edhe qeveria, thashë, dërgonte nga jashtë gjithashtu mjete. Jo pak po në mënyrë të konsiderueshme. Arrinim në tre milion marka që atëherë kur isha unë n'krye të atij këshilli. Ma vonë pastaj edhe osht' rritë edhe ma shumë sigurisht dhe janë shpërnda. Vlera, vlera e këshillit ishte ma shumë n'kuptimin institucional të fjalës sesa të parasë që mblidhej dhe ndihmes që ipej. U jipshin arsimtarëve që ishin rreth 20 mijë, nuk ishin pak. Ju jipeshin atyre ambulancave që punonin vullnetarisht pa para. Ju jipeshin akademisë së shkencave...

Kam shkuar unë kam folur me kryetarin e akademisë dhe i kam thënë, "Të tjerët vijnë lypin para tek ne kurse unë kam ardhë t'ju jep para juve pa lyp hiç", Gazmend Zajmi ka qenë kryetar i akademisë atëherë, te ai shkova dhe bisedova me të. Nuk u gzua aq shumë për paratë që do t'merrte akademia. Po ai e çmonte si veprimtari, si një rrezik që kishin marrë përsipër gjithë ata veprimtarë të ipnin dhe u knaq, i erdhi shumë mirë domethanë. Pastaj, takoheshim edhe ma shpesh me të edhe për ndihmën që ju ipnim. Pastaj edhe sportistët kanë marrë ndonjëherë, kultura, manifestime t'ndryshme kanë marrë.

Madje kena pasë edhe ni asistencë sociale për të ndihmuar njerëzit në nevojë që nuk kanë mjete jetese. U bë ni veprimtari me të, një veprimtari e mirë. Kshtu shkun ato vitet, vitet '90-të. Kur po përgaditej edhe formimi i një ushtrie çlirimtare për reistencë të armatosur dhe kishin filluar veprime, aksione të veçanta guerile që atëherë domethanë. Këshilli i Financimit nga fondi ka ndihmuar edhe luftën çlirimtare. Atëherë me Ismail Kastratin kryetar, jo unë, nuk isha atëherë.

Unë po bëja ni veprimtari tash politike masi kisha heq dorë nga kjo, po politike ishte edhe kjo po kishte karakter ekonomik për mbijetesë. Për mbijetesë të institucioneve edhe të qytetarëve e familjeve. Deri, deri kah fundi i dekatës kur filloj lufta, lufta e armatosur. Një grup jo i vogël njerëzish, kryesisht ish veprimtar të organizatave të fshehta klandestine po kërkonin nga LDK-ja që të ishte ma aktive dhe t'bënim ni dinamikë ma t'theksuar të veprimeve tona e para, e dyta që gjithnji duke ruajtur karakterin paqësor të rezistencës edhe e dyta që politikisht ta mbështetnim luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të pa knaqr me këto që i kërkonin e nuk u bën në tërësinë e plotë, nuk them që s'pati, ne hoqëm, dolëm nga Lidhja Demokratike atëherë. Nuk e kisha të lehtë sepse kisha njohur shumë veprimtarë aty, jo vetëm t'burgosur politik po shumë veprimtar të shkëlqyeshëm me të cilët ruaj miqësinë akoma me ta. Që po ua kthenim shpinën disi, dëshiroja t'isha bashkë me ata. Kontributin ma t'madh në formimin e Këshillave të Financimit e kanë dhënë anëtarët e Lidhjes Demokratike, kryesisht kanë qenë të saj. Me ata unë kisha ni miqësi të thellë tash nga veprimtaria e përbashkët që kishim bërë.

Por ne dëshironim që ni subjekt politik ku ishim ne të përkrahte luftën e armatosur dhe formum ni tjetër subjekt fillimisht që Lëvizja Demokratike Shqiptare dhe ne s'kishim asnjëni prej nesh që kishim dalë ambicie për t'qenë në krye të subjektit a ku ta di unë. Erdhi Rexhep Qosja dhe atë e bëm kryetar të Lëvizjes Demokratike Shqiptare. Më vonë kësaj Lëvizje Demokratike Shqiptare që u zgjerua bukur shumë e shpejt, ju bashkuan edhe nja gjashtë a shtatë parti t'vogla. E ndrrum edhe emrin, e bëm Lëvizja e Bashkuar Demokratike se ishin të bashkuara parti të tjera domethanë. Mund të them që kontributi i kësaj lëvizje ma i madh ka qenë në mbështetjen e luftës çlirimtare që bënte Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Pastaj, vet kryetari i saj Rexhep Qosja duke qenë njeri i letrave, dijetar, akademik, të huajt kur vinin e dinin që ne disa veprimtar aty në udhëheqje të kësaj partie, të kësaj lëvizje se lëvizje e quanim, ishim, kishim lidhje me shumë njerëz në krye të UÇK-së me të cilët kishim qenë n'burg bashkë ose kishim qenë t'organizun në organizatat tona. Në GRG a OMLK ma vonë.

Prandaj, nuk ishim ndoshta, ndoshta po thom, aq të besueshëm për ta kur flisnin për luftën. Kurse Rexhep Qosja fliste me argumente dhe unë e shihja reagimin e tyre që i besonin ato që thoshte. Ato që thoshte ishin krejtësisht në mbështetje të luftës, të një lufte të drejt sepse ne kishim bërë përpjekje gjithfare deri ktu që ta zgjidhim çështjen, nuk po arrijmë dhe u detyru Kosova që t'hyj n'luftë. Prandaj ne e mbështesim këtë luftë, e përkrahim e tjera.

Ky ishte, ky ishte kontributi ndoshta ma i madh po pastaj n'vitin 1999-ten që nga fillimi i vitit u bën disa përpjekje për organizimin e një zhvillimi ndërkombëtar që do t'merrej me çështjen e Kosovës, me zgjidhjen e saj. Ose nëse kurgjo mos tjetër me ndaljen e luftës dhe plotësimin e disa kërkesave të kësaj lufte, disa objektivave të kësaj lufte. Unë kom marrë pjesë në këto takime bukur shpesh dhe bukur shumë herë në zyrën amerikane atëherë ku ishte prezent shumë shpesh Christopher Hill që ishte ambasador në Maqedoni por edhe i ngarkuar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për çështjen e Kosovës.

Një njeri... edhe Richard Holbrooke edhe ai ishte me të shumë shpesh e vinin në Kosovë. Ata po merreshin për formimin e një ekipi të unitetit në Kosovë për t'shkuar në një konferencë eventuale ndërkombëtare dhe për t'biseduar atje, për ta përfaqësuar Kosova. U bë disa përpjekje t'formohen disa delegacione po gjithnji duke lënë anash UÇK-në. Ne po insistonim që UÇK-ja duhej t'jetë në atë

delegacion sepse po bëjnë luftën, po jepin kontributin e tyre madhor me pushkë n'dorë. Ndikim kishte bërë edhe vet UÇK-ja sigurisht.

Nuk po mund të arrihej një një ekip ose një delegacion unik që do t'shkonte e t'fliste n'emër të gjithë Kosovës, pa marrë parasysh subjektin politik ose ushtarak, në emër të gjithëve edhe në emër të gjithë qytetarëve që do të gëzonte besimin e qytetarëve të Kosovës dhe t'shkonte t'bisedonte atje duke qenë legjitim. Bën disa përpjekje që t'bëhej ni grup. Nifar' subjekti n'veti ishin bërë tashi edhe studentët pas asaj demonstratës të 01 tetorit. Sepse ata e ngjallën dinamizmin e veprimit në Kosovë me demonstratën e tyre n'krye me vet rektorin që kishte dalë bashkë me ta ndonëse ishte i sëmurë. Ejup Statovci ishte rektor atëherë.

Dolën edhe profesor të tjerë bashkë me demonstruesin që nuk kishte ndodhë për shembull në vitin 1981 në masë kшту. Po ktu profesorët nuk u ndan nga studentët e tyre, dolën bashkë. Pati sakrifica gjithë ajo punë po pati edhe jehonë t'madhe dhe ndikoj në gjithë skenën politike dhe ushtarake të Kosovës dalja e studentëve atë ditë në rrugë. Kштуqë edhe ata tash ishin ni faktor që duhej t'përfshiheshin në delegacion, përveç partive politike edhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nuk arrihej kjo lehtë, s'di se qysh shkoj ndërmend. Holbrooke dhe Christopher Hill ata propozuan që t'formohet ni qeveri brenda në Kosovë me iniciativën amerikane dhe me mbështetjen europiane. Europeanët dhe Bashkimin European e përfaqësonte atëherë Petritsch, Wolfgang Petritsch⁴, një njeri intelektual i zoti, studiues, po edhe në politikë domethanë po shkëlqente edhe në këtë ndërmjetësimin tonë. Holbrooke siç e njohim t'gjithë, ai kur merrte shtynte proceset përpara, ishte si ai bullduzheri që shtyen çka t'gjen përpara edhe... ata propozun, amerikanët propozuan por edhe me bekimin e europianëve që të formojnë ni qeveri të unitetit dhe pastaj qeveria të flas në ni konferencë eventuale që do të organizohej.

Më propozuan mua për kryeministër. Unë e pranova. Pranova sido që të ishte pranova që t'jem në krye të asaj qeverie ku do t'bënte pjesë shoqëria civile, partitë politike në radhë të parë Lidhja Demokratike e Kosovës e pastaj edhe ushtria, në radhë të parë bile. Të formohej ni qeveri me përfaqësues nga këto subjekte ushtarake dhe politike edhe të shoqërisë civile. Kjo shoqëria civile ishin Veton Surroi dhe Blerim Shala. Fillimisht Partia Demokratike në krye me Ibrahim Rugovën. E pranun kandidaturën time si mandatar domethanë.

Ishte... unë u pashë me, president ishte atëherë Ibrahim Rugova, u pashë me të dhe ai ma konfirmoj edhe mua që ne jemi dakord që ti t'jesh ai. Problemi ishte tash të shkojmë të komunikojmë me ushtrinë, me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. Nji ditë u nisëm që t'shkojmë në shtab. Christopher

⁴ Wolfgang Petritsch ishte i dërguari i posaçëm i Bashkimit European për Kosovën gjatë negociatave të viteve 1998-1999 dhe një nga ndërmjetësuesit kryesorë ndërkombëtarë në Konferencën e Rambujesë. Më pas shërbeu si Përfaqësues i Lartë në Bosnje dhe Hercegovinë (1999-2002).

Hill, Tina Kaidanow që ishte ndihmëse e tij, Veton Surroi, Blerim Shala, Hydajet Hyseni ka qenë edhe unë. U nisëm të shkojmë në Berishë në Kleçkë ku ishte Shtabi i Përgjithshëm.

Mirëpo, një natë përpara kishte hy ofenziva, noshta ishte koiçidencë, pikërisht kur dihej që do t'formohej qeveria e unitetit dhe ishte pajtuar edhe LDK-ja edhe LBD-ja që ishte tash subjekt në vete. Filloj ofenziva dhe u thy mbrojtja e Kievës. Atëherë thuhej pika ma e ndjeshme në Europë është Kieva, ku u bo rezistencë e fortë e UÇK-së por lufta në Llapushnik ishte e përgjakshme, në Grykën e Llapushnikut dhe ne duhej t'shkonim tash të takohemi me shtabin e përgjithshëm.

Hilli tha, "Do t'shkojmë ktu nëpër Sllatinë dalim në Komoran edhe shkojmë atje". Mu m'u tek thashë, "Jo, nuk kisha dashtë të shkojmë nëpër Llapushnik sepse aty mram ka pasë luftime dhe është derdh gjak i dëshmorëve tanë dhe nuk dëshiroj që makina jonë ta shkel atë gjak sot". Mirë, e mirëkuptoj. Atëherë na po shkojmë, po shkojmë nëpër Shtime dhe sillemi pak ma rrotull e dalim atje. U nisëm. U nisëm në paradite. Shkum në Shtime. E kalum Shtimën është pak në bregore aty kur t'kalojsh Shtimën. Kur na kanë pa neve ushtarët serb, policët, u shtrinë për toke dhe nisën po gjujnë me armë rafale për të tregu që po luftohet ktu. Nuk besoj që kishte far' lufte aty.

Kur shkum na ndalën. Ishte makina jonë, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ishte në gjip i madh, i blinduar me flamuj amerikan e tjerë. Na ndaluan. Mrapa nesh ishte në gjip portokalli i ktyne vëzhguesve. Thanë, "Ku po shkoni?" Foli Hill foli me ta se ishte përpara i ulur. Tha, "Po shkojmë në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së", thanë, "Nuk mund të shkoni, a po shihni që ka luftime ktu? Do t'rrezikoheni po t'niseni asaj rruge t'hyni. Ka luftë, kërkush s'mund t'ju garantoj sigurinë. Ne s'mundemi". Ky tha, "Ne megjithatë duam t'shkojmë me gjithë rrezikun".

Ky paramendonte pak që luftë aty s'kishte, mund t'kishte diku ma thellë. E panë ata që ishte këmbëngulës ky. Ne s'po flisnim tjerët. Tha, "Jo nuk mund t'shkoni, ktheni". Çka t'bëjmë? U detyrum u kthym. U kthym po u kthym me në plumb që goditi makinën. Erdhëm në Prishtinë. "A mund t'shkojmë tash nga, mbasi nuk arritëm anena t'shkojmë", s'kishte rrugë tjetër. "A mund t'shkojmë ktu nëpër Komoran?" Unë kisha kundërshtu fillimisht. Tash po i thom, "Meqë erdhi puna kshtu, po shkojmë". U nisëm. Shkum deri në Sllatinë.

Në Sllatinë aty na pritën policia, s'na lanë hiç t'shkojmë në Komoran. Thanë, "Nuk mund t'shkoni se ka luftime, po luftohet atje". Na kthyn edhe aty dhe dështoj atë ditë kjo ndërmarrja jonë. U kthym, "Çka t'bëjmë tash?" Tashti po m'pyste mua sepse nuk dinte rrugë siç i dinim ne. Thashë, "E lëm shkojmë nesër në mëngjes", tash ishte bërë vonë, thashë, "Shkojmë nesër në mëngjes dhe unë do t'gjej rrugën nga do t'shkojmë mos u boni merak". Dojsha edhe t'mos e dijë kërkush as mos t'rrjedh fjala që po shkojmë nesër se ata na prisnin pastaj, na zinin pritrat nuk na lenin.

Të nesërmen përsëri ne i njeiti ekip, hyjmë në makinë dhe po shkojmë. E njihja anena pak, unë jom i Strovci të Vushtrisë dhe atë teren pak a shumë e njoh. U nisëm për Mitrovicë. Ma merr menja që ata

kanë mendu që ne po shkojmë në Mitrovicë e prej Mitrovicës dalim në Skenderaj e pastaj kthehemi rrugëve të atjeshme për Shtabin e Përgjithshëm me u taku. Nuk ju ka shku menja atyne që kur shkum te Pestova, para se të hyjmë në Vushtrri, osht' aty ni rrugë, rrugë e keqe, me gropa e pa shtruar ku ta di unë edhe aty i thashë shoferit, "Kthe në të majtë", ku s'na pritshin ata që do t'hyjmë ne aty.

Hyjmë aty dhe rruga ishte për, për faqe t'zezë. Rrugë e keqe shumë. Nisi gjip tash po kcente poshtë e lartë nëpër ato grupa. Mbaj mend që Tina Kaidanow po qeshte kur e pa makinën si shkonte ashtu. S'ka pasë ajo n'jetë kurrë përvojë gropash (qeshë). Qeshte n'fillim po pastaj rruga ishte e tëra me gropa deri n'fund dhe nuk qeshte më (qeshë). Sepse ishte e rëndë. Ne kishim njoftuar UÇK-në e asaj zone që t'dalin t'na presin, diku.

Pjesa e Dymbëdhjetë

Mehmet Hajrizi: E kalum atë rrugë. Na duhej pak ni rrugë që shkon e asfaltuar nga Vushtrria për në Prelluzhë. E kanë shtruar më shumë për serbët atëherë. Qat' rrugë e kishim pak në rrezik me na prit dikush aty po kalum edhe atë dhe hym malit përpyet. Pak si n'shaka i kisha thënë Christopher Hillit që në zonën ku kontrollohet nga forcat serbe je përgjegjës ti për neve. Kurse kur t'hyjmë në zonën e UÇK-së përgjegjës jam unë. Mirë. Hym në zonën, dolën ata të Ushtrisë Çlirimtare na pritën me ni makinë kso limuzinë.

Ata po na prijnë përpara. Ne pas tyre. Ata i kishin dhezë kto dritat mrapa po neve na ishte prishë e majta, ndizej vetëm kjo e djathta dhe gjithnji t'linte përshtypjen që po hynte djathtas dikund. N'rregull. Po shkojmë pas tyre. Dola unë fola me ata dhe ata thanë që në ni fshat po zhvillohen luftime, në ni fshat të Skenderaj, Polac. Ne do t'bijmë dikund afër tyne aty, të jeni në dijeni domethanë. Po ne po ecim përpara ju ejani mas nesh. Mirë. U nisëm.

Ndërkohë takum plot gra, burra, fmijë, pleq tek kishin ikë nga zonat ku po luftohej dhe po vinin nga rruga ku po ngjiteshim ne. Ata vinin në anën e kundërt për t'u vendos diku nëpër fshatra ma t'sigurta ku s'kishte luftime. Kto i pam mirë. Pastaj, në Shtetet e Bashkuara nihere Christopher Hill m'duket në kongres mos ka qenë thotë, "Unë atë ditë tek po udhëtonim kom pa refugjat shqiptar që po ktheheshin dhe kom pa n'çfarë gjendje ishin ata, kah po iknin nga forcat serbe dhe aty unë i kom thanë vetit që kurrë nuk kom me pushua për t'i mbrojtë kta njerëz edhe për t'i nxjerrë nga lufta", domethanë për t'ju ndihmuar.

Kur mbrritëm me ni lartësi u ndal kjo makina e UÇK-së dhe po vijnë te makina jonë. Thanë, "Ktu tash ku jemi forcat serbe na shohin neve dhe ata kanë armatim që mund t'na gjujnë prej atje dhe t'na godasin makinën. Prandaj, nuk mund t'ju themi që t'vazhdojmë ne rrugën tash ktu sepse ktu po rrezikoheni. Ata mund t'gjujnë prej aty fare lehtë dhe ta shkatërrojnë edhe makinën edhe juve". Christopher Hill tha, "Zoti Hajrizi, kush e ka përgjegjësinë e sigurisë ktu tash?" (qeshë). Unë i kisha

thënë që në zonën e UÇK-së unë e mbaj përgjegjësinë. Pastaj u kthye nga ata, “Grahni makinës, do t’vazhdojmë”.

Ta them të drejtën isha pak i befasuar, ni njeri nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës vjen ktu në Kosovë edhe hyn në ni rrezik që mund t’i kushtoj me jetë dhe thotë, “Grahni makinës, do t’ecim”. Unë nuk isha ai që mund të thosha vazhdo makinën përpara, jo. Sepse nuk mund t’garantoja sigurinë e një njeriu që nuk ishte... hajde ne ishim shqiptarë t’gjithë, po ai ishte një mysafir i largët. Shkoj makina, eci. Mbrritëm në Likovc. Po në Likovc nuk ishte i tërë Shtabi i Përgjithshëm ishin vetëm pak anëtarë, një dy m’duket, tre, dy, dy. Rexhep Selimi ishte, Bislim Zurapi ishte nga Shtabi i Përgjithshëm m’duket. Ka qenë ky komandanti i zonës të Drenicës, Sylejman Selimi edhe ndonjë tjetër që kam harruar.

Aty doli i pari Hill për nevojën e një ekipi të unitetit, për nevojën e një qeverie, për, “Ne mendojmë që si unifikues i të gjithëve”, në nifar’ konflikti ishin subjektet politike mes veti niherë e pastaj edhe me ushtrinë dikush e tjera e tjera. “Kemi menduar që t’jetë Mehmet Hajrizi që jemi ktu bashkë me të, le t’flas edhe ky”. Fola edhe unë. Ata thanë, ata që ishin aty, “Jemi n’rregull po duhet ta paraqesim çështjen në Shtabin e Përgjithshëm dhe t’vendos i tërë shtabi. Ne nuk mund t’vendosim sot po jemi tash në ofenzivën serbe dhe vështirë e kemi të takohemi po na leni dy javë afat që ne t’mblihdemi dikund t’bahemi bashkë”. Se ishin tash krejt të shkapërderdhur pasi kishin hy thellë forcat.

Mirë. U kthym me nifar’ shprese. Ishim në pritje ne ende, kta delegacioni europian nuk kishin udhëtuar. Po prisnin që kur të kthehem ne të jepnim lajmin që po e pranuan qeverinë edhe ata dhe do t’formohet që t’kthehen me këtë lajm. Ne pastaj nuk u kthym asaj rruge t’keqe sepse tani nuk mërziteshim fort. Po vazhdum në Drenas e prej Drenasi dolëm në Komoran. Aty kishin qenë punkti policor që kanë qenë prej herët po meqë s’kishte çarkullim... ajo rrugë s’kishte çarkullim përveç forcave ushtarake. Ata ishin sdërvaj nëpër tokë e po hanin diçka policia.

U çun n’kamë një dy a tre prej tyre kur u afruam ne afër. Nuk na ndalën, nuk na pytën. Bon veç me dorë që mund t’shkoni anej edhe zbritëm pastaj në Sllatinë e erdhëm në Prishtinë. Po nuk e sollëm lajmin. Atëherë kanë udhëtuar kta europianët, morën rrugën. Nuk e sollëm lajmin dhe po prisnim ne tash ni konfirmim. U bën dy javë sa kishin kërkuar, nuk erdh konfirmimi. Kaloj edhe dy javëshi nuk erdh. Ofenziva ishte shtri në të gjitha anët atje. Nuk e dinin tash a ishte ofenziva, a ishte pa mundësia që të takoheshin t’gjithë që të merrnin ni vendim po nuk erdhi përgjigja.

U kthym përsëri te delegacioni. Dështoj qeveria. Dështoj dhe unë e konsiderova si një dëm që ju bë Kosovës. Me ta thanë të drejtën, qëllimi im ishte që gjithë mjetet që mblidheshin që ishin mbledhë ai 3% nga qeveria e jashtme dhe gjithë mjetet që ishin mbledhë nga Vendlindja Thrret meniherë t’i kontraktaja dhe t’bëj armë për njerëzit që dojnë t’luftojnë. Isha i sigurt edhe sot jom i sigurt që po t’kishte armë, jo 20 mijë a 200 mijë po 300-400 mijë t’ri e t’reja kishim mujtë m’i nxjerrë n’luftë atëherë në t’gjitha rajonet, gjithkund, edhe Prishtina kish dalë. Që konsiderohet se ka qenë e strukur e tjera.

Ka pasë motiv t'fortë tek të rinjtë sidomos që t'dalin edhe t'luftojnë. Unë veç po e përmendi ni shembull. Kthehem pastaj ktu përsëri unë, po e boj ni digresion. Pasi jemi kthyer nga Rambuje na thanë që jeni në shënjestër t'parët ju prandaj mos qëndroni në shtëpia t'paktën javën e parë, dhjetë ditëshin e parë. Po strehohuni dikund ku t'mundeni. Unë dola ktyne bjeshkëve të Germisë përpjetë edhe dola lart në dy zonat që ishin pran njëra tjetrës. Zona e Karadakut dhe Zona e Llapit. Aty kom parë të rinjë dhe thanë edhe kta të UÇK-së që thanë janë rreth tre mijë të rinjë që po kërkojnë të hyjnë në UÇK po s'po mund t'i marrim se s'këm armë. Ata armë të veta nuk kishin.

Ajo zonë aty që ka qenë e pa banueshme ish mbush plot e për plot banor, kush e di sa dhjetra mijë të tillë që kishin ardhë nga shumë zona për t'u strehuar atje. Meqë ishte vend malor. Tre mijë. Pastaj kom qenë edhe në Zonën e Llapit atje, ne tash ishim në cilësinë e qeverisë sepse qeveria e përkohshme u themelu, do t'flas ma vonë për këtë. Erdhi ni djalë që s'ishte larg prej ktu po më njifte. Tha, "Baca Mehmet po shoh që po rrin me komandantin", ishte komandant i zonës Rustem Mustafa të Llapit. "A ka mundësi me lut le t'më pranojnë në UÇK se s'po më pranojnë?" Nuk mund t'i ndihmoja, s'kishte armë. Çka të shkosh në UÇK? Çka kërkon? Me gjujt gur? S'kishte.

Të gjitha në armatim do t'i futsha si qeveri e unitetit. Kjo ishte puna e parë që duhej t'bëhej domethënë, pastaj do t'shkojmë në bisedime ne po armatimi t'jetë i sigurt. Nuk ishin pak para, nuk di sa kanë qenë krejt po nuk ishin pak para që t'blehej armë. Nuk u bë megjithatë kjo punë dhe dola me ni deklaratë unë që u dëmtu Kosova. Sa m'përket mu personalisht unë s'kisha ndonjë interes personal aty, jo, ajo qeveri mund edhe t'rrezikohej sepse nuk do t'lejonte Serbia që t'formohet ni qeveri ktu para hundëve t'saj në Prishtinë.

Do t'ndërmerre diçka po ne megjithatë deshëm ta bëjmë dhe kisha ndërmend t'ju them ministrave që sot ktu u themluam, nesër në mëngjes jemi në Malishevë. Malisheva ishte e shliuar atëherë. Dhe do t'vendosemi atje. Do fati bashkë me ata njerëz kudo t'jenë ata do t'jemi edhe ne si qeveri po s'mund t'veprojmë në Prishtinë, s'na lën. Nuk u bë. Nuk u bë dhe mbaroj kjo punë. Pastaj ju kthyer përsëri delegacioneve. Hajde të formojmë delegacion pas delegacioni edhe po bisedohej për punën e një konference si do t'dukej ajo dhe çfarë mund t'bisedohej n'të.

Unë i kisha dhënë tri kushte si mandatar i qeverisë. E para të ndalet lufta. E dyta në Kosovë të hyjnë forcat e NATO-s që të kontrollojnë zonat e kontrolluara nga UÇK dhe të ruajnë paqen, të mos thehet paqja. E treta të ulemi të bisedojmë me ndërmjetësim ndërkombëtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës. "Ky osht", thashë, "me tri fjali programi i qeverisë time. Unë nuk du t'paraqes tash program për zhvillimin e kulturës e të sportit e të ekonomisë po deshtët e tjera. Kto janë programi i gjendjes në të cilën ndodhemi, të kontekstit historik ku jemi dhe pastaj vazhduam me këto delegacione deri në fund të vitit '98.

Atëherë u arrit ni marrëveshje që t'jetë ni delegacion i përbërë nga LDK, LBD dhe UÇK me përbërje të barabartë secili, me përfaqësues t'barabartë. Mirë. Edhe nga, e quanin vetën independent, të pavarur,

Blerimi edhe Vetoni, edhe aty dy në delegacion. Mirë, u pajtuam. Me 05 maj po m'duket, me 05 shkurt m'duket 05 ka qenë u mor' vesh që të nisemi. Na lajmërun që UÇK-ja s'mund, pjesa e delegacionit të UÇK-së nuk mund t'niset sot. Ne refuzum që t'shkojmë. Tham, "Jo nuk shkojmë pa UÇK-në me vete", se nifar' dyshimi mos po e lana UÇK-në jashtë.

Megjithatë udhëtum të nesërmen. Me 06 po m'duket. Kishin ardhë dy aeroplan t'vegjël ushtarak francez në aeroport që nuk zinte aeroplani ma shumë se shtatë a tetë vet. Po me dy aeroplan hynim t'gjithë. U ndam në dy aeroplan ne. Ne shkuam drejt në aeroport. Unë nuk kisha, nuk m'kishin dhënë pasaportë kurrë që kur kisha dalë nga burgu. Pastaj, u detyrun nifar' mënyre meqenëse isha anëtar i delegacionit ma bonën ni pasaportë. Me pasaportë t're unë frringo po udhëtoja atë ditë.

Shkum atje. Pjesëtarët e UÇK-së të delegacionit erdhën në aeroport po nuk hyn në kontrollë e që bohen zakonisht ku kontrollohen pasaportat po drejt në aeroplan. Erdhën me makina të KDOM-it, që i thojshin atëherë, të vëzhguesve. Hyjnë në aeroplan pa kurfar' kontrolli. Ata megjithatë s'kanë pasë besim t'plotë që do t'vijne ashtu aq lirë. Kishin marrë nga ni revole me veti. Jo për t'vlarë kënd me të po ishin t'bindur që nuk duhej të dorëzohen dhe për t'vlarë vetën domethanë. Të armatosur hyjnë në aeroplan dhe po udhëtonim.

Bile ktij komandantit të Shtabit të Përgjithshëm, Azem Syla ishte atëherë, kishim qenë t'organizuar bashkë ne në organizatë edhe n'burg pastaj ni kohë kemi qenë bashkë. Po i them, ishim në aeroplan ai m'duket Fehmi Agani duhet t'ketë qenë, Ibrahim Rugova... bile Ibrahim Rugova... se aeroplani ishte me tavolinë, me, sikur të ishte ni restaurant ashtu. Nuk ishte kshtu ato ulëset varg siç shkojnë njëra pas tjetrës.

Po i thom këtë Azemit me shaka, thashë, "Isa Boletini kur ka shku në Europë nuk ka shku kshtu i çarmatosur sikur ju, sikur ti", po i thom atina. Kur ai po e shpalon palltën e tij qishte {shtyen mrapa setren e tij në anën e djathtë} dhe po tregon që e kishte. E kishte me veti. Unë nuk e dija që ishin të armatosur. E kishte, e shpaloj për t'u dukë. Mirë. Shkum. Shkum mirë. Atje tash Rambuje është një histori e gjatë nuk di sa keni interes ta dëgjoni...

Anita Susuri: Po, tregona pak.

Mehmet Hajrizi: Shkum në Paris dhe na bën bashkë dy delegacionet edhe delegacionin serb edhe ne. Ishte aty ministri i jashtëm francez Vedriç edhe ishte ministri i jashtëm britanik [Robin] Cook⁵, po erdhi Presidenti i Francës Jacques Chirac, e mbajti ni fjalim para t'gjithë neve bashkë aty. Tha që janë disa momente në histori kur paqja e popujve është në duar të vetëm disa njerëzve, tha, "Sot, paqja e juv atje, shpëtimi i atyre viktimave, vrasjeve e tjera është në dorën tuaj. Ju mund ta vendosni paqen sot",

⁵ Robin Cook ishte Ministër i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar (1997–2001) dhe një nga zërat kryesorë të diplomacisë britanike gjatë krizës së Kosovës. Ai luajti rol të rëndësishëm në mbështetjen ndërkombëtare për ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999.

por e tha edhe ni gja t'ëndësishme, "Europa nuk don, nuk pranon luftë në kontinentin e saj, territorin e saj".

U ndam aty. Prej nesh s'mund t'liste kërkush. Me këta delegacionit serb a u përshëndet a s'u përshëndet nuk e di. U ndam edhe na hypën në makina na dërgun në Rambuje. Rambuje ishte nja 30 a 40 kilometra, nuk di sa, ishte larg. Po ne ishim me makinë shtetërore dhe ishim nën përcjellje të policisë ata me motocikleta. Nuk kisha pa n'jetën time të bëjnë ni përcjellje policore të një delegacionit me aq art sa policia franceze. Nuk du tash t'i përshkruaj krejt po m'ka lënë shumë përshtypje.

Unë isha ulur përpara në atë far' kombi busi që po na dërgonin dhe i shihja mirë, i përcillesha si ndrrheshin ata njëri me tjetrin, si ofroheshin, si fishkëllenin, si shkonin pastaj drejt e te xhami i dritarës së makinës e trokisnin n'dritare. Shoferi kur u kthente shikonte thoshte, "Shtyju anej", si i zinin rrugët pastaj që t'mos mund t'hyj askush aty. Ishte një shfaqje interesante, artistike për mua që po shikoja si i bënin ata me art gjith këtë punë.

Shkuam në Rambuje, u vendosëm nëpër dhoma. Pushum atë natë. Të nesërmen filloj puna. Delegacioni serb ishte vendosë në katin lart nesh dhe ne s'kishim kontakte me ta, përveç kur dilnin n'ballkon ndonjëherë e ne dilnim jashtë për t'bërë shëtitje në oborrin e, nuk ishte oborr po ishte ni fushë e tërë e kështjellës të Rambujes. Ni kështjellë e vjetër dhe përjashta ishte knaqësi të ecje po t'kishe kohë. S'kom pasë kohë me dalë dy-tre herë kom dalë krejt. Poshtë ishim ne të vendosur, delegacioni.

Formum atë një herë si delegacion u morëm vesh për disa parime që vendimet t'merren me konkonzus t'plotë. Vetëm një t'kundërshtonte s'mund t'merrej vendimi. E dyta zgjodhëm ni kryesi, zgjodhëm ni grup politik për t'i shqyrtuar t'gjithë draftet që vinin, dokumentet që i bënin ndërkombëtarët. Ne kishim marrë paraprakisht parimet e pa negociueshme dhe e dinim që ato parime nuk e preknin integritetin dhe sovranitetin e Jugosllavisë. Ajo Jugosllavi që kishte mbetur me Federatën Serbe dhe Malazeze atëherë.

Ne kishim pranuar t'shkojmë n'bisedime për t'parë nëse mund t'nxjerrim ndonjë gjë t'hajrit. Por që të mbetemi ne në kuadër të Jugosllavisë atëherë ajo luftë po bëhej e kotë dhe po shkonte huq e tëra dhe gjithë ato vujtje, gjithë ato vrasje, gjithë ato masakra, e fundit ishte bërë në Reçak me 15 janar. Ishte e kuptueshme domethanë që ne nuk mund të prananim kurqysh që të mbetemi pavarësisht që ishte parim i negociueshëm. Por, ajo që na shtynte ne t'shkojmë t'bisedojmë ishte ni marrëveshje e përkohshme me afat tre vjeçar. Pas tri vjetësh ne mund të nxirrnim atë që dëshironim dhe nëqoftëse jo mund t'vazhdonim luftën.

Po UÇK do t'ishte në ni pozitë tjetër mas tri vjetësh, do ta merrte vetën, do t'armatosej ma mirë, do të riorganizohet, do të zgjerohet e tjera e tjera. Kto t'gjitha e bënin t'mundur që ushtria dilte me ni kapacitet krejt tjetër n'luftë, me ni potencial krejt tjetër n'luftë, jo me atë që kishte aktualisht. Që

çështje e vërteta ishte me municion të kufizuar dhe me armë të kufizuara. Nuk mund të mbahej gjatë lufta frontale ma. Një luftë guerile ndoshta edhe mund të mbahej kur t'i del del vret atje dikond edhe ni polic a ni ushtar edhe ikën e mshefesh e tjera e tjera. Po ktu ishte qëllimi të bëhej ni luftë ballë për ballë.

Shkum në emër të ksaj, në emër të përkohësisë së marrëveshjes. Në grupin politik që u formu prej katër vetve, si përfaqësues i të pavarurve ishte, e quanin kshtu vetën, ishte Blerim Shala atëherë. Përfaqësues i LDK-së ishte Fehmi Agani. Përfaqësues i UÇK-së ishte Jakup Krasniqi dhe përfaqësues i LBD-së isha zgjedhë unë. Nga t'gjitha deshëm ta zgjedhnim nga një që t'formohet grupi politik. Kishte punë shumë ky. T'i shqyrtonte të gjitha draftet që do t'sillnin grupi i kontaktit dhe ndërmjetësuesit e ato drafte kanë qenë shumë dhe ndryshonin.

Ata i bënin herë ftohtë herë nxehtë për t'mar' pulsën deri ku mund t'shkohet. Herë i bënin në favor të Serbisë, herë në favor tonin. Po ne bonim punën pastaj te kto dhe ipnim gjitha vrejjet dhe sygjërimet tona se si duhet t'jetë drafti i marrëveshjes. Jo ashtu siç e paraqisnin kta po me ndryshimet tona. Kishim edhe kshilltar t'huaj. Me grupin tonë politik punonte Mark Veller. Një profesor universitar i Mbretërisë së Bashkuar, i shkëlqyeshëm, njohës shumë i mirë i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe jurist i fortë. Ishte ndihma jonë. Kemi punuar bashkë me të tërë kohën, natën edhe ditën, s'kam pasë orar.

Pastaj, u formun edhe grupe tjera për ekonomi, për siguri, për... kishim thirrë edhe ekspert të ndryshëm nga Kosova, të fushave përkatëse që t'vijnë atje dhe t'bisedojmë bashkë. Unë isha angazhuar për grupin ekonomik, për ekspertët ekonomik që do t'vinin aty. Duhej ata t'i udhëhiqja për t'shkuar në bisedime me ndërkombëtarë. Konferenca megjithatë mbaroj, s'dua t'ju mbaj gjatë me këtë. Por, nuk u nënshkru marrëveshja, duhej t'nënshkruar.

Nuk u nënshkru as nga pala serbe që e refuzonte, e refuzonte sidomos për atë kapitullin e sigurisë që parashihte hyrjen e NATO-s në Kosovë. Ata nuk dëshironin t'hyj NATO ktu sepse konsideronin vetën shtet sovran dhe nuk lejoj t'hyj ni ushtri e huj aty se do t'jetë okupuese nëqoftëse vjen ajo. Nuk e pranonte Millosheviçi. Ndoshta s'e pranonte edhe për hallet e veta po nuk pranonin. Kurse ne tham, "Na jepni afat nja dy javë t'shkojmë t'konsultohemi me bazën tonë atje", bile ata thanë, "me popullin".

Dikush nga gazetarët e huaj që ishin për çdo ditë aty pytën, "Si konsultohen kta me popullin tash n'gjendje lufte?" Ni gazetar i hyni, humorist thotë, "Konsultohen me telefona mobil", thotë, "krejt shqiptarët kanë telefona mobil" (qeshë). Bënte shaka. Ne u kthyem. U kthyem brenda dhe nuk mund t'them ndonjë diçka të veçantë për juve ktu që pat' rrugës. U kthyem në Kosovë kurse ata pjesëtarët e UÇK-së u kthyen në zonat e veta. Dikush në Kosovë dikush në Tiranë po edhe aty u kthyen.

Ne sigurisht u konsultuam. Ne ishim nja shtatë parti të bashkuara në Lëvizjen e Bashkuar Demokratike. Atje bile m'u ngarku mu t'dal t'flas me ta në ni mbledhje të gjerë dhe t'i njoftoj dhe t'marr miratimin e

tyre. Folëm sa folëm dhe në fund Afrim Morina, ni veprimtar i hershëm, ai ishte kryetar Unikomit, ni parti atëherë që ka udhëheq ma përpara Ukshin Hoti po ai ra n'burg. Po pytë tha, "Ty çka ta merr menja? A duhet me nënshkru marrëveshjen a jo?" Thashë, "Mu ma merr menja që po vetëm për arsyen themelore se marrëveshja është e përkohshme dhe ne mund ta miratojmë përfundimisht, mund mos ta miratojmë, mund t'vazhdojmë luftën kërkush s'na ndalon".

Si duket kjo tani u bë edhe si të thush nifar' argumenti që thanë po, u pajtun t'gjithë. Ne kishim miratimin tonë. Nuk di tjerët qysh janë konsultu po kanë shkru pastaj. Kam pa që UÇK-ja për shembull ka mbledhë komandantët e zonave, kanë bisedu me ta, nuk e kanë kundërshtu, kanë pranë që të shkohet në Rambuje. Kshtu shkrujnë ata që dëshmojnë për kto punë. U kthym ne jo mas dy jave po mas tri jave qashtu diqysh. Nënshkrimi tash duhej të bëhej në Paris në një hotel afër asaj portës triumfale që është, nuk ishte larg. Se di kom harrru. M'dukej Sofitel quhej, hotel shumë i shtrejtë.

Aty bujtëm natën e parë pastaj me 18 mars duhej t'shkonim për nënshkrim. U nënshkru marrëveshja. Ata na kishin premtuar që ju po na pengoni, nënshkruani marrëveshjen dhe aksioni i NATO-s fillon. Ku me marrë ma mirë, ne këtë e prisnim NATO të bohet aleat i yni. Ai në qiell na n'tokë. U kthym ktu. Na thanë që duhet të keni kujdes të strehoheni dikund bile javën e parë se mund t'ju godasin t'parëve juve të delegacionit. N'rregull. Unë siç tregova dola, dola ktu maleve.

Mas nja katër-pesë diteve që filluan bombardimet se po rrija, po rrija te ni fqinj i imi ktu i burgosur politik edhe ai. Nuk prisja që do t'vijne dhe aty qëndrova, qëndrova tek ni mikpritje vllazërore. Mas nja tre-katër pesë dite tani dolëm anena. Me 02... në ni akord që kishim arritur në Rambuje në fund të konferencës ishte që sipas marrëveshjes që thonte do t'formohet ni qeveri e përkohshme në Kosovë deri në zgjedhjet e para. Ne formum, ne arritëm ni marrëveshje atje që t'formojmë ni qeveri të përkohshme.

Tash e kishim lanë mandatarin ta zgjedhë UÇK-ja. Kurse aty t'shkonin si ministra përfaqësues të subjekteve politike. E kishin nënshkruar atë Rugova dhe nga UÇK-ja Thaçi, Hashim Thaçi. U kthym, nuk, nuk pat' ma ndonjë gatishmëri ma për këtë punë.

Pjesa e Trembëdhjetë

Mehmet Hajrizi: Më njoftun pastaj që kush ka dëgjuar, unë s'e kisha ndëgju, që po është formu qeveria e përkohshme. Mu m'thanë, 'Ti ishe zgjedhë zëvendës kryeministër', edhe dy tjerë atje ishin zgjedhë ministra. Hydajet Hyseni dhe Bajram Kosumi edhe ndonjë zëvendës ministër. Kshtuqë ne tash ishim atje dhe po përfaqësonim qeverinë që ishte formu e re në Kosovë. Nuk dinim ne a do të dërgojnë përfaqësuesit e vet kta tjerët, sidomos LDK-ja. Nuk di për çfarë arsye krejt po nuk e dërguan. Kshtuqë qeveria mbeti gjatë luftës nuk patëm ndonjë punë kush e di çfare.

Po përpiqeshim t'bëhemi bashkë disi me Shtabin e Përgjithshëm atje dhe me pjesën tjetër të qeverisë. Nuk po arrinim se ofenzivë mas ofenzive. Bëmë ni përpjekje, u desh t'kthehemi. Nuk bëri. Komunikonim me telefon satelitor qashtu. Kaq. Pas lufte pastaj meqenëse mbet një mbasi nuk erdhën krejt, një qeveri gjysmake. Nuk mund t'kishte kushedi çfarë veprimtarie. Po në fund të vitit '99 pushoj së vepruari. Ashtu po i bjen. Po. Në vitin 2000 pastaj...

Anita Susuri: Veç po du edhe pak me ju pytë për luftën. Për familjen, ku ka qenë familja? A ka qenë në Prishtinë e strehune diku gjatë luftës?

Mehmet Hajrizi: Familja ime ka qenë ktu ku jemi tash. Pastaj, janë vendosë ktu ni shtëpi të Jashar Alisë. Ai kishte ni podrum dhe kanë shku jo vetëm familja ime po familjet Hajrizi janë fut në atë podrum aty. Kishim edhe ni t'sëmuar rëndë, Zeqir Hajrizin, që i ishin bllokuar veshkët tash. Veshkët që kishin ni histori prej burgut...

Anita Susuri: Po, që na tregut.

Mehmet Hajrizi: Po. Pastaj kanë ardhë ktu forcat policore i kanë nxjerrë jashtë dhe me gjithë qytetarët e tjerë, plot, i kanë drejtu drejt stacionit të trenit atje. Atje pastaj janë bart kush andej kush këndeje. Familja ime kanë shkuar drejt Tetovës nëpër Jezhincë dhe kanë përfunduar atje në ni familje shumë t'mirë që i kanë prit mirë dhe kanë qëndruar aty gjatë luftës.

Anita Susuri: E ju gjatë gjithë kohës jeni kanë ktu a po?

Mehmet Hajrizi: Unë gjatë gjithë kohës kom qenë ktu deri disa ditë para përfundimit t'luftës kur shkova në, nëpërmjet Maqedonisë dhe shkum në Tiranë. Atje, atje pastaj udhëtuam Hashim Thaçi, Xhavit Haliti edhe unë në Itali dhe u takuam me ministrin e jashtëm italian Lamberto Dini atëherë. Kaq. Unë s'kisha pasaportë për udhëtim atje, kisha mbetë në shtëpi. Ajo pasaporta e Serbisë. Ministria e Jashtme e Shqipërisë ma bëri ni pasaportë. Ma bëri ni pasaportë që më shërbeu edhe katër vjet tjera.

Megjithëse unë nga viti 1992 isha shtetas i Shqipërisë. Po si t'kthehem tash mbrapa ktu ku jem. Kisha ni vlla t'sëmur me kancer dhe duhej të operohej në Tiranë. Unë doja t'shkoja në Tiranë. Se ta shihja ndoshta për herë t'fundit se ai mund të mbetej edhe n'sallë. Shkova bashkë me vllaun tim, këtë Zeqirin, dhe vajzën e tij. Ni fiqnj ktu na çoi me makinën e tij. Shkum në Maqedoni ku mund t'kaloj me leternjoftim. '92 ka qenë kjo, vjeshtë. '92, po. Unë shkova te, ka qenë atëherë Partia e Prosperitetit Demokratik në Maqedoni.

Shkova te ata në zyre dhe ju thashë që duhet t'ma bëni ni hall disi t'më qitni në Shqipëri mua. Thanë, "Po, kem rrugë po duhet nëpër baltë e nëpër ujë që t'kalojmë", rrugë klandestine. "Por, mund ta rregullojmë ndoshta edhe në kufi t'kalosh se osht' një shqipëtar i joni aty që punon në kufi. Po ai shkon në punë aty në ora 07:00, ju duhet t'prisni deri në 07:00". Shkum në ni fshat. M'duket mos Veles kemi

qenë nuk jom i sigurt. Nejtëm aty shumë mirë na pritën. N'fund u nisëm me ni makinë të tyre dhe makinën tonë. Shkum n'kufi. Bisedun kta t'partisë me atë shqiptarin.

Ai thotë, “Nuk po kom mundësi me nxjerrë pa pasaportë. Krejt mundësinë që kom unë Mehmeti le ta merr pasaportën e vllaut unë e qes pa problem edhe pse s'osht' pasaporta e tina”. Ata po tregojnë, kshtu kshtu osht' puna. “Me pasaportë t'vllaut mund t'dalësh”. Kjo do të thonte që vllau të kthehej n'shpi. S'ma merrte menja mu ta bëj këtë. Ai tha, “Nëqoftëse don po ta jep pasaportën edhe shko”, “Jo, shku për shku shko ti me pasaportë tane po jo unë me shku”. Nuk bëhet. Mirë, dolëm te makina. I shoh ata policët e doganierët rrishin afër makinës tonë aty. Ne duhej të nisemi. Po pres, po kqyri unë anash. Do të kthehem unë, m'vinte shumë rand të kthehem mrapa. Duhej tash kta t'më merrnin me makinë dhe t'më kthejnë.

Ishte kjo vjaza e vllaut prej meje knej e ulun. Po ia boj, “Qelma dritaren”, e qeli, e hapi dritarën mrapa. Unë po i shikojta ata a po m'shikojnë mua. Po flas diçka unë me kta kishe a din. Thashë, “Unë vetëm po bisedoj, ju mos u gutni m'u nisë”. Po bisedoj me këtë vajzën diçka, po qeshim, i kqyri ata s'më kqyrin. Çka t'bëj i shkreti. Nuk isha bash i aventurave (qeshë). Si njeri s'kam qenë kurrë. Aty e shoh. Dikur thash, “Hape derën”. E qeli derën. Thashë, “Kishe po t'jep diçka ose po marr diçka prej teje”. Kom harru diçka n'makinë edhe po zgjatem kishe po marr edhe po kqyri atje, nuk reagojnë. E hapi derën pak a shumë u ula, i them, “Grahi makinës”. U nis ai. Me shpjetësi dolëm. Kërkush as s'na fishkëlloj as s'na thirri, ne kaluam kufirin.

Kalum në pjesën shqiptare tash. Te Qafë Thana ishte kjo. Pjesën shqiptare ata ma zotni nuk dilnin me na kontrollu ktu po u dashke të gjithë udhëtarët me pasaporta t'shkojnë n'zyre atje. Thom, “Ju që keni pasaporta shkoni, unë po rri ktu”. Dola n'vend t'shoferit unë, po rri. Tash kta policët ktu që ishin doganierët e mund t'mendojnë thojnë ky e ka kry sigurisht përpara dhe tash po vjen po rrin shlrë, ma merrte menja. Kshtu përafërsisht ndodhi. Vi unë n'makinë. Kur erdh ni polic, polic m'u dok mua, polic m'boheshin krejt tash. Ndoshta ka qenë doganier.

“Hape”, tha, “bagazhin”. Dola jashtë dhe po shkoj kshtu po e hapi. S'di as ku e ka ata e ku hapet në makinë tina. E hapëm. Po shikon. “S'keni gjë?” “Jo”, thashë, “s'kemi gjë për të deklaruar”, “Mirë n'rregull”. Shkova unë u ula, po pres ata kur po vijnë. Po vijnë ata të tret t'u i fut pasaportat nëpër xhepa, e kishin kry. Kur erdh vllau thashë, “Hyni”, thashë, “n'makinë se unë jam shoferi”. Për mos me bo ma lëvizje m'u vonu. Hyjnë ata te tret unë i jep gaz (qeshë) e kalova. Atje rruga e keqe kur dolëm. Mirë shkum.

Shkum dhe hyra kshtu unë atje. Po kur shkova atje kishte mundësi me u mbajtë mbledhja konstituive e parlamentit që kishte dalë pas zgjedhjeve që kishim mbajtë në vitin 1992. U dëgjova me ta thanë, “Po provoj do t'mbajmë mbledhjen e kuvendit tash”. Të mos isha unë aty nuk, m'vinte shumë randë. Mund t'konsideronte dikush, çka m'shkonte mu mendja, mos po thotë dikush Mehmeti s'ka dashtë

t'rrezikohet se e ka ditë që kur të mbahet mbledhja vijnë policia na arrestojnë t'gjithëve e qe ka ikë. Kshtuqë duhej t'shkoja me çdo kusht duhej t'shkoja atje. Po s'kisha tash pasaportë.

Shkum te ministri i brendshëm unë edhe Ali Aliu. Ali Aliu ishte atëherë në zyrën e Kosovës në Tiranë. Ishte Bashkim Kopliku ministër. Po i tregoj krejt hallin. Thashë, "Mu m'duhet ni pasaportë që mund të kthehem në Prishtinë se ka mundësi që të mbahet mbledhja tash". Ai e thirri drejtorin e policisë, drejtorin e policisë të kufirin, Agim e kishte emrin tash kom harru mbiemrin. Erdh Agimi. Tha, "Dëgjoje pak Mehmetin". Unë po i tregoj atij qishtu kom hy e po m'duhet ni pasaportë e s'di çka. Ai, "Qysh hyre", tha, "ti në Shqipëri? Si hyre ti në Shqipëri?"

Ky ministri po ia bon, "Agim", tha, "lëre si hyri tregoj si të dal" (qeshë). "Jo për të dalë nuk është asni problem se unë ju them atyre t'kufirit që t'kalojnë ty po do t'kesh problem ti në kufirin maqedon pastaj. Aty do të ndalin s'ke pasaportë", thashë, "Po edhe ky ishte ni hall tjetër që ta bëj një pasaportë", "Një pasaportë", tha, "duhet të kesh shtetësinë, kurse kërkesën për shtetësi", tha, "presidenti", Sali Berisha ishte, "presidenti e bën vetëm", tha, niherë në muj a gjashtë muj, qishtu diqysh, "i shqyrton kërkesat dhe e jep ose s'e jep shtetësinë", tha, "po ne urgjentisht po e çojmë kto dhe po i tregojmë që është me urgjencë kjo".

E pashë që do t'vonohet kjo punë thashë le t'bojnë çka t'dojnë kta unë po kthehem. Kërkova ni pasaportë t'ma bijnë prej shpije, t'huj që ngajsha pak me të unë. Ma sollën dhe me atë pasaportë u ktheva unë, erdha në shtëpi pa ndonjë problem. Kur po m'thirr ma vonë tash nuk ishte ma Ali Aliu ma aty po ishte Mehmet Kraja. Disa muaj më vonë. N'telefon. Mehmet Kraja ishte shef i asaj zyrës tonë atje. "Mehmet", tha, "ka ardhë ni pasaportë ktu e jotja, a don ta dërgoj a vjen vet me marrë a po ta lë ktu në zyrë?" Thashë, "Leje aty ku është". Se t'ia jepin ndokujt thojsha po e hallakatin edhe t'ja gjejnë edhe m'del problem tani mu edhe atij. Thashë, "Le t'rrij aty ku është".

Kurrë s'e kom pa atë pasaportë më, kurrë s'e kom marrë, s'di çka u bë, ka shku atje ka mbetë. Shtetësinë kurrë s'e kom shfrytëzu. Para nja dy-tri vjetve kom shku me Haxherën bashkë edhe pashë që kishte qenë dosja ime e '92-tes atëherë që e kisha shtetësinë prej atëherë. Janë bërë tash për 31 vjet kom hyrë unë që jam shtetas i Shqipërisë. E mora edhe pasaportën edhe letërnjoftimin. I kom por s'i shfrytëzoj dot as tani. Në vjeshtë të vitit '99...

Anita Susuri: Keni shku me pasaportën shqiptare në...

Mehmet Hajrizi: Shqiptare, po. Bile si në shaka ishim në ni takim me disa kongresist dhe senator në mesin e të cilëve ishte edhe Robert Doll. Me Robert Dollin njihesha që herët. Kur dolëm prej atij takimi po shkojmë koridorit bashkë. Unë isha me Robert Dollin kah shkoj, mrapa ishte ni zyrtar, s'di kush ke. Me shaka po i thom senatorit thashë, "M'duhet ni pasaportë, ni pasaportë që t'vi ktu në Amerikë ma me dinjitet tjetër herë". E kuptoj. E kuptoj çka po i thosha.

Njëri mrapa që po vinte, mrapa nesh po i thotë Dollit, “Të shikojmë, ka mundësi ndoshta të shikojmë mos po mund t’bëjmë diçka atje”, “Leje”, tha, “leje. Nuk e ka hallin ky për ni pasaportë t’vetën, po kërkon”, tha, “tjetër gjë. Miku im”, tha, “do ta kesh edhe atë pasaportë”. Vërtetë u bë. U bë po u bë në 2008-ten.

Anita Susuri: Në cilin vit keni dalë në penzion, jeni pensionu?

Mehmet Hajrizi: Kom harru se osht’ para dhjetë viteve kjo.

Anita Susuri: Deri në penzion jeni angazhu për politikë apo?

Mehmet Hajrizi: Jo. Kur mbaroj lufta unë kom heq dorë nga politika tërësisht për t’mos u kthyer më kurrë. Kom pasë kërkesa, oferta hajde hyn ktu e aty nuk kom hy në asni parti dhe nuk hy ma. T’ju them shkakun ndoshta s’ia vlen po dukej ni politikë ndryshe tash, ni politikë e interesit. Nuk gjeja ma vetën aty dhe kom heq dorë. Mund të isha aty edhe sot mund të isha aty po... pastaj kom punu në funksione profesionale. Kom qenë nja tri vjet sekretar i përgjithshëm në kryeministri.

Pastaj, kom qenë nja dy vjet themelues i drejtorisë për integritet europian dhe dy vjet e kom mbajtë atë drejtori. Ishte fillimi atëherë s’kishte shumë. Ni Priba ka qenë, ni gjerman që ishte ngarkuar edhe me Kosovën. Megjithatë u nis diçka dhe u bë diçka. Pastaj, pas qeverisë kom qenë në kuvend shëf i kabinetit kom qenë dhe këshilltar i lartë i kryetarit të kuvendit për nja shtatë vjet. Ni mandat e gjysë, dy mandate gati. Kom dalë në penzion po i bie 2005. Sa po i bjen? Dhjetë vjet mrapa tash. Tash osht’ ‘23, 2023 hiq dhjetë vjet 2013, a po i bjen kshtu? 2013-ten kom dalë në penzion. Ma pastaj s’jom angazhu në kurfar’ angazhimi s’kom marrë ma kurfare. As...

Kom ardhë ktu në shtëpi. Atëherë pata punu me ni projekt për historinë e ni organizate dhe e përfundova. U botu ajo akoma pa dalë në penzion. Po 2008-ten domethanë. E botoj Toena në Tiranë. Kom shkru aty ktu ndonjë shkrim nëqoftëse ka naj vlerë domethanë dikush mund ta lexoj. Ndonjëherë m’thrrasin në ndonjë simpozium, ndonjë aktivitet, “Hajde”, shkoj. Po jo ma si politikan. Përndryshe nuk jom shkëputë nga interesi për politikën domethanë e përcjell politikën. I vështroj t’mirat e t’kqijat e saj. Vrej ku bëhen gabime, ku... po nuk shkoj ta qortoj kërkond që t’i them ktu osht’ keq ktu osht’ mirë. Nuk jom përzi domethanë në kto.

Rri ktu me ni penzion që kom të punës sime të para luftës. Po jam në epërsi me gruan time sepse kjo as penzion nuk merr mbasi nuk i ka bërë 15 vjet përvoj pune. Se niherë s’e kanë pranuar n’punë siç thashë ma përpara. Herën e dytë pse ka dalë n’grevë e kanë përjashtu prej pune, në vitin 1990 është përjashtu nga puna. Kjo është arsyeja pse nuk i ka 15 vjet, i ka dikund 13 e diçka por jo 15 dhe nuk merr, nuk merr penzion. Ndryshe nga unë që i marr 200 euro. Bëjmë jetën. Këtë shtëpi që po na shihni.

Megjithatë ndjehemi të lumtur për arritjet që ka bërë Kosova. Një herë që nuk është nën qizmen e huaj, e dyta që ka ndryshuar shumë prej atëherë e deri tash. Që është zhvilluar, që nuk i shoh më nga aeroplani ato kulmet e zeza të djegura po janë t'kuqe. Në vitin 2000 në të vërtetë 2000, në janar të vitit 2000, unë kom hy me vullnet djaloshtar t'madh në departamentin e rindërtimit që ishte produkt i bashkë qeverisjes të vendorëve me ndërkombëtarët në UNMIK.

Departamentin e rindërtimit e kemi udhëhequr për një tri vjet, dy vjet e gjysë aty dikund, një anglez, Roy Dickinson dhe unë. Të dytë bënim sa ni ministër domethanë për ta udhëhequr ni digaster ekzekutiv atëherë. Puna jonë ishte që t'koordinojmë donatorët ndërkombëtarë të tërheqim sa ma shumë donacione prej tyre dhe t'i orientojmë ku t'i dërgojnë ndihmat. Kemi qenë në një unitet t'plotë me këtë ndërkombëtarin. Ishim dhe kemi mbetë miq t'mirë. Koordinoheshim shumë mirë bashkë dhe kemi dalë n'teren. Përsëri në teren. Në teren në gjithë Kosovën për t'parë dëmet, për t'i vlerësuar ato dhe për t'i orientuar donatorët atje ku ishte ma keq.

Me donatorët, t'shumbtë kanë qenë donatorët, kemi mbajtur mbledhje koordinuese çdo dy javë përafërsisht, ndonjëherë edhe n'javë. I kemi koordinuar. Kanë qenë shumë t'knaqur ata me punën e kësaj dyshje që po bënim bashkë. Janë ato vitet ndër ma t'mirat që i kam kaluar në përvojën time sepse i ndërtuam një 20 mijë shtëpi me donatorët. Ndërtuam rrugë, ndërtuam kanalizime, ndërtuam shtëpi të kulturës, ndërtuam infrastrukturë çfarëdo qoftë edhe ujësjellësit. Që u bën me ujësjellës fshatra të tëra që s'kishin pasë kurrë ujësjellës, për herë t'parë domethanë.

Tashma s'po merrnin vetëm dëmtime të riparoheshim po po bënim diçka të re që s'ka pasë deri në këtë kohë. Kam qenë i lumtur për ato vite të asaj veprimtarie për punën që po bënim që ato çati të djegura t'i bëjmë me tjegulla të kuqe dhe ndodhi ky ndryshim. M'u kujtu kur përmenda çati të djegura prandaj bëra këtë digresion të së kaluarës që ne kishim kaluar aty ma herët. Ka pasë ni vullnet t'madh ndërkombëtar për të ndihmuar Kosovën dhe është ndihmuar. Ka shku në miliarda domethanë vetëm ndihmat europiane dhe ka vazhdu pastaj kjo edhe pas departamentit të rindërtimit kur u shpërndan ato departamente se kishte për t'gjitha fushat departamente.

Kanë ndihmuar ndërkombëtarët, ju mund ta dini mirë edhe n'kohën e sotme domethanë ku ndërkombëtarët vazhdojnë të ndihmojnë në shtet ndërtim, në ndërtimin e institucioneve, në ndërtimin e demokracisë, të kulturës demokratike dhe të ndërtimit të ni shteti modern europian në Kosovë. Është bërë punë e madhe, punë e madhe dhe Kosova ka ndryshuar. Edhe t'hujtë kur vijnë thonë, 'Paska ndryshuar edhe ma shumë'.

Anita Susuri: Zoti Mehmet nëse nuk keni edhe diçka ju kisha falënderu për kohën edhe për kontributin e ju.

Mehmet Hajrizi: Kom.

Anita Susuri: Urdhnoni pra (qeshë).

Mehmet Hajrizi: Kom shumë (qeshë). Kom shumë me thanë kom shumë kujtime. Unë nuk i kom shkruar kujtimet dhe kjo që bët' ju me mua është ni kontribut për t'nxjerrë kujtimet e mia në ni masë të konsiderueshme. Prandaj ju falënderoj unë juve që erdhët ktu dhe në gjithë këtë punë e bët' për kohë kaq t'gjatë që ne t'flasim, t'flasim për ato që kam përjetu, ato që janë bërë, ato që kanë mbetur pa bërë, ka shumë për t'u bërë për Kosovën ende. Unë tash jam në vitet e pleqërisë dhe nuk mund të bëj shumë. Po zemra m'rrah për Kosovën. Për Kosovën dhe për të ardhmen tuaj.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!

Mehmet Hajrizi: Dhe për t'gjithë t'rive të Kosovës. Uroj, uroj që kurrë ma Kosova t'mos kthehet në ato vite të tmerrit po të përparoj dhe jom i sigurt për këtë që Kosova do t'bëhet një shtet modern, europian dhe do t'ketë jo vetëm subjektivitet ndërkombëtar t'vetin t'gjitha institucionet ndërkombëtare por do t'ketë edhe rol në ruajtjen e ndërtimin e paqes. Paqes në rajon dhe n'botë. Do t'jem ni faktor, faktor ndërkombëtar, superfuqi ne s'bëhemi kurrë por mund t'jemi paqe ndërtues. Do t'jemi sigurisht se po jemi provat e para që jemi, jemi dhe mund t'bëjmë diçka për paqen. Edhe kta ushtarë që shkoj në misione t'jashtme e vërtetojnë edhe shqiptarët nga Shqipëria.

Unë kam bindje gjithashtu që në ni të ardhme të kombit të bashkuar shqiptar dhe këtë nuk e vë në dyshim. Nji popull i ndarë padrejtësisht kurrë nuk duhej ta pushoj ëndërrën e tij për t'u bashkuar, për t'u ribashkuar. Ky popull do t'bashkohet dhe do t'jetë një vend edhe një faktor i paqes në rajon. Ka nevojë shumë që të ndërtohet ni trekëndësh, këtë e kam thënë, të ndërtohet ni trekëndësh i paqes ktu në Ballkan. Kta janë tre popuj. Pak a shumë me numër t'njejtë të banorëve. Serbia, Greqia edhe Shqipëria. Shqipëria e bashkuar.

Kta duhet t'kenë edhe një potencial mbrojtës ushtarak të përafërt dhe kjo vendos pastaj ekuilibrin në rajon ktu dhe pushojnë ëndërrat për të zgjeruar territoret për ekspansion të fuqive fqinjë tanë për ta zgjeruar territorin në dam të shqiptarëve siç ka ndodhë në të kaluarën. Atëherë do t'vendosi paqja. Këtë do duhej ta kuptonin edhe ndërkombëtarët. Nuk do t'ketë nevojë atëherë të vij ktu KFOR-i, NATO për të qenë po ne do t'jem në NATO dhe do t'kem kapacitetin tonë ushtarak për t'u mbrojtur dhe do t'i ruhem ni tjetrit sepse jemi secili i rrezikshëm për tjetrin.

Prandaj, duhet të pajtohem me paqen dhe koekzistencën si popuj dhe si vend. T'jenë të kaluara kto. Unë e besoj këtë, do t'jenë të kaluara. Nuk do t'jem ni popull që jetojnë vazhdimisht në ankthin kur po na sulojmë, ku po na sulmojnë, a do t'jemi gjallë e tjera. Jo, ne do t'kemi sigurinë e plotë, sigurinë e plotë sepse e meritojmë. Ju faleminderit!

Anita Susuri: Ju faleminderit edhe niherë!